FOL lëvizja

Duke Mbështetur Qeverisjen e Mirë dhe Qytetarinë Aktive
Supporting Good Governance and Active Citizenry

Indeksi i Transparencës së Institucioneve dhe Ndërmarrjeve Publike në Kosovë II

Hulumtim politikash: Vlerësimi i transparencës së institucioneve dhe ndërmarrjeve publike në Kosovë për vitin 2011

Nentor 2011

B | T | D The Balkan Trust for Democracy
A PROJECT OF THE GERMAN MARSHALL FUND

Publikimi i këtij Raporti është përkrahur nga BTD – The Balkan Trust for Democracy. Qëndrimet e shprehura në këtë raport nuk reflektojnë qëndrimet e BTD-së.

Përmbajtja

Falënderime **3**

Rreth Lëvizjes FOL **3**

I. Hyrje *4*

Përmbledhje ekzekutive *4*

Qëllimi dhe metodologjia e studimit *6*

Dispozitat kushtetuese dhe ligjore për qasje në dokumentet zyrtare *8*

II. Përmbledhje e të gjeturave **10**

III. Të gjeturat për secilin institucion dhe ndërmarrje publike **11**

Institucionet përfaqësuese **11**

1. Kuvendi i Republikës së Kosovës *11*

Institucionet ekzekutive të nivelit qendror **14**

2. Zyra e Kryeministrit (ZKM) *14*

3. Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL) *16*

4. Ministria e Drejtësisë (MD) *19*

5. Ministria e Integrimit Evropian (MIE) *21*

6. Ministria e Komuniteteve dhe Kthimit (MKK) *23*

7. Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH) *25*

8. Ministria e Punëve të Jashtme (MPJ) *27*

9. Ministria e Shëndetësisë (MSH) *29*

10. Ministria e Zhvillimit Ekonomik (MZHE) *31*

Institucionet e pavarura dhe agjencitë ekzekutive **34**

11. Agjencia kosovare Kundër Korrupsionit (AKK) *34*

12. Agjencia për Privatizim e Kosovës (APK) *36*

13. Dogana e Kosovës (DK) *38*

14. Institucioni i Avokatit të Popullit (IAP) *41*

15. Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK) *42*

Ndërmarrjet publike **45**

16. Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës (PTK) *45*

IV. Përfundime dhe rekomandime **48**

FALËNDERIME

Publikimi i këtij Raporti u mundësua nga “BTD – The Balkan Trust for Democracy” në kuadër të projektit “FOL për Qasje ne Dokumente Zyrtare”. Ky Raport, po ashtu, është produkt dhe rezultat i kontributit të një ekipi të përkushtuar, si nga stafi i Lëvizjes FOL, por edhe nga bashkëpunëtorët e jashtëm. Në këtë kontekst, Lëvizja FOL falënderon publikisht të gjithë personat që punuan në sigurimin e informacioneve dhe përpilimin e këtij raporti.

RRETH LËVIZJES FOL

Lëvizja FOL angazhohet për të fuqizuar ndikimin qytetar në vendimmarrje, për qeverisje të përgjegjshme dhe efikase. FOL është thellësisht e përkushtuar që të punojë në përmirësimin dhe arritjen e niveleve më të mira të përfaqësimit qytetar në jetën publike. FOL punon për qeverisje të mirë dhe të bazuar në parimet demokratike, për institucione të përgjegjshme, transparente dhe llogaridhënëse, si dhe për zbatim dhe hartim të ligjit me pjesëmarrje. Prandaj, shpenzimi i fondeve publike, konfliktit të interesit, neglizhenca dhe përgjegjësia institucionale, si dhe qasja në informacione zyrtare, përbëjnë çështjet kryesore të punës së FOL. Në përmbushje të këtyre qëllimeve, FOL mëton të luftojë apatinë dhe indiferencën qytetare si dhe ta bëjë më aktiv dhe më të dëgjueshëm zërin e qytetarit; ta bëjë atë pjesë aktive të interesit të komunitetit dhe përherë të gatshëm që t’i kundërvihet abuzimit, keqpërdorimit, korrupsionit dhe formave tjera deformuese të qeverisjes.

I. Hyrje

1. Përmbledhje ekzekutive

Ky studim politikash publike është i dyti me radhë, pas atij të vitit të kaluar. Ashtu sikurse studimi i vitit 2010, edhe ky vlerëson transparencën e institucioneve dhe ndërmarrjeve publike që operojnë në Kosovë. Këtë vit jemi fokusuar kryesisht në përparimet e bëra që nga studimi i vitit të kaluar në funksionimin e strukturave të brendshme të institucioneve dhe ndërmarrjeve publike që janë përgjegjëse për çështjet e komunikimit dhe informimit publik, natyrisht duke vlerësuar të njëjtat çështje si raporti i kaluar. Pra, edhe ky studim fokusohet në atë se deri në çfarë niveli institucionet dhe ndërmarrjet publike kanë zhvilluar kapacitetet e strukturave të tyre formale për të siguruar zbatimin e plotë dhe efektiv të dispozitave kushtetuese dhe ligjore që garantojnë të drejtën e qytetarëve për qasje në dokumentet publike, pra komunikimit dhe informimit publik, me qëllim të forcimit të transparencës dhe llogaridhënies ndaj publikut.

Ky raport përmbledh gjetjet sa u përket çështjeve relevante nga tri përmasa kryesore të ndërtimit të institucioneve në këtë fushë 'horizontale' të politikave publike, përkatësisht në lidhje me infrastrukturën ***rregullative***, atë të ***politikave*** (përkatësisht zbatimin e kësaj rregullative në kuadër të kornizave kohore të caktuara dhe në kontekstin e veçantë të fushëveprimit të secilit institucion dhe ndërmarrjeje publike) dhe ***kapacitetet*** për implementimin efektiv të kornizës rregullative dhe asaj të politikave. Megjithatë, përkundër faktit se në raportin e kaluar është theksuar se sigurimi i informatave dhe të dhënave të plota dhe adekuate për këtë studim politikash publike kërkon punë analitike dhe një vetë-vlerësim paraprak të brendshëm nga secili institucion (sidomos nga ana e zyrtarëve përgjegjës për komunikim dhe informim publik), siç mund të vihet re në vijim të këtij raporti, këtë vit nuk është shënuar përmirësim i dukshëm në numrin e institucioneve dhe ndërmarrjeve publike që i janë përgjigjur kërkesës për pjesëmarrje në të, kurse një numër tejet i vogël i atyre që i janë përgjigjur kanë marrë parasysh gjetjet e vitit të kaluar. Kjo në veçanti tregohet nga përsëritja e gabimeve elementare nga viti i kaluar (si për shembull, ngatërrimi i akterëve të shoqërisë civile me ata qeveritarë, donatorë, organizata të huaja dhe projekte që mbështesin institucione të ndryshme ekskluzivisht në nivel teknik – në ngritjen e kapaciteteve institucionale të çfarëdo lloji, pastaj i kornizës ligjore me atë të politikave, e kështu me radhë).

Në vijim paraqitet rangimi i të gjitha institucioneve dhe ndërmarrjeve publike, sipas Indeksit të Transparencës Institucionale (ITI) për vitin 2010 dhe 2011.

Indeksi i Transparencës së Institucioneve dhe Ndërmarrjeve Publike (rangimi për 2010 dhe 2011 – pasqyrë krahasuese):

NR.	INSTITUCIONI/NDËRMARRJA PUBLIKE	INDEKSI		TRENDI
		2010	2011	
1.	Dogana e Kosovës (DK)	90 (**JPH**)	93 (**JPH**)	▲
2.	Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL)	47 (**PJH**)	55 (**M**)	▲
3.	Agjencia për Privatizim e Kosovës (APK)	N/A	55 (**PJH**)	N/A

4.	Ministria e Shëndetësisë (MSH)	N/A	55 (**PJH**)	N/A
5.	Kuvendi i Republikës së Kosovës (KRK)	53 (**M**)	50.5 (**M**)	▼
6.	Agjencia kosovare Kundër Korrupsionit (AKK)	69 (**GJH**)	48 (**M**)	▼
7.	Ministria e Integrimit Evropian (MIE)	N/A	48 (**M**)	N/A
8.	Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK)	N/A	45.5 (M)	**N/A**
9.	Ministria e Punëve të Jashtme (MPJ)	62 (**PJH**)	45 (**M**)	▼
10.	Zyra e Kryeministrit (ZKM)	41.5 (**M**)	42.5 (**M**)	▲
11.	Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës (PTK)	43 (**M**)	42.5 (**M**)	▼
12.	Institucioni i Avokatit të Popullit (IAP)	N/A	39 (**M**)	N/A
13.	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH)	N/A	39 (M)	N/A
14.	Ministria e Drejtësisë (MD)	N/A	29.5 (**M**)	N/A
15.	Ministria e Zhvillimit Ekonomik (MZHE)	N/A	24.5 (M)	N/A
16.	Ministria e Komuniteteve dhe Kthimit (MKK)	N/A	24 (**M**)	N/A
17.	Korporata Energjetike e Kosovës (KEK)	64 (**PJH**)	N/A	N/A
18.	Policia e Kosovës (PK)	55.5 (**PJH**)	N/A	N/A
19.	Prokuroria e Shtetit	3 (**M**)	N/A	N/A

2. Qëllimi dhe metodologjia e studimit

Ky studim politikash fokusohet në punën e institucioneve publike dhe ndërmarrjeve publike në zbatimin e Ligjit për Qasje në Dokumente Publike gjatë periudhës janar 2010 – maj 2011. Informata për qëllim të këtij studimi kanë dhënë vetëm 16 institucione dhe ndërmarrje publike. Pyetësori përkatës u është dërguar atyre në fillim të muajit korrik, dhe kanë pasur rreth dy muaj kohë për t'u përgjigjur pyetjeve të parashtruara. Për të arritur deri te të gjeturat e prezantuara në këtë raport kemi kaluar nëpër tri faza:

Zhvilli i indikatorëve për vlerësim, gjatë së cilës janë identifikuar *çështjet* që mbulon studimi dhe *indikatorët* për vlerësimin e transparencës.

Çështjet specifike që mbulon studimi ndahen në këto kategori:

1. *Korniza ligjore* në fuqi (përfshirë legjislacionin kornizë dhe atë zbatues – aktet nënligjore) që themelon dhe rregullon funksionimin e strukturave të brendshme institucionale/organizative dhe të kapaciteteve implementuese për komunikim dhe informim publik, bazuar në dispozitat përkatëse të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe në Ligjin për Qasje në Dokumente Publike;
2. *Korniza rregullatore* në fuqi zbërthen këto obligime ligjore në përgjegjësi konkrete të strukturave të brendshme institucionale/organizative përgjegjëse për komunikim dhe informim publik në kuadër të secilit institucioni/ndërmarrjeje publike, si dhe detyrat specifike të stafit të obliguar për të kryer funksione specifike të komunikimit dhe informimit publik (Struktura Organizative/Organogrami – SO/O, Termat e Referencës – TR, dhe Përshkrimet e Vendeve të Punës – PVP);
3. *Korniza e politikave* në fuqi (strategjitë dhe planet e veprimit, qofshin ato 'horizontale' [specifikisht për komunikim dhe informim publik] apo komponentë në kuadër të dokumenteve të 'vertikale'/sektoriale të politikave], të cilat zakonisht janë shumë-vjeçare dhe parashohin objektiva strategjike) dhe planet operative për implementimin e tyre (të cilët zakonisht janë njëvjeçarë, dhe të cilët përkthejnë objektivat strategjike në aktivitete konkrete për arritjen e këtyre objektivave strategjike);
4. *Korniza institucionale/organizative* për komunikim dhe informim publik, me fokus në ekzistimin e strukturave institucionale/organizative për këtë qëllim, si dhe të mekanizmave të funksionimit të tyre, përfshirë pozitën e tyre hierarkike dhe standardet e brendshme të monitorimit, raportimit e vlerësimit të implementimit të legjislacionit e dokumenteve strategjike dhe atyre planifikuese relevante për komunikim dhe informim publik, por edhe ato për vlerësimin e performancës së stafit përkatës;
5. *Kapacitetet institucionale* (humane, financiare dhe teknike) për implementimin e legjislacionit e të dokumenteve strategjike dhe atyre planifikuese relevante për komunikim dhe informim publik; dhe
6. *Çështjet e implementimit*, me fokus në praktikat dhe standardet administrative për komunikim dhe informim publik, gjë që ka të bëjë specifikisht me marrëdhëniet me mediat dhe organizatat e shoqërisë civile (përfshirë ato të biznesit), përfshirjen e tyre në hartimin dhe monitorimin e implementimit të legjislacionit përkatës dhe të dokumenteve strategjike e planifikuese që rrjedhin nga ky legjislacion (qofshin këto dokumente strategjike specifike për institucionin/organizatën ose për sektorë përkatës), si dhe çfarëdo masash dhe aktivitetesh shtesë, përtej obligimeve ligjore të ndërmarra nga institucionet dhe ndërmarrjet publike me qëllim të komunikimit dhe

informimit më të mirë të publikut dhe zbatimit më të mirë të dispozitave përkatëse kushtetuese e ligjore.

Indikatorët: Sistemi i Pikëve të Transparencës Institucionale (SPTI) – sistem pesë-shkallësh, siç është paraqitur në tabelën në vijim:

1. ***'I mbyllur' (M)***: 0% – 54% nga 100%, shënjuar me të kuqe	
2. ***'Pjesërisht i hapur' (PJH)***: 55% – 66%, shënjuar me portokalli;	
3. ***'Gjysmë i hapur' (GJH)***: 67% – 80%, shënjuar me të verdhë;	
4. ***'Jo plotësisht i hapur' (JPH)***: 81 – 92%, shënjuar me të përhimë 50%	
5. ***'Plotësisht u hapur' (PLH)***: 93% – 100%, shënjuar me të gjelbër.	

Bazuar në këto çështje është bërë **mbledhja e të dhënave** përmes një pyetësori të përbërë nga 25 komponentë: 24 pyetje dhe një tabelë. Përmes pyetësorit është synuar të mblidhen informata kuantitative dhe kualitative mbi secilën çështje. Pyetësorët u janë dërguar Sekretarëve të Përgjithshëm të Kuvendit dhe Institucioneve përfaqësuese dhe atyre qendrore ekzekutive, përkatësisht Kryeshefave Ekzekutivë dhe/ose Drejtorëve të institucioneve të pavarura, agjencive ekzekutive dhe ndërmarrjeve publike. Prandaj këta zyrtarë, si përgjegjësit më të lartë menaxherialë të tyre, janë përgjegjës për të gjitha gjetjet që përmban ky raport.

Në hyrje të secilit pyetësor, respondentët janë udhëzuar në mënyrë të hollësishme dhe të saktë mbi mënyrën e plotësimit të pyetësorit dhe llojin e informatave të kërkuara, përfshirë edhe atë se çfarë lloj zyrtarësh (këta të fundit janë specifikuar në bazë të fushave të përgjegjësisë) brenda strukturave të tyre duhen konsultuar për të marrë informata gjithëpërfshirëse dhe të sakta mbi çështjet për të cilat kërkon informata pyetësori. Të dhënat janë mbledhur nga fundi i majit deri në fund të gushtit 2010.

Pas kthimit të pyetësorëve të plotësuar, është bërë **vlerësimi i transparencës** së institucioneve dhe ndërmarrjeve publike, sipas indikatorëve të paraqitur më sipër. Varësisht nga sasia dhe cilësia e informatave të dhëna në pyetësor dhe në dokumentet e dërguara si pjesë të përgjigjeve, secili komponent i pyetësorit është vlerësuar me nga 0 deri në 4 pikë. Shuma e pikëve të dhëna përbën ***Indeksin e Transparencës Institucionale (ITI)***, të shprehur me numrin e plotë që pasqyron përqindjen e pikëve, emërtim tekstual dhe kod, si dhe ngjyrë, në përputhje me (SPTI).

3. Dispozitat kushtetuese dhe ligjore për qasje në dokumente publike

Kushtetuta e Republikës së Kosovës, në Nenin 41, përcakton se "Secili person gëzon të drejtën për qasje në dokumentet zyrtare." Më tej, ajo përcakton se "Dokumentet që mbajnë institucionet publike dhe organet e pushtetit shtetëror, janë publike, përveç informatave që janë të kufizuara me ligj për shkak të privatësisë, sekreteve biznesore tregtare ose klasifikimit të sigurisë."[1] Përmes kësaj, Kushtetuta krijon të drejta dhe detyrime. Nga njëra anë, ajo qytetarëve u jep të drejtën për qasje pa pagesë dhe të papenguar në dokumentet e institucioneve dhe ndërmarrjeve publike si në nivelin qendror ashtu edhe në atë lokal. Nga ana tjetër, ajo i detyron institucionet publike dhe ndërmarrjet publike që të krijojnë të gjitha mekanizmat dhe infrastrukturën mbështetëse si dhe të ndërmarrin të gjitha masat e nevojshme për të siguruar përmbushjen e kësaj të drejte, duke filluar nga zbërthimi i detyrimeve specifike të tyre përmes legjislacionit zbatues, e cili duhet më pastaj të pasqyrohet dhe të zbatohet në kuadër të kornizës së politikave të secilit institucion dhe ndërmarrje publike. Megjithatë, ky nen i Kushtetutës përcakton se kjo e drejtë mund të kufizohet në rastet kur qasja në informatat që përmbajnë dokumentet e caktuara shkel privatësinë, ose kur këto informata paraqesin sekrete biznesore ose duhet të klasifikohen për arsye të sigurisë publike. Më tej, aty përcaktohet se këto kufizime duhet të përcaktohen më në hollësi me ligj. E ky ligj është Ligji për Qasje në Dokumente Publike.

Përveç Kushtetutës, Ligji nr. 03/L-215 për Qasje në Dokumente Publike (LQDP) përcakton se zbatimi i tij synon që t'i "[...]garanto[jë] të drejtën e secilit person fizik dhe juridik, pa diskriminim mbi çfarëdo baze, për të pasur qasje, pas kërkesës, në dokumentet e mbajtura, hartuara apo pranuara nga institucionet publike."[2] Ky ligj përcakton parimet, kushtet dhe kufizimet sa i përket qasjes në dokumente publike, dhe rregullat për ushtrimin sa më të lehtë të mundshëm të kësaj të drejte. Pa hyrë në hollësi të mëtejshme mbi mënyrat dhe procedurat e qasjes në dokumente publike, në përputhje me obligimet kushtetuese që i garantojnë qytetarit këtë të drejtë, me rëndësi parësore është zbatimi i këtyre obligimeve në mënyrë të efektshme nga ana e institucioneve dhe ndërmarrjeve publike. Kjo shtron nevojën që ato të vendosin dhe vënë në funksion tërë infrastrukturën e nevojshme ligjore e institucionale, si dhe të posedojnë kapacitetet e nevojshme për përmbushjen e detyrimeve përkatëse.

Sa u përket akteve nënligjore për zbatimin e tij, ky ligj e obligon Qeverinë që brenda tre muajsh pas hyrjes së tij në fuqi të nxjerrë akte nënligjore për zbatimin e tij[3], por megjithatë nuk specifikon as fushëveprimin e as numrin e këtyre akteve. Baza ligjore zbatuese duhet në veçanti të përcaktojnë strukturat, resurset dhe obligimet përkatëse specifike brenda secilit institucion/ndërmarrje publike për komunikim dhe informim publik, si dhe mekanizmat e masat zbatuese për të arritur këtë, përfshirë çështjen e klasifikimit dhe seleksionimit të dokumenteve publike senzitive nga dokumentet publike në të cilat gëzohet e drejta për qasje. Për të përmbushur obligimet përkatëse në kuadër të strukturave e mekanizmave

---

[1] *Kushtetuta e Republikës së Kosovës*, Neni 41, në dispozicion në http://www.assembly-kosova.org/common/docs/Kushtetuta_sh.pdf

[2] *Ligji për Qasje në Dokumente Publike*, neni 1, në dispozicion në http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/2010-215-alb.pdf

[3] Poaty, neni 26, paragrafi 1 dhe 2

zbatues, secili institucion/ndërmarrje publike nevojitet të vendosë infrastrukturën rregullative e teknike përkatëse: reflektimin e resurseve dhe obligimeve në kuadër të strukturës së tyre organizative/organogramit, ekzistencën e Termave të Referencës (TR) dhe Përshkrimeve të Vendeve të Punës (PVP), të cilat përcaktojnë konkretisht përgjegjësitë e strukturës institucionale/organizative për komunikim dhe informim publik dhe detyrat konkrete të stafit përkatës.

Përveç këtyre, zbatimi efektiv i kornizës ligjore e rregullative kërkon ekzistencën e standardeve të brendshme të monitorimit, raportimit dhe vlerësimit të punës së tyre, alokimin e resurseve të mjaftueshme (humane, financiare e teknike) për funksionimin e këtyre strukturave të brendshme, përfshirë zbatimin e dokumenteve të politikave e planeve relevante të punës. Sa u përket dokumenteve të politikave e planeve të punës për zbatimin e këtyre obligimeve kushtetuese e ligjore, komponenti i komunikimit dhe informimit publik duhet të pasqyrohet në të gjitha dokumentet e politikave, të cilat duhet të përmbajnë objektiva dhe aktivitete specifike për përmbushjen e tyre brenda periudhave të caktuara kohore. Së fundi, por jo vetëm kjo, nevojitet ekzistimi i praktikave administrative në mënyrë që brenda secilit institucioni/ndërmarrjeje publike të krijohet dhe zhvillohet një kulturë që promovon komunikimin e rregullt me dhe përfshirjen e mediave dhe organizatave të shoqërisë civile në punën e rregullt të tyre, në veçanti në hartimin, implementimin dhe monitorimin e vlerësimin e implementimit të kornizës ligjore përkatëse dhe asaj të politikave.

II. Përmbledhje e të gjeturave

ITI / KOMP. → / INSTITUCIONI/ NP ↓	1 (0 - 4 / 4 PIKË)	2 (0 - 4 / 4 PIKË)	3 (0 - 4 / 4 PIKË)	4 (0 - 4 / 4 PIKË)	5 (0 - 4 / 4 PIKË)	6 (0 - 4 / 4 PIKË)	7 (0 - 4 / 4 PIKË)	8 (0 - 4 / 4 PIKË)	9 (0 - 4 / 4 PIKË)	10 (0 - 4 / 4 PIKË)	11 (0 - 4 / 4 PIKË)	12 (0 - 4 / 4 PIKË)	13 (0 - 4 / 4 PIKË)	14 (0 - 4 / 4 PIKË)	15 (0 - 4 / 4 PIKË)	16 (0 - 4 / 4 PIKË)	17 (0 - 4 / 4 PIKË)	18 (0 - 4 / 4 PIKË)	19 (0 - 4 / 4 PIKË)	20 (0 - 4 / 4 PIKË)	21 (0 - 4 / 4 PIKË)	22 (0 - 4 / 4 PIKË)	23 (0 - 4 / 4 PIKË)	24 (0 - 4 / 4 PIKË)	25 (0 - 4 / 4 PIKË)	ITI (0 - 100% / 100%), KODI DHE NGJYRAT
DK	4	4	4	4	4	4	4	4	4	4	4	4	4	4	4	4	4	2	1	4	2	4	4	4	4	93 (PLH)
MAPL	2	1	1	4	4	2	2	2	4	2	1	1	2	2	3	4	2	2	2	1	1	4	2	0	4	55 (PJH)
APK	4	2	2	2	2	4	2	2	3	2	2.5	0	1	2	1	2	4	1	1	0	1	4	3.5	3	4	55 (PJH)
MSH	3	2	2	2	3	4	2	2	3	2	4	2	2	2	2	2	3	4	4	2	3	0	0	0	0	55 (PJH)
KUVENDI	4	2	1	0	2	2	2	4	1	1	1	3	4	2	2	2	2	1	1	1	2	4	2	3	4	53 (M)
AKK	4	1	1	2	1	2	2	2	3	2	0.5	0	0.5	1	1	3	2	1	1	1	2	4	3	4	4	48 (M)
KGJK	2	1	4	1	1	2	0	2	2	1	3	1	1	1	3	3	3	4	1	1	0	4	2	0	2.5	45.5 (M)
MIE	3	0	4	4	3	4	2	1	2	3	1	0	0	0	3	3	2	4	0	0	0	4	0	0	2	45 (M)
MPJ	4	3	4	2	2	2	2	2	0	2	1	0	1	2	2	2	2	1	1	1	0	4	3	0	2	45 (M)
ZKM	1.5	1	2	2	2	2	2	2	2	1	1	0	1	2	1	2	4	4	1	1	0	4	2	0	2	42.5 (M)
PTK	1	1.5	0	2	2	4	3	3	2	2	0	0	0	2	2	2	2	2	0	2	0	4	2	0	4	42.5 (M)
MMPH	3	2	2	2	1	4	1	1	1	0	0.5	0	0.5	1	2	1	2	0	2	0	0	4	2	4	3	39 (M)
IAP	3	0	2	0	2	3	2	2	2	2	0	0	0	0	2	2	2	4	0	0	2	4	2	0	3	39 (M)
MD	0.5	1	1	1	1	4	0	1	1	1	0	0	0	0	2	2	4	1	0	0	0	4	1	2	2	29.5 (M)
MZHE	0	1	1	0	0	2	2	0	1	1	0.5	0	0	0	2	2	2	2	1	0	0	4	0	0	3	24.5 (M)

MKK	**0**	**1**	**1**	**1**	**1**	**2**	**2**	**2**	**1**	**1**	**0.5**	**0**	**1**	**1**	**0.5**	**1**	**0**	**4**	**0**	**0**	**0**	**2**	**0**	**0**	**2**	**24 (M)**
****																										
I N D E K S I I T R A N S P A R E N C Ë S I N S T I T U C I O N A L E (AGREGAT) : 45.97 (M)																										

III. Të gjeturat për secilin institucion dhe ndërmarrje publike

Institucionet përfaqësuese

Nga të dyja institucionet përfaqësuese të kontaktuara, vetëm Kuvendi i Republikës së Kosovës i është përgjigjur kërkesës për informata për qëllim të këtij studimi, kurse Zyra e Presidentit të Republikës së Kosovës nuk e ka bërë këtë.

1. Kuvendi i Republikës së Kosovës

Me qëllim të zbatimit të dispozitës kushtetuese që garanton të drejtën e qytetarëve për qasje në dokumente publike (Nenit 41 të saj), Kuvendi i Republikës së Kosovës posedon Rregulloren për Organizimin dhe Përgjegjësitë e Administratës së Kuvendit, Neni 10 i së cilës përkufizon përgjegjësitë e Zyrës për Media dhe Marrëdhënie me Publikun. Kuvendi gjithashtu ka dhënë tekstin e plotë të këtij neni, dhe ka marrë vlerësim maksimal (4 pikë). Më tej, sa i përket aktit nënligjor që përcakton strukturat, resurset dhe obligimet specifike të këtij institucioni për komunikim dhe informim publik, Kuvendi ka dhënë përmbajtjen e plotë të nenit 3 të Rregullores së tij, e cila përcakton vetëm obligimet e këtij institucioni në këtë fushë, por meqë nuk është dhënë asnjë sqarim në lidhje me strukturat e brendshme institucionale dhe resurset që duhen alokuar për zbatimin e këtij obligimi, është vlerësuar me 2 pikë (50%). Vlerësimi për të dy këto pika është i njëjtë si vitin e kaluar.

Sa u përket mekanizmave dhe masave për zbatimin e këtyre dispozitave kushtetuese dhe ligjore, ky institucion ka dhënë një përgjigje të përgjithshme që i referohet punës së shpejtë dhe profesionale si faktor për vlerësimin e performancës së stafit dhe avancimin e tyre në karrierë, por asnjë shpjegim mbi funksionimin e këtij mekanizmi (përfshirë ato të llogaridhënies) dhe kapacitetet ekzistuese për vënien e tij në zbatim, prandaj është vlerësuar me 1 pikë (25%). Më tej, meqë sipas informatave të dhëna, Kuvendi nuk posedon asnjë akt ligjor që rregullon klasifikimin dhe seleksionimin e dokumenteve publike senzitive nga dokumentet publike në të cilat gëzohet e drejta për qasje të pakufizuar në to, e as mekanizma e masa përkatëse zbatuese (është në pritje të miratimit të Ligjit për Klasifikimin e Dokumenteve Zyrtare), vlerësimi i dhënë ka qenë 0 pikë (0%). Sa i përket përdorimit të gjuhëve zyrtare dhe atyre në përdorim nga Kuvendi, është dhënë vetëm përmbajtja e Neneve 78 dhe 79 të Rregullores së Kuvendit, të cilat nene rregullojnë këtë çështje, por nuk është dhënë asnjë shpjegim i masave dhe mekanizmave zbatues, prandaj është vlerësuar me 2 pikë (50%). Vlerësimi i dhënë për këto tri pika është i njëjtë si vitin e kaluar.

Në nivelin e strukturave të brendshme institucionale, është dhënë vetëm përmbajtja e Nenit 10 të Rregullores për Organizimin dhe Përgjegjësitë e Administratës së Kuvendit (i cili përcakton përgjegjësitë e Zyrës për Media dhe Marrëdhënie me Publikun), por asnjë informatë e mëtejme mbi pozitën e saj në organogramin e institucionit dhe mënyrën e funksionimit të saj në kuadër të strukturës së përgjithshme të tij. Prandaj është dhënë vlerësim prej 2 pikë (50%). E njëjta vlen edhe për Termat e Referencës së kësaj zyre (është dhënë pjesa e Nenit 10 të rregullores së lartpërmendur që rregullon obligimet e dy njësive të saj përgjegjëse për përcjelljen dhe publikimin e aktiviteteve të Kuvendit dhe për dokumentet e Kuvendit), por nuk është dhënë asnjë përshkrim i detajuar i TR-ve të Zyrës në tërësi dhe mekanizmave e masave zbatuese, prandaj ka marrë vlerësim prej 2 pikësh (50%). Sa u përket Përshkrimeve të Vendeve të Punës (PVP), është dhënë vetëm përmbajtja e Rregullores për Organizimin dhe Përgjegjësitë e Administratës së Kuvendit që përcakton detyrat e stafit (gjithsej 6) të Zyrës për Media dhe Marrëdhënie me Publikun,

prandaj ka marrë vlerësim prej 2 pikësh (50%). Vlerësim për këto tri çështje është për 2 pikë më pak se vitin e kaluar.

Sa u përket standardeve të raportimit e monitorimit të brendshëm dhe të vlerësimit të punës së zyrtarëve të kësaj Zyre të Kuvendit dhe mekanizmave e masave për zbatimin e këtyre standardeve, Kuvendi ka dhënë vetëm një përshkrim të detajuar për detyrave të përditshme të zyrtarëve, prandaj është vlerësuar me 25% (1 pikë). Në aspektin e resurseve të alokuara Zyrës për Media dhe Marrëdhënie me Publikun, informatat e dhëna u referohen numrit të stafit të saj (prej 7 personash) dhe vëllimit të punës, kurse është theksuar nevoja për më shumë resurse bazuar në një plan paraprak për komunikim dhe informim publik. Vlerësimi i dhënë për këtë pikë është 2 pikë (50%), një më tepër se vitin e kaluar. Të njëjtat të dhëna të kufizuara janë dhënë në lidhje me resurset e alokuara për implementimin e dokumenteve të politikave dhe atyre planifikuese për komunikim dhe informim publik gjatë periudhës që mbulon ky raport (vetëm resurset humane dhe disa përmirësime të resurseve teknike e financiare), por meqë mungojnë të dhëna më të sakta se kaq, është dhënë vlerësimi me 50% (2 pikë, njëjtë si vitin e kaluar).

Sa u përket dokumenteve planifikuese për komunikim dhe informim publik dhe mekanizmave për monitorimin dhe raportimin e rregullt të implementimit të tyre, Kuvendi posedon Planin e Punës së Zyrës për Media dhe Marrëdhënie me Publikun dhe kryhet vlerësimi vjetor i performancës së stafit, kurse nuk është dhënë asnjë e dhënë mbi objektivat e parapara me këtë dokument, prandaj është vlerësuar me 25% (1 pikë), njëjtë si vitin e kaluar. Në nivelin e aktiviteteve, është dhënë një numër aktivitetesh të parapara me Rregulloren për Qasjen e Mediave dhe të Publikut në Punën e Kuvendit, por asgjë në lidhje me masat dhe mekanizmat për monitorim dhe raportim të zbatimit të tyre dhe shpeshtësinë e tyre, prandaj është vlerësuar me 1 pikë (25%), tri pikë më pak se vitin e kaluar. Të dhëna të ngjashme të kufizuara janë dhënë në lidhje me masat që parasheh ky plan për të siguruar qasjen në dokumente publike, në pajtueshmëri të plotë me LQDP-në, dhe mekanizmat e masat për monitorimin dhe raportimin e rregullt të zbatimit të tyre, prandaj është vlerësuar me 1 pikë (25%, 2 pikë më pak se vitin e kaluar).

Më tej, sipas informatave të dhëna, Kuvendi ka komunikim të drejtpërdrejtë të rregullt me media dhe u shpërndan rregullisht informata organizatave të shoqërisë civile, por nuk është dhënë asnjë informatë mbi llojet specifike të aktiviteteve dhe shpeshtësinë e kryerjes së tyre, gjë që është vlerësuar me 50% (2 pikë, njëjtë si vitin e kaluar). I njëjti vlerësim (2 pikë, 50%, njëjtë si vitin e kaluar) është dhënë në lidhje me mediat specifike me të cilat komunikohet, meqë nuk është dhënë asnjë informatë mbi aktivitetet specifike mbi të cilat komunikohet. Sa i përket bashkëpunimit me organizata të shoqërisë civile gjatë periudhës janar 2010 – maj 2011, meqë është dhënë lista e organizatave dhe aktivitetet specifike, është vlerësuar maksimalisht (me 4 pikë, 100%, 2 pikë me tepër se vitin e kaluar).

Edhe sa i përket komunikimit dhe bashkëpunimit me akterët jashtë-qeveritarë në hartimin dhe monitorimin e implementimit të dokumenteve specifike legjislative dhe të politikave, janë dhënë të dhëna të mangëta. Në pikën mbi hartimin e dokumenteve legjislative është dhënë lista e projektligjeve në hartimin e të cilave janë përfshirë organizatat jashtë-qeveritare, por meqë nuk figuron asnjë organizatë vendore, është dhënë vlerësim prej 3 pikësh (75%, 2 më tepër se vitin e kaluar). Në pikën në vijim, që ka të bëjë me përfshirjen e organizatave të shoqërisë civile në hartimin e dokumenteve të politikave dhe atyre planifikuese, është dhënë vlerësim i njëjtë si vitin e kaluar (1 pikë, 25%), pasi që është dhënë vetëm lista e dokumenteve, por nuk është përmendur asnjë organizatë e shoqërisë civile. I njëjti vlerësim si vitin e kaluar (1 pikë, 25%) është dhënë sa i përket përfshirjes së akterëve jashtë-qeveritarë në implementimin e dokumenteve të politikave dhe atyre planifikuese, pasi që nuk është përmendur asnjë organizatë e tillë e përfshirë. E njëjta vlen (1 pikë, 25%, njëjtë si vitin e kaluar) është dhënë mbi përfshirjen e akterëve jashtë-

qeveritarë në monitorimin e implementimit të këtyre lloj dokumentesh, pasi që ky institucion ka përmendur në mënyrë të paqartë 'qeverinë, ministritë përkatëse, mekanizmat vendorë dhe ndërkombëtarë për monitorimin e punës së Kuvendit të Kosovës, shoqërinë civile, grupet e interesit etj.'.

Kuvendi gjithashtu ka konfirmuar se ka ueb-faqen e tij (www.kuvendikosoves.org) dhe ka listuar dokumentet e publikuara aty dhe gjuhët në të cilat ato janë në dispozicion, prandaj është vlerësuar me 4 pikë (100%, njëjtë si vitin e kaluar). Ky institucion gjithashtu ka ndërmarrë masa dhe aktivitete shtesë sa i përket informimit dhe komunikimit me publikun, siç është vendosja e monitorëve në korridore për paralajmërimin e ngjarjeve të parapara (në shqip, serbisht dhe anglisht), ekspozimi i materialeve të Kuvendit si dhe i fletëpalosjeve, buletineve, revistave e publikimeve relevante, për çfarë ka marrë vlerësim prej 100% (4 pikë, njëjtë si vitin e kaluar).

Krejt në fund, Kuvendi ka dhënë listën e zyrtarëve përgjegjës për komunikim dhe informim publik (gjithsej katër zyrtarë, megjithëse me lart thuhet se ka shtatë zyrtarë të tillë), të dy me kualifikime të relativisht relevante për punën që bëjnë, me përvojë prej 9, 8 si dhe 1,5 dhe 1,5, përkatësisht, dhe që kanë ndjekur trajnime me kohëzgjatje prej gjithsej 1 – 3 muaj, dhe është dhënë vlerësimi prej 3,5 pikësh (87,5%, 0,5 pikë më pak se vitin e kaluar).

Për të ***përmbledhur***, bazuar në informatat e dhëna për qëllim të këtij studimi dhe vlerësimin e tyre në përputhje me Sistemin e Pikëve të Transparencës Institucionale (SPTI), ***Kuvendi i Republikës së Kosovës***, me ***Indeksin e Transparencës Institucionale (ITI) prej 50,5 (2,5 më i ulët se vitin e kaluar)***, rezulton të jetë institucion ***i mbyllur***.

Institucionet ekzekutive të nivelit qendror

Informatat për qëllim të studimit të këtij viti kanë dhënë vetëm nëntë (9) institucione ekzekutive të nivelit qendror: Zyra e Kryeministrit, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Integrimit Evropian, Ministria e Komuniteteve dhe Kthimit, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Ministria e Punëve të Jashtme, Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria e Zhvillimit Ekonomik.

Për të ***përmbledhur***, bazuar në informatat e dhëna për qëllime të këtij studimi dhe vlerësimin e tyre në përputhje me Sistemin e Pikëve të Transparencës Institucionale (SPTI), të nëntë ***institucionet ekzekutive të nivelit qendror*** të përfshira në studimin e këtij viti, me ***mesataren e Indeksit të Transparencës Institucionale (ITI) prej 40.5***, rezultojnë se janë institucione ***të mbyllura***.

2. Zyra e Kryeministrit (ZKM)

Zyra e Kryeministrit nuk ka dhënë dispozitën në kuadër të dokumentit ligjor themelues të saj e cila garanton të drejtën për qasje në dokumente publike, por vetëm ka përmendur 'Ligjin për Qasje në Dokumente Publike dhe një numër të madhe dokumentesh të tjera', prandaj është vlerësuar me 1,5 pikë (37,5%, 1,5 pikë më pak se vitin e kaluar). Sa i përket aktit nënligjor që përcakton strukturat, resurset dhe obligimet për komunikim dhe informim publik për zbatimin e këtyre dispozitave, ZKM ka përmendur vetëm Rregulloren nr. 03/2011 për Shërbimin e Komunikimit Qeveritar me Publikun, por nuk është dhënë asnjë shpjegim mbi strukturat e brendshme institucionale dhe resurset që duhen alokuar për zbatimin e këtij obligimi, prandaj është vlerësuar me 1 pikë (25%, 1 pikë më pak se vitin e kaluar). Sa u përket mekanizmave dhe masave zbatuese të parapara me këtë akt

nënligjor, ZKM ka përmendur se rregullorja e lartpërmendur parasheh 'kompletimin e Zyrës për Komunikim me Publikun në nivel qendror dhe lokal me zyrtarë përgjegjës për secilin aspekt të komunikimit me publikun' dhe 'krijimin e Njësisë për komunikim me qytetarë', por pasi që nuk ka dhënë asnjë shpjegim shtesë, është vlerësuar me 2 pikë (50%, 1 pikë më tepër se vitin e kaluar).

Sa i përket rregullimit të çështjes së klasifikimit dhe seleksionimit të dokumenteve publike, ZKM ka përmendur Udhëzimin Administrativ mbi Parimet, Procedurat dhe Shenjat e Klasifikimit të Dokumenteve Publike si bazë ligjore, dhe ka specifikuar se Njësia e saj për Komunikim me Qytetarë 'është përgjegjëse që në bazë të legjislacionit në fuqi të vlerësojë se cila është njësia brenda institucionit publik që duhet ta ketë dokumentin'. Pasi që nuk ka dhënë asnjë shpjegim më tepër, është vlerësuar me 2 pikë (50%, 1 pikë më tepër se vitin e kaluar). Më tej, në nivelin e rregullimit të çështjes se përdorimit të gjuhëve, ZKM ka përmendur Ligjin mbi Përdorimin e Gjuhëve dhe Komisionin përkatës, i cili funksionon në kuadër të ZKM-së (por ky komision është strukturë nacionale për këtë çështje, jo specifikisht e ZKM-së), por nuk ka dhënë asnjë shpjegim mbi mekanizmat dhe masat zbatuese, prandaj është vlerësuar me 2 pikë (50%, 1 pikë më tepër se vitin e kaluar).

ZKM ka deklaruar se organogrami i saj parasheh funksionimin e Zyrës për Komunikim Publik në kuadër të strukturës së saj, gjë që është përcaktuar me Rregulloren nr. 03/2011 mbi Shërbimin e Komunikimit Qeveritar me Publikun, por pasi që nuk ka dhënë asnjë shpjegim shtesë mbi pozitën e saj në hierarkinë e ZKM-së, është vlerësuar me 2 pikë (50%, 2 pikë më pak se vitin e kaluar). ZKM gjithashtu ka deklaruar se në kuadër të kësaj rregulloreje janë të integruar Termat e Referencës së Zyrës për Komunikim Publik, dhe ka dhënë numrin e stafit të saj (5 zyrtarë), por meqë nuk është dhënë asnjë shpjegim mbi mekanizmat dhe masat zbatuese, është vlerësuar me 2 pikë (50%, 1 pikë më tepër se vitin e kaluar). E njëjta vlen (1 nga 4 pikë, 50%, njëjtë si vitin e kaluar) për Përshkrimet e Vendeve të Punës së këtyre zyrtarëve, pasi që vetëm është thënë se ato ekzistojnë në kuadër të së njëjtës rregulloreje, bazohen në Ligjin për Shërbimin Civil dhe i posedon secili zyrtar në dosjen personale, por nuk është dhënë asnjë shpjegim shtesë mbi detyrat dhe obligimet e secilit zyrtar. Sa u përket standardeve të raportimit e monitorimit të brendshëm dhe të vlerësimit të punës, ZKM ka deklaruar se monitorimi dhe raportimi 'kryesisht bëhen përmes sistemit të vlerësimit të punës së secilit nëpunës për periudhën njëvjeçare (vlerësimi vjetor i punës) nga secili udhëheqës për vartësit e tij', dhe është vlerësuar me 2 pikë, (50%, njëjtë si vitin e kaluar) për shkak se nuk ka dhënë asnjë shpjegim mbi funksionimin e mekanizmave dhe masave zbatuese në kuadër të hierarkisë së brendshme të këtij institucioni.

Vlerësimi i dhënë në pikën që ka të bëjë me resurset e alokuara gjatë periudhës janar 2010 – maj 2011 është 25% (1 pikë, përkatësisht 1 pikë më tepër se vitin e kaluar), pasi që vetëm është thënë se Zyrës për Komunikim me Publikun i janë alokuar mjete financiare në kuadër të buxhetit të ZKM-së për realizimin e detyrave të saj, pra mungojnë të dhëna mbi planifikimin e resurseve për këtë Zyrë dhe alokimin e tyre. Në pikën që ka të bëjë me resurset e alokuara me rastin e miratimit të dokumenteve të politikave dhe planit vjetor të punës, është dhënë vlerësimi prej 50% (2 pikë, njëjtë si vitin e kaluar), pasi që vetëm është thënë se është paraparë mbulesë buxhetore për realizimin e të gjitha aktiviteteve të parapara, pa përmendur asnjë dokument të këtillë konkret të ZKM-së, asnjë aktivitet konkret të planifikuar dhe asnjë të dhënë mbi shumën e resurseve të alokuara. Sa u përket resurseve të alokuara për periudhën njëvjeçare në vijim, ZKM ka deklaruar se plani buxhetor i saj mbulon të gjitha aktivitetet e parapara me planin e punës, por pasi që nuk është thënë asgjë specifike mbi resurset financiare dhe për resurset teknike, vlerësimi i dhënë është 2 pikë (50%, 1 pikë më pak se vitin e kaluar).

Për dallim nga viti i kaluar, kur ZKM ka deklaruar se Zyra e saj për Komunikim Publik ka Strategjinë e Komunikimit dhe Planin Vjetor të Punës, këtë herë është përmendur vetëm plani i punës, për realizimin e objektivave strategjikë në kuadër të të cilit është thënë se raportohet çdo tre muaj, por pasi që nuk është përmendur asnjë prej këtyre objektivave e as janë shpjeguar të gjitha masat për monitorim dhe raportim, është dhënë vlerësimi prej 25% (1 pikë, njëjtë si vitin e kaluar). Më tej, në lidhje me aktivitetet e parapara në kuadër të këtij plani vjetor për të siguruar qasjen në dokumente zyrtare, ZKM vetëm ka ripërsëritur obligimin ligjor dhe kërkesën për përmbushjen e tij, e cila është përgjigje jo-relevante, prandaj ka marrë vlerësimin prej 0% (0 pikë, njëjtë si vitin e kaluar). Një vlerësim pak më lartë, (1 pikë 25%, 1 pikë më tepër se vitin e kaluar) është dhënë në pikën në lidhje me aktivitetet e parapara për këtë vit me qëllim të implementimit të obligimeve ligjore të ZKM-së për komunikim dhe informim publik, pasi që është ripërsëritur se raportet tremujore janë mekanizmi kryesor monitorues, përfshirë monitorimin e sigurimit të qasjes në dokumente zyrtare, varësisht nga numri i kërkesave.

Bazuar në informatat e dhëna në kuadër të këtij hulumtimi, Kryeministria ka komunikim direkt dhe të rregullt me të gjitha mediat në Kosovë, kryesisht për njoftimin e publikut mbi aktivitetet e ZKM-së dhe përgjigjes ndaj interesimit të mediave për çështje të ndryshme. Sidoqoftë, nuk është thënë asgjë në lidhje me komunikimin me organizatat e shoqërisë civile dhe shpeshtësinë e tij, prandaj është vlerësuar me 25% (1 pikë, 1 më pak se vitin e kaluar). I njëjti vlerësim si vitin e kaluar (2 pikë, 50%) është dhënë sa i përket komunikimit të rregullt me mediat, pasi që vetëm është deklaruar se ka komunikim me të gjitha mediat nacionale dhe një numër të konsiderueshëm të mediave lokale, por nuk është shpjeguar asgjë mbi aktivitetet për të cilat komunikohet me to. Në anën tjetër, gjendja duket të jetë përmirësuar krahasuar me vitin e kaluar sa i përket përfshirjes së organizatave të shoqërisë civile: janë listuar nëntë organizata të tilla (kryesisht në fushën e të drejtave të njeriut), si dhe aktivitetet konkrete në të cilat janë përfshirë dhe kohëzgjatjen e kësaj përfshirjeje, prandaj është vlerësuar maksimalisht (4 pikë, 50%., 2 më tepër se vitin e kaluar).

I njëjti vlerësim (4 pikë, 100%, 3 pikë më tepër se vitin e kaluar) është dhënë në pikën mbi projektligjet e sponsorizuara nga ZKM, pasi që janë listuar projektligjet e sponsorizuara (gjithsej 8) dhe akterët jashtë-qeveritarë të përfshirë në hartimin e tyre. Megjithatë, kur jemi te përfshirja e akterëve jashtë-qeveritarë në hartimin e dokumenteve të politikave të sponsorizuara nga ZKM, janë përmendur vetëm dy dokumente (Deklarata e Prioriteteve të Qeverisë për Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve dhe Plani i Veprimit për Zbatimin e Vizionit Ekonomik 2011 – 2014) dhe një numër ministrish relevante dhe donatorësh (gjë që është përgjigje jo-adekuate), prandaj është dhënë vlerësimi prej 1 pikë (50%, 2 pikë më pak se vitin e kaluar). Sa i përket implementimit të dokumenteve të politikave nën përgjegjësinë e ZKM-së dhe akterëve jashtë-qeveritarë të përfshirë në implementimin e tyre, është dhënë vlerësimi prej 1 pikë (25%, 1 pikë më tepër se vitin e kaluar), pasi që është dhënë lista e dokumenteve të politikave në implementimin e të cilit është e përfshirë ZKM, por nuk është dhënë asnjë informatë mbi akterët jashtë-qeveritarë të përfshirë në këtë proces. I njëjti vlerësim si vitin e kaluar (0 pikë, 0%) është dhënë në lidhje me akterët jashtë-qeveritarë të përfshirë në monitorimin dhe vlerësimin e zbatimit të dokumenteve të politikave, pasi që vetëm është deklaruar se 'organizata të ndryshme ndërkombëtare e vendore bëjnë vlerësimin dhe monitorimin e dokumenteve të politikave për çështje të ndryshme ose specifike.'.

ZKM ka deklaruar se posedon ueb-faqen e saj (www.kryeministri-ks.net), e cila përmban një numër të madh dokumentesh në gjuhët zyrtare. Vlerësimi i dhënë për këtë është 100% (4 nga 4 pikë). Më tej, pika në lidhje me masat dhe aktivitetesh shtesë të ndërmarra nga ZKM është vlerësuar me 0 pikë (0%, 1 pikë më pak se vitin e kaluar), pasi që ZKM ka deklaruar se nuk ka kryer asnjë aktivitet shtesë gjatë periudhës që mbulon ky raport. Në fund, ZKM ka dhënë listën e zyrtarëve përgjegjës për komunikim dhe informim publik

(gjithsej 6 zyrtarë), nga të cilët 4 nuk posedojnë kualifikime adekuate, kurse përvoja e të gjithëve sillet nga 3 deri në 9 vjet (megjithëse nuk është thënë asgjë në lidhje me relevancën e saj), dhe kanë ndjekur trajnime me kohëzgjatje prej gjithsej 1 javë – 3 muaj. Prandaj është dhënë vlerësimi prej 2 pikë (50%, 0,5 pikë më pak se vitin e kaluar.

Për të ***përmbledhur***, bazuar në informatat e dhëna për qëllim të këtij studimi dhe vlerësimin e tyre në përputhje me Sistemin e Pikëve të Transparencës Institucionale (SPTI), ***Zyra e Kryeministrit***, me ***Indeksin e Transparencës Institucionale (ITI) prej 42.5*** (1 pikë më tepër se vitin e kaluar), rezulton të jetë institucion ***i mbyllur***.

3. Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL)

Sa i përket zbatimit të dispozitave kushtetuese e ligjore për qasje në dokumente publike përmes përkthimit të kësaj në dokumentin që themelon MAPL-në, kjo ministri ka dhënë informata pjesërisht të sakta: ajo i është referuar Ligjit për Qasje në Dokumente Zyrtare (i cili nuk rregullon specifikisht punën e MAPL-së), dhe ka dhënë nenin që përcakton qëllimin e Rregullores për Shërbimin e Komunikimit Qeveritar me Publikun, prandaj ka marrë vlerësim prej 2 pikësh (50%, 2 pikë më tepër se vitin e kaluar). Megjithatë, akti nënligjor që rregullon strukturën e brendshme organizative të MAPL-së përmban një dispozitë që rregullon funksionimin e Zyrës për Informim në kuadër të saj (përkatësisht neni 7 i UA nr. 2010/02 për Organizmin dhe Strukturimin e Brendshëm të MAPL-së, mbi detyrat dhe përgjegjësitë e Zyrës për Informim), kurse janë përmendur edhe dy akte të tilla: UA nr. 2008/09 për Transparencë në Komuna dhe Vendimi për Krijimin e Nëngrupeve Punese për Vazhdimin e Implementimit të Planit të Veprimit për Decentralizmin. Përveç kësaj, nuk është dhënë asnjë shpjegim në lidhje me strukturat, resurset dhe obligimet e përcaktuara nga këto akte nënligjore, prandaj është vlerësuar me 1 pikë (25%, 1 pikë më pak se vitin e kaluar). Sa u përket mekanizmave dhe masave zbatuese të përpara me këto akte nënligjore, MAPL vetëm ka deklaruar se UA mbi Organizmin dhe Strukturimin e Brendshëm të saj rregullon funksionimin e Zyrës së saj për Informim, por nuk është dhënë asnjë shpjegim në lidhje me funksionimin e mekanizmave të brendshëm që sigurojnë zbatimin e kësaj dispozite. Prandaj vlerësimi i dhënë është 1 pikë (25%, 1 pikë më pak se vitin e kaluar).

Më tej, MAPL ka shpjeguar në tërësi mënyrën e rregullimit të çështjes së klasifikimit dhe seleksionimit të dokumenteve publike, sipas Ligjit për Klasifikimin e Dokumenteve Zyrtare, dhe ka specifikuar plotësisht përmbajtjen e dispozitave përkatëse, prandaj është vlerësuar me 4 pikë (100%, 4 më tepër se vitin e kaluar). Çështjen tjetër, atë të përdorimit të gjuhëve zyrtare dhe atyre në përdorim në Kosovë, kjo ministri e rregullon përmes Rregullores për Përdorimin e Gjuhëve dhe UA për Përdorimin e Gjuhëve, kurse si mekanizma dhe masa zbatuese shërben monitorimi i rregullt i zbatimit të Ligjit mbi Përdorimin e Gjuhëve dhe akteve të tjera ligjore, për çfarë gjithashtu përgatiten raporte periodike. Një mekanizëm tjetër është edhe pjesëmarrja direkte në Komisionin Qeveritar për Përdorimin e Gjuhëve, i cili vepron në kuadër të Zyrës së Kryeministrit. Kjo pikë është vlerësuar me 100% (4 pikë, njëjtë si vitin e kaluar).

Sipas informatave të dhëna nga kjo ministri, Zyra për Informim e MAPL-së është pjesë përbërëse e strukturës organizative të saj dhe përbëhet nga katër zyrtarë, por meqë mungojnë të dhëna më të detajuara mbi funksionimin e saj në kuadër të strukturës së MAPL-së, është dhënë vlerësim prej 1 pikë (1 pikë, 25%, 3 pikë më pak se vitin e kaluar). Sa u përket Termave të Referencës së Zyrës për Informim, MAPL ka dhënë përmbajtjen e tyre, por pasi që nuk është dhënë ndonjë shpjegim në lidhje me mekanizmat dhe masat zbatuese, është dhënë vlerësim prej 2 pikësh (50%, 2 pikë më tepër se vitin e kaluar). Kurse sa u përket Përshkrimeve të Vendeve të Punës, MAPL ka deklaruar se zyra ka TR të specifikuar më sipër (por nuk është e qartë a posedon vërtet PVP), prandaj është vlerësuar

me 2 pikë (50%, njëjtë si vitin e kaluar). MAPL ka deklaruar se posedon standarde të raportimit e monitorimit të brendshëm, të cilat janë raportet javore, tremujore, gjashtëmujore dhe vjetore, kurse si mekanizëm dhe masë zbatuese është krahasimi me realizimin e aktiviteteve të planifikuara në kuadër të planit të punës së Zyrës për Informim, dhe është vlerësuar me 4 pikë (100%, 3 pikë më tepër se vitin e kaluar).

Në aspektin e alokimin të resurseve departamentit përgjegjës për komunikim dhe informim publik gjatë periudhës janar 2010 – maj 2011, MAPL ka deklaruar se buxheti alokohet çdo vit bazuar në planin vjetor të punës, i cili miratohet nga menaxhmenti dhe stafi politik i Ministrisë, por meqë nuk janë dhënë shpjegime të hollësishme mbi aktivitetet e planifikuara dhe shumën e përafërt të resurseve, vlerësimi i dhënë është 2 pikë (50%, 1 pikë më tepër se vitin e kaluar). I njëjti vlerësim (2 pikë, 50%, 1 pikë më tepër se vitin e kaluar) është dhënë në pikën mbi resurset e alokuara për implementimin e komponentëve të dokumenteve të politikave dhe atyre planifikuese për komunikim dhe informim publik, pasi që vetëm është deklaruar se buxheti vjetor i Ministrisë parasheh këto resurse, por nuk është dhënë asnjë shpjegim mbi shumën e tyre dhe raportin në mes të resurseve të kërkuara dhe të alokuara. I njëjti vlerësim (2 pikë, 50%, 1,5 pikë më tepër se vitin e kaluar), është dhënë në pikën në lidhje me resurset e alokuara për vitin vijues, pasi që vetëm janë dhënë vetëm të dhëna mbi numrin e stafit dhe disa pajisje teknike, si dhe është thënë se burimet financiare janë pjesë e buxhetit vjetor të Ministrisë, por mungojnë shpjegime konkrete në lidhje me shumën e resurseve të të gjitha kategorive (humane, financiare e teknike) të parapara me Planin Vjetor të Punës së kësaj zyre.

Vlerësimi prej 1 pikë (25%, 1,5 pikë më pak se vitin e kaluar) është dhënë në pikën që ka të bëjë me dokumentet e politikave të kësaj ministrie për komunikim dhe informim publik, pasi që është specifikuar titulli dhe u është referuar komponentëve për komunikim dhe informim publik (Plani Vjetor i Punës së Zyrës për Informim, që përfshin plane specifike për komunikim me media, për fushatën informuese të decentralizmit, për fuqizimin e transparencës në komuna dhe ai për fushatën Informuese për rolin e qytetarit në vendimmarrje), por nuk janë formuluar në formë objektivash e as janë dhënë shpjegime mbi mekanizmat e masat për monitorim dhe raportimin e rregullt të implementimit të tyre. Sa u përket mekanizmave dhe masave konkrete të parapara nga dokumentet e politikave të MAPL-së për të siguruar qasjen në dokumente publike dhe mekanizmat e masat për monitorimin dhe raportimin e rregullt të zbatimit të tyre, MAPL vetëm ka deklaruar se kjo realizohet përmes raportimit të rregullt mbi realizimin e politikave për qasje në dokumente zyrtare, por nuk është thënë asgjë mbi përmbajtjen e këtyre aktiviteteve, e nuk ka as shpjegime të hollësishme mbi mënyrën e vënies në zbatim të mekanizmave dhe masave zbatuese, prandaj është vlerësuar me 1 pikë (25%, 1 pikë më pak se vitin e kaluar). Nga ana tjetër, MAPL ka listuar komponentin që ka të bëjë me komunikim dhe informim publik në kuadër të planit të punës së MAPL-së, si dhe një pjesë të masave e mekanizmave për raportim dhe monitorim (raportet dhe vlerësimet e rregullta të performancës së zyrtarëve), por meqë nuk janë listuar aktivitetet konkrete në kuadër të këtij komponenti, e as shpjegime më të detajuara mbi mekanizmat dhe masat për monitorimin dhe raportimin e rregullt të kryerjes së tyre, është vlerësuar me 2 pikë (50%, 2 pikë më tepër se vitin e kaluar).

MAPL ka deklaruar se ka vendosur komunikim të rregullt e drejtpërdrejtë me të gjitha mediat dhe organizatat e shoqërisë civile, varësisht nga aktivitetet dhe kërkesat e mediave për të marrë informata, por pasi që nuk kanë shpjeguar më në hollësi shpeshtësinë e komunikimit me to, ka marrë vlerësim prej 3 pikësh (75%, 1 pikë më pak se vitin e kaluar). Më tej, kjo ministri ka dhënë një listë të gjatë të mediave më të cilat ka komunikim të rregullt dhe të aktiviteteve për të cilat komunikohet (konferenca për media, takime formale dhe joformale me gazetarë, komunikata, njoftime, intervista, përgjigje në pyetjet e drejtuara nga gazetarët, dërgimit të informatave mbi aktivitetet e ministrisë dhe tema të caktuara) dhe është vlerësuar me 4 pikë (100%, njëjtë si vitin e kaluar). MAPL

gjithashtu është dhënë lista e organizatave të shoqërisë civile të përfshira në realizimin e planit të punës së Zyrës për Informim, por meqë nuk është dhënë një shpjegim më i plotë mbi llojet e përfshirjes me secilën prej tyre (shkëmbim informatash, konsultime, bashkëpunim ose partneritet), është vlerësuar me 2 pikë (75%, 1 pikë më pak se vitin e kaluar).

Kjo ministri ka dhënë listën e projektligjeve që ka sponsorizuar gjatë këtij viti dhe ka deklaruar se shoqëria civile është përfshirë në hartimin e tyre, por meqë nuk ka shpjeguar specifikisht cila organizatë e shoqërisë civile është përfshirë në hartimin e secilit projektligji, është vlerësuar me 2 pikë (50%, njëjtë si vitin e kaluar). I njëjti vlerësim (prej 2 pikësh, 50%, 1 pikë më tepër se vitin e kaluar), në ndërlidhje me përfshirjen e akterëve jashtë-qeveritarë në hartimin e dokumenteve të saj të politikave për komunikim dhe informim publik, MAPL ka dhënë listën e dokumenteve të politikave të hartuara gjatë periudhës janar 2010 – maj 2011, por pasi që nuk është dhënë lista e akterëve të përfshirë është vlerësuar me 2 pikë (25%, 1 pikë më tepër se vitin e kaluar). I njëjti vlerësim si vitin e kaluar (1 pikë, 25%) është dhënë sa i përket përfshirjes së këtyre lloj akterësh në implementimin e dokumenteve të politikave, pasi që është dhënë lista e dokumenteve të politikave, por mungon lista e akterëve të përfshirë dhe llojet e aktiviteteve përkatëse të realizuar. I njëjti vlerësim (1 pikë, 25%, 0.5 pikë më pak se vitin e kaluar) është dhënë sa i përket përfshirjes së akterëve jashtë-qeveritarë në monitorimin dhe vlerësimin e implementimit të dokumenteve të politikave, pasi që të gjithë akterët e listuar janë organizata të huaja, por nuk është thënë asgjë në lidhje me përfshirjen e akterëve vendorë dhe kohëzgjatjen e përfshirjes së tyre.

Në ndërkohë, pika që ndërlidhet me ueb-faqen e kësaj ministrie është vlerësuar maksimalisht (4 nga 4 pikë, 100%), pasi që është deklaruar se kjo ministri posedon ueb-faqen e saj zyrtare (www.mapl.rks-gov.net), gjë që mund të monitorohet lehtë. Meqë MAPL nuk ka deklaruar të ketë ndërmarrë kurrfarë masash dhe aktivitetesh shtesë sa i përket informimit dhe komunikimit me publikun, është vlerësuar në këtë pikë me 0 pikë (0%, njëjtë si vitin e kaluar). Në fund, kjo ministri ka dhënë listën e zyrtarëve përgjegjës për komunikim dhe informim publik (gjithsej 2 zyrtarë), të dy prej të cilëve posedojnë kualifikime adekuate, kurse përvoja e punës është 6 vjet, përkatësisht 1 vit, dhe kanë ndjekur trajnime relevante me kohëzgjatje nga përkatësisht 8 vjetësh, dhe që kanë ndjekur trajnime me kohëzgjatje prej 1 javë – 1 muaj, prandaj është dhënë vlerësimi prej 4 pikësh (100%, 0.5 pikë më tepër se vitin e kaluar).

Për të ***përmbledhur***, bazuar në informatat e dhëna për qëllim të këtij studimi dhe vlerësimin e tyre në përputhje me Sistemin e Pikëve të Transparencës Institucionale (SPTI), ***Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal***, me ***Indeksin e Transparencës Institucionale (ITI) prej 55*** (8 pikë më tepër se vitin e kaluar), rezulton se është institucion ***pjesërisht i hapur***.

4. Ministria e Drejtësisë (MD)

Ministria e Drejtësisë nuk është përzgjedhur për studimin e vitit të kaluar. Sa i përket reflektimit të dispozitave kushtetuese dhe ligjore për komunikim dhe informim publik në kuadër të dokumentit themelues të kësaj ministrie, MD vetëm ka përmendur Ligjin për Qasje në Dokumente Publike dhe Rregulloren mbi Shërbimet e Komunikimit Qeveritar me Publikun, por meqë nuk është dhënë përmbajtja e dispozitave përkatëse as në kuadër të këtyre dy dokumenteve e as të dokumentit ligjor themelues të MD-së, është vlerësuar me 0.5 pikë (12,5%). Përgjigje ngjashëm e kufizuar është dhënë në ndërlidhje me aktin nënligjor që përcakton obligimet, strukturat dhe resurset e kësaj ministrie për komunikim dhe informim publik, pasi që kjo ministri i është referuar vetëm Rregullores mbi Shërbimet e Komunikimit Qeveritar me Publikun, por pasi që nuk është dhënë asnjë shpjegim shtesë

nëse dhe si zbatohet kjo në kuadër të strukturave të brendshme të MD-së përgjegjëse për komunikim dhe informim publik, e as mbi strukturat, resurset dhe obligimet konkrete që rrjedhin nga dokumentet përkatëse ligjore, është vlerësuar me 1 pikë (25%). I njëjti vlerësim (1 pikë, 25%) është dhënë në pikën mbi mekanizmat dhe masave zbatuese të përpara me aktet përkatëse nënligjore, pasi që MD vetëm ka deklaruar se Zyra e saj për Informim 'siguron komunikim efektiv [dhe] ofron raportim të saktë dhe të qartë për aktivitetet e institucioneve publike për grupet e synuara ose palët e interesuara.', por nuk është dhënë asnjë shpjegim mbi funksionimin e mekanizmave të brendshëm që sigurojnë zbatimin e kësaj dispozite.

Sipas informatave të dhëna, MD ka rregulluar pjesërisht çështjen e klasifikimit dhe seleksionimit të dokumenteve publike, pasi që ka deklaruar se kjo është e rregulluar vetëm sipas nenit 12 të Ligjit për Qasje në Dokumente Publike, duke mos dhënë as përmbajtjen e dispozitës përkatëse e as ndonjë shpjegim mbi mekanizmat dhe masat zbatuese, prandaj është vlerësuar me 1 pikë (25%). I njëjti vlerësim (prej 1 pike, 25%) është dhënë sa i përket rregullimit të çështjes së përdorimit të gjuhëve zyrtare dhe atyre në përdorim, pasi që MD ka përmendur vetëm Ligjin për Përdorimin e Gjuhëve dhe Komisionin përkatës të nivelit nacional, kurse nuk është dhënë asnjë shpjegim shtesë mbi mënyrën se si 'përkthehen' në praktikë dispozitat e këtij ligji dhe mekanizmat e masat zbatuese që dalin nga puna e këtij komisioni, prandaj është vlerësuar me 1 pikë (25%).

Sipas informatave të dhëna, Zyra për Informim e MD-së është pjesë përbërëse e strukturës organizative të saj dhe funksionon në kuadër të Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm, dhe është vlerësuar me 4 pikë (100%). Sa u përket Termave të Referencës së Zyrës për Informim, kjo ministri ka deklaruar se ka themeluar një komision për hartimin e një rregulloreje për organizimin, sistematizimin e përshkrimin e vendeve të punës së të gjitha njësive e strukturave të saj, që nënkupton se akoma nuk posedon as TR të Zyrës për Informim, prandaj është vlerësuar me 0 pikë (0%). Kurse sa u përket Përshkrimeve të Vendeve të Punës, MD ka deklaruar se stafi i saj përgjegjës për komunikim dhe informim publik vepron duke u bazuar në detyrat dhe përgjegjësitë e përcaktuara me Rregulloren mbi Shërbimin e Komunikimit Qeveritar me Publikun, dhe është vlerësuar me 1 pikë (25%), pasi që nuk ka dhënë asnjë shpjegim shtesë mbi atë se si zbatohen këto përgjegjësi dhe obligime në nivel të përshkrimit të vendeve të punës. Edhe sa u përket standardeve të raportimit e monitorimit të brendshëm MD është vlerësuar me 1 pikë (25%), pasi që vetëm kanë deklaruar përgjithësisht se monitorimi dhe vlerësimi i punës kryhen në përputhje me rregulloren e lartpërmendur dhe legjislacionin në fuqi për Shërbimin Civil, pra mungojnë të dhëna më të hollësishme mbi mekanizmat dhe masat konkrete të kryerjes së tyre, e as mbi shpeshtësinë e këtyre mekanizmave e masave.

Në aspektin e alokimin të resurseve departamentit përgjegjës për komunikim dhe informim publik gjatë periudhës janar 2010 – maj 2011, MD ka dhënë shumën e buxhetit të alokuar Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë (në kuadër të së cilës zyrë funksionon), por pasi që nuk ka dhënë asnjë informatë e as shpjegime më të hollësishme mbi aktivitetet e planifikuara dhe llojet e tjera të resurseve, vlerësimi i dhënë është 1 pikë (25%). Në anën tjetër, vlerësim prej 0 pikësh (0%) është dhënë sa i përket resurset e alokuara për implementimin e komponentëve të dokumenteve të politikave dhe atyre planifikuese për komunikim dhe informim publik gjatë periudhës janar 2010 – maj 2011, pasi që në këtë pikë MD nuk ka dhënë asnjë informatë. Vlerësim prej 1 pikësh (25%) është dhënë edhe për pikën e mësipërme në lidhje me resurset e alokuara për vitin vijues, pasi që janë mjaftuar me përgjigjen e dhënë në pikën mbi buxhetin e alokuar Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm.

Vlerësim prej 0 pikësh (0%) është dhënë në pikën që ka të bëjë me dokumentet e politikave të kësaj ministrie për komunikim dhe informim publik, pasi që është deklaruar se janë duku punuar në Planin Zhvillimor Strategjik, pjesë e të cilit do të jetë edhe fusha

e komunikimit dhe informimit publik. I njëjti vlerësim (prej 0 pikësh, 0%) është dhënë sa u përket mekanizmave dhe masave konkrete të parapara nga dokumentet e saj të politikave për të siguruar qasjen në dokumente publike dhe mekanizmat e masat për monitorimin dhe raportimin e rregullt të zbatimit të tyre, pasi që vetëm është shprehur përkushtimi i MD-së për të punuar në përputhje me LQDP. Po i njëjti vlerësim (0 pikë, 0%) është dhënë në lidhje me zbërthimin e objektivave në aktivitete konkrete për komunikim dhe informim publik, pasi që nuk është dhënë kurrfarë përgjigje.

MD ka deklaruar se gjatë periudhës janar 2010 – maj 2011 ka pasur komunikim të rregullt me media dhe me secilën organizata të shoqërisë civile të interesuara, por pasi që nuk kanë shpjeguar më në hollësi llojet e aktiviteteve dhe shpeshtësinë e komunikimit me to, ka marrë vlerësim prej 2 pikësh (50%). Njëjtë vlen (vlerësim prej 2 pikësh, 50%) sa u përket mediave me të cilat MD ka pasur komunikim gjatë kësaj periudhe, pasi që vetëm ka listuar disa prej tyre, por nuk ka dhënë asnjë shpjegim mbi llojet e aktiviteteve dhe shpeshtësinë e kryerjes së tyre. Në anën tjetër, kjo ministri ka dhënë listën e organizatave të shoqërisë civile me të cilat ka bashkëpunuar gjatë periudhës janar 2010 – maj 2011, dhe aktivitetet përkatëse, dhe është vlerësuar me 4 pikë (100%).

Kjo ministri ka dhënë listën e projektligjeve që ka sponsorizuar gjatë këtij viti, por meqë nuk ka përmendur asnjë organizatë të shoqërisë civile të përfshirë në hartimin e tyre, është vlerësuar me 1 pikë (25%). Në anën tjetër, vlerësim më pak se kaq (prej 0 pikësh, 0%) është dhënë në ndërlidhje me përfshirjen e akterëve jashtë-qeveritarë në hartimin e dokumenteve të saj të politikave për komunikim dhe informim publik, pasi që përgjigja e dhënë është e pasaktë. I njëjti vlerësim (0 pikë, 0%) është dhënë sa i përket përfshirjes së këtyre lloj akterësh në implementimin e dokumenteve të politikave, pasi që nuk është dhënë asnjë informatë. Po i njëjti vlerësim (0 pikë, 0%) është dhënë sa i përket përfshirjes së akterëve jashtë-qeveritarë në monitorimin dhe vlerësimin e implementimit të dokumenteve të politikave, pasi që përgjigja e dhënë është e pasaktë.

Në ndërkohë, pika që ndërlidhet me ueb-faqen e kësaj ministrie është vlerësuar maksimalisht (4 nga 4 pikë, 100%), pasi që është deklaruar se kjo ministri posedon ueb-faqen e saj zyrtare (www.md-ks.org), ku publikohen sistematikisht të gjitha aktivitetet, legjislacioni, etj., por edhe shpenzimet e MD-së (këto të fundit çdo javë) gjë që gjithashtu mund të monitorohet lehtë. Sa u përket aktiviteteve shtesë për komunikim dhe informim publik të ndërmarrë nga ana e saj, meqë MD ka deklaruar se u janë përgjigjur të gjitha kërkesave të pranuara sa i përket komunikimit dhe informimit publik, është vlerësuar me 2 pikë (50%). Në fund, kjo ministri ka dhënë të dhënat mbi kualifikimet e zyrtarit të saj përgjegjës për komunikim dhe informim publik, i cili posedon kualifikime formale relevante, përvojë pune prej 1 – 5 vitesh dhe trajnime me kohëzgjatje gjithsej 1 – 3 muaj, por meqë nuk janë dhënë më tepër hollësi mbi fushën e përvojës së punës dhe temat e trajnimeve të ndjekura, është vlerësuar me 2 pikë (50%).

Për të ***përmbledhur***, bazuar në informatat e dhëna për qëllim të këtij studimi dhe vlerësimin e tyre në përputhje me Sistemin e Pikëve të Transparencës Institucionale (SPTI), ***Ministria e Drejtësisë***, me ***Indeksin e Transparencës Institucionale (ITI) prej 29,5***, rezulton se është institucion ***i mbyllur***.

5. Ministria e Integrimit Evropian (MIE)

As kjo ministri nuk është përfshirë në studimin e vitit të kaluar, pasi që është themeluar vetëm disa muaj para kryerjes së tij. Sa i përket reflektimit të dispozitave kushtetuese dhe ligjore për komunikim dhe informim publik në kuadër të dokumentit themelues të saj, MIE vetëm ka përmendur Rregulloren për Strukturën Organizative të saj (neni 6 i së cilës parasheh Zyrën për Komunikim dhe Informim), Rregulloren për Shërbimin e Komunikimit

Qeveritar me Publikun (e cila në nenin 10 parasheh funksionet e Zyrës për Komunikim Publik të Ministrive dhe në nenin 12 funksionet e Drejtorit të Zyrës për Komunikim Publik të ministrive), por meqë nuk është dhënë përmbajtja e plotë e të gjitha neneve të listuar, është vlerësuar me 3 pikë (75%). Më tej, MIE ka deklaruar se nuk posedon ndonjë akt nënligjor që përcakton obligimet, strukturat dhe resurset e kësaj ministrie për komunikim dhe informim publik, prandaj është vlerësuar me 0 pikë (0%). Në anën tjetër, vlerësimi prej 4 pikësh (100%) është dhënë në pikën mbi mekanizmat dhe masave zbatuese të përpara me aktet përkatëse nënligjore, pasi që MIE ka listuar detyrat dhe obligimet e Zyrës së saj për Informim dhe ka shpjeguar zbatimin tyre.

Sipas informatave të dhëna, MIE e ka të rregulluar çështjen e klasifikimit dhe seleksionimit të dokumenteve publike sipas Ligjit për Klasifikimin e Informacioneve dhe Verifikimin e Sigurisë së të Dhënave, dhe ka listuar të gjitha masat përkatëse, prandaj është vlerësuar me 4 pikë (100%). Një vlerësim më i ulët (prej 3 pikësh, 75%) është dhënë sa i përket rregullimit të çështjes së përdorimit të gjuhëve zyrtare dhe atyre në përdorim, pasi që kjo ministri ka përmendur Ligjin për Përdorimin e Gjuhëve dhe Komisionin përkatës të nivelit nacional, si dhe masat zbatuese të parapara me ligj dhe që ekzekutohen nga ky institucion, por nuk ka dhënë shpjegime shtesë mbi mënyrën e zbatimit të obligimeve që dalin nga ky ligj.

Sipas informatave të dhëna, Zyra për Informim e MIE-së është pjesë përbërëse e Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm, të cilit edhe i raporton, si dhe ka treguar se organogrami mund të gjendet në ueb-faqen e kësaj ministrie, dhe është vlerësuar me 4 pikë (100%). Sa u përket Termave të Referencës së Zyrës për Informim, kjo ministri ka deklaruar se ato janë të përcaktuar me Rregulloren për Shërbimin e Komunikimit Qeveritar me Publikun, por pasi që nuk janë dhënë shpjegime më të hollësishme mbi mekanizmat dhe masat për zbatimin e këtyre obligimeve, është dhënë vlerësim prej 2 pikësh (50%). Vlerësim i ngjashëm (prej 1 pikësh, 25%) është dhënë sa u përket Përshkrimeve të Vendeve të Punës, pasi që MIE ka deklaruar se e njëjta rregullore përcakton edhe PVP-të, por nuk ka dhënë shpjegime me të hollësishme mbi këtë çështje. Sa u përket standardeve të raportimit e monitorimit të brendshëm, MIE është vlerësuar me 2 pikë (50%), pasi që vetëm kanë deklaruar se vlerësimi i punës kryhet rregullisht (në baza vjetore), kurse standard i raportimit është niveli i zbatimit të përgjegjësive të PVP', dhe nuk kanë dhënë shpjegime më të hollësishme mbi mekanizmat dhe masat konkrete të kryerjes së tyre, e as mbi shpeshtësinë e këtyre mekanizmave e masave.

Në aspektin e alokimit të resurseve departamentit përgjegjës për komunikim dhe informim publik gjatë periudhës janar 2010 – maj 2011, MIE ka deklaruar se Zyra e saj për Komunikim dhe Informim është krijuar në maj 2011, posedon të gjitha resurset e nevojshme financiare dhe teknike dhe dy zyrtarë, por meqë është deklaruar se ka nevojë për më tepër zyrtarë, është vlerësuar me 3 pikë (75%). Në anën tjetër, vlerësim prej 0 pikësh (0%) është dhënë sa i përket resurseve të alokuara për implementimin e komponentëve të dokumenteve të politikave dhe atyre planifikuese për komunikim dhe informim publik gjatë periudhës janar 2010 – maj 2011, pasi që në këtë pikë MIE nuk ka dhënë asnjë informatë. I njëjti vlerësim (prej 0 pikësh, 0%) është dhënë në pikën mbi resurset e alokuara për vitin vijues, pasi që nuk është dhënë asnjë informatë.

Vlerësim prej 1 pike (25%) është dhënë në pikën që ka të bëjë me dokumentet e politikave të kësaj ministrie për komunikim dhe informim publik, pasi që janë listuar një numër çështjesh fokusi në draft-strategjinë e kësaj ministrie për Komunikim dhe Informim, e cila është në hartim e sipër, dhe si e tillë nuk është akoma nuk është në fuqi. Në anën tjetër, vlerësim prej 0 pikësh (0%) është dhënë sa u përket mekanizmave dhe masave konkrete të parapara nga dokumentet e saj të politikave për të siguruar qasjen në dokumente publike dhe mekanizmat e masat për monitorimin dhe raportimin e rregullt të zbatimit të tyre, pasi që është deklaruar se strategjia e sipërpërmendur do të parashohë, në mes të

tjerash, një zyrtar përgjegjës për shqyrtimin e kërkesave për qasje në dokumente zyrtare, por kjo strategji akoma nuk është në fuqi. Po i njëjti vlerësim (0 pikë, 0%) është dhënë në lidhje me aktivitetet konkrete për komunikim dhe informim publik, megjithëse është deklaruar se strategjia në fjalë do të parashohë monitorim, raportim dhe vlerësime (përfshirë ato nga jashtë) të zbatimit të LQDP.

MIE ka deklaruar se gjatë periudhës janar 2010 – maj 2011 ka pasur komunikim të rregullt me media dhe me organizata të shoqërisë civile të interesuara, si dhe ka listuar disa aktivitete konkrete (takime të rregullta javore me Zyrën për Informim, takime me Ministren e me zyrtarë të tjerë, konsultime në hartimin e Rregullores për Zyrat për Integrim Evropian në nivelin komunal), dhe është vlerësuar me 3 pikë (75%). Njëjtë vlen (vlerësim prej 3 pikësh, 75%) sa u përket mediave me të cilat MIE ka pasur komunikim gjatë kësaj periudhe, pasi që është thënë se ka komunikim të rregullt me të gjitha mediat dhe janë listuar aktivitetet kryesore (që kanë të bëjnë kryesisht me zhvillimet rreth integrimit evropian). Në anën tjetër, kjo ministri vetëm ka shpjeguar në përgjithësi se gjatë kësaj periudhe ka bashkëpunuar me organizata të shoqërisë civile në informimin e opinionit publik për integrim evropian, por nuk ka përmendur ndonjë aktivitet konkret, prandaj është vlerësuar me 2 pikë (50%).

Pasi që nuk sponsorizon projektligje, kjo ministri ka dhënë listën e akteve nënligjore (tri) të hartuara gjatë periudhës janar 2010 – maj 2011 dhe listën e organizatave të shoqërisë civile të konsultuara gjatë hartimit të tyre (5 prej tyre) dhe është vlerësuar me 4 pikë (100%). Në anën tjetër, vlerësim prej 0 pikësh (0%) është dhënë në ndërlidhje me përfshirjen e akterëve jashtë-qeveritarë në hartimin e dokumenteve të saj të politikave për komunikim dhe informim publik, pasi që nuk është dhënë asnjë informatë. I njëjti vlerësim (0 pikë, 0%) është dhënë sa i përket përfshirjes së këtyre lloj akterësh në implementimin e dokumenteve të politikave, pasi që nuk është dhënë asnjë informatë. Po i njëjti vlerësim (0 pikë, 0%) është dhënë sa i përket përfshirjes së akterëve jashtë-qeveritarë në monitorimin dhe vlerësimin e implementimit të dokumenteve të politikave, pasi që nuk është dhënë asnjë informatë.

Në ndërkohë, pika që ndërlidhet me ueb-faqen e kësaj ministrie është vlerësuar maksimalisht (4 nga 4 pikë, 100%), pasi që është deklaruar se kjo ministri posedon ueb-faqen e saj zyrtare (www.mei-ks.net), dhe është dhënë lista e dokumenteve të publikuara në të (gjë që gjithashtu mund të monitorohet lehtë). Meqë MIE nuk ka dhënë asnjë informatë sa u përket aktiviteteve shtesë të komunikimit dhe informimit publik, është vlerësuar me 0 pikë (0%). Në fund, kjo ministri ka dhënë të dhënat mbi kualifikimet, përvojën dhe trajnimet e ndjekura vetëm nga një zyrtar, ndërkohë që më sipër ka deklaruar se ka dy zyrtarë përgjegjës për komunikim dhe informim publik, prandaj është vlerësuar me 2 pikë (50%).

Për të ***përmbledhur***, bazuar në informatat e dhëna për qëllim të këtij studimi dhe vlerësimin e tyre në përputhje me Sistemin e Pikëve të Transparencës Institucionale (SPTI), ***Ministria e Integrimit Evropian***, me ***Indeksin e Transparencës Institucionale (ITI) prej 45***, rezulton se është institucion ***i mbyllur***.

6. Ministria e Komuniteteve dhe Kthimit (MKK)

As Ministria e Komuniteteve dhe Kthimit nuk është përzgjedhur për studimin e vitit të kaluar. Sa i përket reflektimit të dispozitave kushtetuese dhe ligjore për komunikim dhe informim publik në kuadër të dokumentit themelues të saj, MKK ka përmendur vetëm Ligjin për Qasje në Dokumente Publike 'dhe një numri të madh dokumentesh të tjera', prandaj është vlerësuar me 0 pikë (0%). Sipas të dhënave të saj, kjo ministri nuk posedon një akt të sajin nënligjor që përcakton obligimet, strukturat dhe resurset për komunikim

dhe informim publik, pasi që kanë përmendur Rregulloren për Shërbimin e Komunikimit Qeveritar me Publikun, por nuk kanë dhënë asnjë shpjegim mbi atë se cilat struktura dhe resurse kanë siguruar për të zbatuar atë, prandaj është dhënë vlerësim prej 1 pikësh (25%). I njëjti vlerësim (prej 1 pike, 25%) është dhënë në pikën mbi mekanizmat dhe masave zbatuese të përpara me aktet përkatëse nënligjore, pasi që MKK vetëm ka përmendur obligimet ligjore që dalin nga rregullorja e sipërpërmendur dhe LQDP për themelimin e Zyrave për Informim Publik, por nuk kanë shpjeguar asgjë më tepër.

I njëjti vlerësim (prej 1 pike, 25%) është dhënë në lidhje me çështjen e klasifikimit dhe seleksionimit të dokumenteve publike, pasi që vetëm kanë deklaruar se kjo rregullohet sipas UA mbi Parimet, Procedurat dhe Shenjat e Klasifikimit të Dokumenteve Publike, por nuk kanë dhënë asnjë shpjegim mbi mekanizmat dhe masat zbatuese. Po i njëjti vlerësim (prej 1 pikësh, 25%) është dhënë sa i përket rregullimit të çështjes së përdorimit të gjuhëve zyrtare dhe atyre në përdorim, pasi që kjo ministri ka përmendur Ligjin për Përdorimin e Gjuhëve dhe Komisionin përkatës të nivelit nacional, kurse nuk ka dhënë asnjë shpjegim shtesë mbi mekanizmat dhe masat zbatuese.

Sipas informatave të dhëna, organogrami i MKK-së parasheh funksionimin e Zyrës për Informim Publik, por meqë nuk kanë shpjeguar pozitën e saj në kuadër të hierarkisë së Ministrisë, është vlerësuar me 2 pikë (50%). I njëjti vlerësim (prej 2 pikësh, 50%) është dhënë sa u përket Termave të Referencës së Zyrës për Informim të kësaj ministrie, pasi që vetëm kanë deklaruar se janë të përcaktuara me Rregulloren për Shërbimin e Komunikimit Qeveritar me Publikun, por nuk kanë dhënë asnjë shpjegim më të hollësishëm mbi mekanizmat dhe masat zbatuese. Po i njëjti vlerësim (prej 2 pikësh, 50%) është dhënë sa u përket Përshkrimeve të Vendeve të Punës, pasi që MKK ka deklaruar se secili zyrtar i Zyrës për Informim Publik posedon PVP-të e tyre, por nuk ka dhënë as përmbajtjen e tyre e as shpjegime me të hollësishme mbi këtë çështje. Sa u përket standardeve të raportimit e monitorimit të brendshëm, MKK është vlerësuar me 1 pikë (25%), pasi që vetëm kanë deklaruar, në nivel parimor, se raportimi dhe monitorimi kryhen bazuar në Ligjin për Shërbim Civil dhe rregulloret përkatëse dhe vlerësimi i punës është njëvjeçar, por nuk kanë dhënë shpjegime më të hollësishme mbi mekanizmat dhe masat konkrete të kryerjes së tyre.

Sa i përket alokimit të resurseve departamentit përgjegjës për komunikim dhe informim publik gjatë periudhës janar 2010 – maj 2011, MKK vetëm ka deklaruar se janë paraparë mjete financiare për realizimin e aktiviteteve të Zyrës për Komunikim dhe Informim, por nuk kanë dhënë asnjë informatë mbi shumën e tyre e as llojet e tjera të resurseve të planifikuara, dhe prandaj është vlerësuar me 1 pikë (25%). I njëjti vlerësim (prej 1 pikësh, 25%) është dhënë sa u përket resurseve të alokuara për implementimin e komponentëve të dokumenteve të politikave dhe atyre planifikuese për komunikim dhe informim publik gjatë periudhës janar 2010 – maj 2011, pasi që vetëm kanë deklaruar përgjithësisht se mjetet buxhetore për të gjitha aktivitetet e planifikuara me Planin Vjetor të Punës së Zyrës për Komunikim me Publikun janë të planifikuara, sipas kërkesës së kësaj zyre, por nuk kanë dhënë asnjë shpjegim më të hollësishëm mbi shumën e këtyre mjeteve e as të resurseve të tjera të nevojshme për kryerjen e këtyre aktiviteteve. Vlerësim më i vogël, (prej 0 pikësh, 0%) është dhënë në pikën mbi resurset e alokuara për vitin vijues, pasi që nuk është dhënë asnjë informatë.

Vlerësim prej 0.5 pikësh (12.5%) është dhënë në pikën që ka të bëjë me dokumentet e politikave të kësaj ministrie për komunikim dhe informim publik, pasi që është përmendur vetëm Plani Vjetor i Zyrës për Komunikim Publik, dhe është thënë përgjithësisht se mbikëqyret realizimi i tij, por nuk është shpjeguar asgjë mbi përmbajtjen e objektivave, mënyrat për realizimin e tyre, dhe mekanizmat e masat për monitorim dhe raportim. Në anën tjetër, vlerësim prej 0 pikësh (0%) është dhënë sa u përket mekanizmave dhe masave konkrete të parapara nga dokumentet e saj të politikave për të siguruar qasjen në

dokumente publike dhe mekanizmat e masat për monitorimin dhe raportimin e rregullt të zbatimit të tyre, pasi që përgjigja e dhënë është jo-relevante. Vlerësim prej 1 pike (25%) është dhënë në lidhje me aktivitetet konkrete për komunikim dhe informim publik, pasi që vetëm është deklaruar se Plani i zyrës në fjalë parasheh garantimin e qasjes në dokumente zyrtare, kurse raportet e tremujore mbi zbatimin e tij shërbejnë si mekanizma monitorues, por nuk është përmendur asnjë aktivitet tjetër a asnjë mekanizëm tjetër monitorimi dhe vlerësimi.

MKK ka deklaruar se gjatë periudhës janar 2010 – maj 2011 ka pasur komunikim të rregullt me të gjitha mediat në vend, kryesisht me qëllim të njoftimit të publikut mbi aktivitetet e ministrisë, por meqë nuk janë listuar lloje të tjera të aktiviteteve e as ndonjë organizatë e shoqërisë civile (përfshirë shpeshtësinë e komunikimit me secilën prej tyre), është dhënë vlerësim prej 0.5 pikësh (12.5%). Në anën tjetër, vlerësim prej 1 pike (25%) është dhënë sa u përket mediave konkrete me të cilat MKK ka pasur komunikim gjatë kësaj periudhe dhe llojet e aktiviteteve për të cilat është komunikuar, pasi që edhe në këtë pikë kjo ministri vetëm ka deklaruar përgjithësisht se ka pasur komunikim të rregullt me të gjitha mediat nacionale dhe ato lokale mbi aktivitete të ndryshme të saj, por nuk ka dhënë listën e këtyre mediave e as sqarime më të hollësishme mbi llojet e aktiviteteve për të cilat është komunikuar me to. Më tej, MKK është vlerësuar me 0 pikë (0%) në pikën që ka të bëjë me bashkëpunimin me organizata të shoqërisë civile, pasi që nuk ka dhënë asnjë informatë konkrete dhe specifike.

Pasi që kjo ministri ka deklaruar se gjatë periudhës janar 2010 – maj 2011 nuk ka sponsorizuar ndonjë projektligj, rrjedhimisht nuk ka pasur nevojë për kurrfarë bashkëpunimi me organizata të shoqërisë civile, është vlerësuar me 4 pikë (100%). Në anën tjetër, vlerësim prej 0 pikësh (0%) është dhënë në ndërlidhje me përfshirjen e akterëve jashtë-qeveritarë në hartimin e dokumenteve të saj të politikave relevante për komunikim dhe informim publik, pasi që nuk është dhënë asnjë informatë relevante. I njëjti vlerësim (0 pikë, 0%) është dhënë sa i përket përfshirjes së këtyre lloj akterësh në implementimin e dokumenteve të politikave, pasi që nuk është dhënë asnjë informatë konkrete dhe specifike. Po i njëjti vlerësim (0 pikë, 0%) është dhënë sa i përket përfshirjes së akterëve jashtë-qeveritarë në monitorimin dhe vlerësimin e implementimit të dokumenteve të politikave, pasi që as në këtë pikë nuk janë dhënë informata konkrete dhe specifike.

Në ndërkohë, pika që ndërlidhet me ueb-faqen e kësaj ministrie është vlerësuar maksimalisht (4 nga 4 pikë, 100%), pasi që është deklaruar se kjo ministri posedon ueb-faqen e saj zyrtare (www.mkk-ks.org) dhe janë përmendur kategoritë kryesore të informatave të publikuara në të (gjë që gjithashtu mund të monitorohet lehtë). Meqë MKK nuk ka dhënë asnjë informatë sa u përket aktiviteteve shtesë të komunikimit dhe informimit publik, është vlerësuar me 0 pikë (0%). Në fund, kjo ministri ka dhënë të dhënat mbi kualifikimet, përvojën dhe trajnimet e ndjekura nga stafi i Zyrës për Informim Publik (gjithsej tre zyrtarë), të cilët posedojnë arsimim kryesisht jo-relevant për punën që bëjnë, në ndërkohë që nuk kanë specifikuar asgjë mbi relevancën e përvojës së punës (dy prej tyre nga 6 vjet dhe njëri 26 vjet) dhe të trajnimeve të ndjekura (mbi 3 muaj), prandaj është vlerësuar me 1 pikë (25%).

Për të ***përmbledhur***, bazuar në informatat e dhëna për qëllim të këtij studimi dhe vlerësimin e tyre në përputhje me Sistemin e Pikëve të Transparencës Institucionale (SPTI), ***Ministria e Komuniteteve dhe Kthimit***, me ***Indeksin e Transparencës Institucionale (ITI) prej 24***, rezulton se është institucion ***i mbyllur***.

7. Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH)

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor nuk është përzgjedhur për studimin e vitit të kaluar. Sa i përket reflektimit të dispozitave kushtetuese dhe ligjore për komunikim dhe informim publik në kuadër të dokumentit themelues të saj, MMPH i është referuar UA për Informim dhe Pjesëmarrje të Publikut dhe të Palëve të Interesuara në Procedurat e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis, dhe kanë dhënë përmbajtjen e dispozitës që përcakton qëllimet e saj, por meqë ky akt nënligjor rregullon vetëm një pjesë të vogël të fushëveprimit të kësaj ministrie, është vlerësuar me 3 pikë (75%). Edhe sa i përket aktit të saj nënligjor që përcakton obligimet, strukturat dhe resurset për komunikim dhe informim publik, kjo ministri i është referuar të njëjtit UA, por gjithashtu kanë listuar disa mekanizma dhe masa të vendosura përmes tij, prandaj është vlerësuar me 2 pikë (50%). I njëjti vlerësim (prej 2 pikësh, 50%) është dhënë në pikën mbi mekanizmat dhe masave zbatuese të përpara me aktet përkatëse nënligjore, pasi që MMPH vetëm ka listuar shtatë masa të tilla, po nuk kanë dhënë asnjë shpjegim më të hollësishëm.

I njëjti vlerësim (prej 2 pikësh, 50%) është dhënë në lidhje me çështjen e klasifikimit dhe seleksionimit të dokumenteve publike, pasi që edhe te kjo pikë kanë dhënë përmbajtjen e dispozitave të UA për Informim dhe Pjesëmarrje të Publikut dhe të Palëve të Interesuara në Procedurat e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis të cilat rregullojnë klasifikimin dhe seleksionimin e dokumenteve publike, por nuk kanë dhënë asnjë shpjegim mbi mekanizmat dhe masat zbatuese. Një vlerësim më i vogël se kaq (prej 1 pikësh, 25%) është dhënë sa i përket rregullimit të çështjes së përdorimit të gjuhëve zyrtare dhe atyre në përdorim, pasi që kjo ministri vetëm ka deklaruar se respekton dispozitat përkatëse ligjore për çdo dokument zyrtar të sajin, por nuk kanë dhënë asnjë shpjegim shtesë mbi mekanizmat dhe masat zbatuese.

Sipas informatave të dhëna, organogrami i MMPH-së parasheh funksionimin e Zyrës për Komunikim dhe Informim, si dhe kanë shpjeguar pozitën e saj në kuadër të hierarkisë së Ministrisë (në kuadër të Kabinetit të Ministrit), është vlerësuar me 4 pikë (100%). Në anën tjetër, një vlerësim më i ulët se kaq (prej 1 pikësh, 25%) është dhënë sa u përket Termave të Referencës së kësaj zyre, pasi që vetëm kanë deklaruar se i posedojnë ato, por nuk kanë dhënë përmbajtjen e tyre e asnjë shpjegim më të hollësishëm mbi mekanizmat dhe masat zbatuese. Po i njëjti vlerësim (prej 1 pikësh, 25%) është dhënë sa u përket Përshkrimeve të Vendeve të Punës, pasi që MMPH vetëm ka deklaruar se ato janë të përcaktuara përmes Rregullores mbi Shërbimin e Komunikimit Qeveritar me Publikun, por nuk kanë dhënë as përmbajtjen e tyre e as shpjegime me të hollësishme mbi këtë çështje. Sa u përket standardeve të raportimit e monitorimit të brendshëm, MMPH është vlerësuar me 1 pikë (25%), pasi që vetëm kanë deklaruar, në nivel parimor, se vlerësimi i punës së zyrtarëve për informim kryhet çdo fundvit, por nuk kanë dhënë shpjegime më të hollësishme mbi mekanizmat dhe masat konkrete të kryerjes së tyre, e as kanë listuar ndonjë masë e mekanizëm tjetër zbatues.

Sa i përket alokimit të resurseve departamentit përgjegjës për komunikim dhe informim publik gjatë periudhës janar 2010 – maj 2011, MMPH nuk ka dhënë përgjigje konkrete e as specifike. prandaj është vlerësuar me 0 pikë (0%). Një vlerësim më i lartë se kaq (prej 1 pikësh, 25%) është dhënë sa u përket resurseve të alokuara për implementimin e komponentëve të dokumenteve të politikave dhe atyre planifikuese për komunikim dhe informim publik gjatë periudhës janar 2010 – maj 2011, pasi që vetëm kanë deklaruar përgjithësisht se Zyra për Komunikim dhe Informim posedon resurse të mjaftueshme njerëzore dhe teknike, kurse resurset buxhetore i alokohen sipas kërkesave, por nuk kanë dhënë asnjë shpjegim më të hollësishëm mbi shumën e këtyre mjeteve e as të resurseve të tjera të nevojshme për kryerjen e aktiviteteve përkatëse. Vlerësim më i lartë se kaq (prej 2 pikësh, 50%) është dhënë në pikën mbi resurset e alokuara për vitin vijues, pasi që

janë dhënë informata konkrete vetëm për kategorinë e resurseve njerëzore, e asnjë informatë konkrete mbi kategoritë e tjera të resurseve të alokuara.

Vlerësim prej 0.5 pikësh (12.5%) është dhënë në pikën që ka të bëjë me dokumentet e politikave të kësaj ministrie për komunikim dhe informim publik, pasi që vetëm kanë deklaruar se deri më tani kanë hartuar Plane të Komunikimit me Publikun, dhe se pritet të fillohet të punohet sipas planeve vjetore për komunikim dhe informim publik, por nuk është shpjeguar asgjë mbi përmbajtjen e objektivave, mënyrat për realizimin e tyre, dhe mekanizmat e masat për monitorim dhe raportim. Në anën tjetër, vlerësim prej 0 pikësh (0%) është dhënë sa u përket mekanizmave dhe masave konkrete të parapara nga dokumentet e saj të politikave për të siguruar qasjen në dokumente publike dhe mekanizmat e masat për monitorimin dhe raportimin e rregullt të zbatimit të tyre, pasi që përgjigja e dhënë është jo-relevante. Vlerësim prej 0.5 pikësh (12.5%) është dhënë në lidhje me aktivitetet konkrete për komunikim dhe informim publik, pasi që vetëm është deklaruar se Plani i zyrës në fjalë parasheh aktivitete mediale me qëllim të informimit të publikut mbi aktivitetet e Ministrisë, por nuk është përmendur asnjë aktivitet tjetër a asnjë mekanizëm tjetër monitorimi dhe vlerësimi.

MMPH ka deklaruar se gjatë periudhës janar 2010 – maj 2011 ka pasur komunikim të rregullt me mediat dhe se kanë nënshkruar memorandume bashkëpunimi me organizata të shoqërisë civile aktive në fushën e mjedisit, por meqë nuk janë listuar lloje të tjera të aktiviteteve e as ndonjë organizatë e shoqërisë civile (përfshirë shpeshtësinë e komunikimit me secilën prej tyre), është dhënë vlerësim prej 2 pikësh (50%). Në anën tjetër, vlerësim prej 1 pike (25%) është dhënë sa u përket mediave konkrete me të cilat MMPH ka pasur komunikim gjatë kësaj periudhe dhe llojet e aktiviteteve për të cilat është komunikuar, pasi që edhe në këtë pikë kjo ministri vetëm ka deklaruar përgjithësisht se ka pasur komunikim të rregullt me të gjitha mediat nacionale dhe ato lokale mbi aktivitete të ndryshme të saj, por nuk ka dhënë listën e këtyre mediave e as sqarime më të hollësishme mbi llojet e aktiviteteve për të cilat është komunikuar me to. Më tej, MMPH është vlerësuar me 2 pikë (50%) në pikën që ka të bëjë me bashkëpunimin me organizata të shoqërisë civile, pasi që kanë listuar pesë organizata të tilla, por nuk kanë dhënë shpjegime mbi llojet dhe shpeshtësinë a aktiviteteve specifike.

MMPH nuk ka dhënë listën e projektligjeve të hartuara gjatë periudhës janar 2010 – maj 2011 e as atë të akterëve jashtë-qeveritarë të përfshirë në hartimin e secilit prej tyre, është vlerësuar me 0 pikë (0%). I njëjti vlerësim (prej 2 pikësh, 50%) është dhënë sa i përket përfshirjes së akterëve jashtë-qeveritarë në hartimin e dokumenteve të saj të politikave që janë relevante për komunikim dhe informim publik, pasi që kanë listuar 6 strategji, por nuk kanë përmendur asnjë akter jashtë-qeveritar. Në anën tjetër, një vlerësim pre 0 pikësh (0%) është dhënë sa i përket përfshirjes së këtyre lloj akterësh në implementimin e dokumenteve të politikave, pasi që nuk është dhënë asnjë informatë konkrete dhe specifike. Po i njëjti vlerësim (0 pikë, 0%) është dhënë sa i përket përfshirjes së akterëve jashtë-qeveritarë në monitorimin dhe vlerësimin e implementimit të dokumenteve të politikave, pasi që as në këtë pikë nuk janë dhënë informata konkrete dhe specifike.

Në ndërkohë, pika që ndërlidhet me ueb-faqen e kësaj ministrie është vlerësuar maksimalisht (4 nga 4 pikë, 100%), pasi që është deklaruar se kjo ministri posedon ueb-faqen e saj zyrtare (http://mmph.rks-gov.net/) dhe janë përmendur kategoritë kryesore të informatave të publikuara në të (gjë që gjithashtu mund të monitorohet lehtë). MMPH gjithashtu ka deklaruar se kryen aktivitete shtesë të komunikimit dhe informimit publik (për vetëdijesimin e publikut, përmes fletëpalosjeve, faqes së saj zyrtare, Sektorit për Vetëdijesim në kuadër të Departamentit për Mbrojtjen e Mjedisit cili mban kontakte me institucione shkollore të ulëta dhe të mesme, dhe dhënies së këshillave për ruajtjen dhe kujdesin ndaj resurseve natyrore) është vlerësuar me 4 pikë (100%). Në fund, kjo ministri

ka dhënë të dhënat mbi kualifikimet dhe përvojën e stafit të Zyrës për Komunikim dhe Informim (gjithsej tre zyrtarë), të cilët posedojnë arsimim relativisht relevant, në ndërkohë që nuk kanë specifikuar asgjë mbi relevancën e përvojës së punës (e cila thuhet se sillet nga 5 deri në 14 vjet), por nuk kanë dhënë asnjë informatë mbi trajnimet e ndjekura nga secili prej tyre, dhe janë vlerësuar me 3 pikë (75%).

Për të ***përmbledhur***, bazuar në informatat e dhëna për qëllim të këtij studimi dhe vlerësimin e tyre në përputhje me Sistemin e Pikëve të Transparencës Institucionale (SPTI), ***Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor***, me ***Indeksin e Transparencës Institucionale (ITI) prej 39***, rezulton se është institucion ***i mbyllur***.

8. Ministria e Punëve të Jashtme (MPJ)

Sipas të dhënave të siguruara nga MPJ, Ligji për Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Shërbimin Diplomatik të Republikës së Kosovës është dokumenti themelues i saj i cili pasqyron obligimin e specifikuar në dispozitën kushtetuese që garanton qasjen e qytetarëve në dokumente publike, dhe kanë dhënë përmbajtjen e dispozitave përkatëse, prandaj është vlerësuar me 4 pikë (100%, 2.5 pikë më tepër se vitin e kaluar). MPJ gjithashtu ka dhënë titullin dhe dispozitat përkatëse të aktit nënligjor që rregullon zbatimin praktik të këtyre obligimeve kushtetuese dhe ligjore (Neni 14 i UA nr. 06/2009 për Plotësim-ndryshimin e UA 01/2008 për Organizimin dhe Strukturimin e Brendshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme), por pasi që nuk janë dhënë informata dhe shpjegime më të plota në lidhje me strukturat, resurset e alokuara për qëllim të zbatimit të obligimeve të vendosura me këtë dispozitë të këtij akti nënligjor, është dhënë vlerësimi prej 3 pikësh (75%, njëjtë si vitin e kaluar). Në pikën që ka të bëjë me mekanizmat dhe masat zbatuese të parapara me këtë akt nënligjor, MPJ ka shpjeguar rregullat e organizimit, të funksionimit, si dhe strukturën përkatëse, si dhe obligimet e detyrat që rrjedhin nga kjo, por gjithashtu linjën e raportimit të brendshëm deri te Sekretari i Përhershëm i Ministrisë, dhe është vlerësuar me 4 pikë (100%, njëjtë si vitin e kaluar).

Sa i përket çështjes së klasifikimit të dokumenteve, MPJ ka deklaruar se kjo rregullohet me Ligjin për Klasifikimin e Dokumenteve, por meqë nuk kanë dhënë asnjë shpjegim mbi mekanizmat dhe masat zbatuese, është vlerësuar me 2 pikë (50%, 2 më tepër se vitin e kaluar). I njëjti vlerësim (prej 2 pikësh, 50%, 2 pikë më pak se vitin e kaluar) është dhënë për pikën në lidhje me përdorimin e gjuhëve, pasi që MPJ ka deklaruar se kjo rregullohet përmes Ligjit për Përdorimin e Gjuhëve, por nuk kanë dhënë asnjë shpjegim të mëtejshëm relevant mbi mekanizmat dhe masat zbatuese.

MPJ gjithashtu ka specifikuar dispozitën e mbi UA për plotësim-ndryshimin e UA mbi Organizimin dhe Strukturimin e Brendshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme që rregullon funksionimin e strukturës së saj për media, e cila figuron në organogramin e kësaj ministrie si Departament për Media, por meqë mungon një shpjegim më i detajuar mbi pozitën dhe funksionimin e tij në kuadër të strukturës së gjithëmbarshme hierarkike të ministrisë, është vlerësuar me 2 pikë (50%, 2 pikë më pak se vitin e kaluar). I njëjti vlerësim (2 pikë, 50%, 2 pikë më pak se vitin e kaluar) është dhënë edhe në pikën mbi Termat e Referencës së këtij departamenti, pasi që është dhënë përmbajtja e tyre, por asnjë shpjegim shtesë mbi mekanizmat e masat zbatuese. Sa u përket Përshkimeve të Vendeve të Punës, është deklaruar se ato ekzistojnë për secilën pozitë, por meqë mungon çfarëdo shpjegimi në lidhje me to, është vlerësuar me 2 pikë (50%, njëjtë si vitin e kaluar). Pika në vijim, mbi standardet e raportimit dhe monitorimit të brendshëm dhe të vlerësimit të punës së zyrtarëve, është vlerësuar me 0 pikë (0%, 4 më pak se vitin e kaluar), pasi që përgjigja e dhënë nuk është konkrete e as specifike.

Sa u përket resurseve të alokuara Departamentit për Media gjatë periudhës që mbulon ky raport, MPJ ka shpjeguar se ka resurse të mjaftueshme humane dhe financiare (në kuadër të buxhetit të Departamentit të Administratës së Përgjithshme), por pasi që nuk është shpjeguar saktësisht se si janë planifikuar të gjitha llojet e resurseve dhe raporti në mes të resurseve të kërkuara dhe atyre të alokuara për këtë departament, është dhënë vlerësim prej 2 pikësh (50%, njëjtë si vitin e kaluar). I njëjti vlerësim, (2 pikë, 50%, njëjtë si vitin e kaluar) është dhënë për pikën që ka të bëjë me alokimin e resurseve për implementimin e dokumenteve relevante të politikave, pasi që MPJ vetëm ka deklaruar se janë përmbushur të gjitha kërkesat në lidhje me këtë, por megjithatë nuk ka dhënë asnjë shpjegim më konkret dhe specifik në lidhje me këtë. Pika e fundit sa u përket resurseve (shuma e resurseve të alokuara për këtë vit për komunikim dhe informim publik) është vlerësuar me 3 pikë (75%, njëjtë si vitin e kaluar), pasi që është dhënë shuma e resurseve humane (gjithsej 4 zyrtarë) dhe është thënë se nuk ka probleme sa u përket resurseve financiare, por nuk është dhënë asnjë shumë e përafërt e as ndonjë shpjegim në lidhje me resurset teknike.

Sa u përket dokumenteve të politikave, MPJ ka deklaruar se Departamenti i saj për Media nuk është përgjegjës për këtë, por vepron në bazë të planit të tij vjetor, e raportet periodike shërbejnë si mjet monitorimi e vlerësimi, por pasi që dokument politikash i ministrisë që përmban komponentin e informimit dhe komunikimit me publikun, e as nuk është dhënë lista e objektivave të planit të përmendur vlerësimi i dhënë është 1 pikë (25%, 0.5 më pak se vitin e kaluar. Vlerësim më i ulët se kaq (0 pikë, 0%, 3 pikë më pak se vitin e kaluar) në pikën që ka të bëjë me masat konkrete për të siguruar zbatimin e objektivave për komunikim dhe informim publik në kuadër të dokumenteve të politikave të ministrisë, pasi që përgjigja e dhënë nuk është as konkrete e as specifike. Një vlerësim më i ulët se vitin e kaluar (1 pikë, 25%, 0.5 më pak se vitin e kaluar) është dhënë sa u përket aktiviteteve të parapara nga dokumentet e politikave me qëllim të përmbushjes së objektivave strategjike përkatëse, pasi që vetëm është përmendur publikimi i informatave si lloj aktiviteti dhe raportet e rregullta si lloj mekanizmash monitorimi dhe vlerësimi, por mungojnë të dhëna të tjera më të hollësishme.

Sipas të dhënave të MPJ-së, kjo ministri ka pasur komunikim të drejtpërdrejtë me mediat dhe organizatat e shoqërisë civile gjatë periudhës janar 2010 – maj 2011, por pasi që mungon çfarëdo shpjegimi më i hollësishëm, është vlerësuar me vetëm 2 pikë (50%, njëjtë si vitin e kaluar). E njëjta vlen (vlerësim prej 2 pikësh, 50%, njëjtë si vitin e kaluar). Ngjashëm është gjendja sa i përket përfshirjes së organizatave të shoqërisë civile (vlerësim me 2 pikësh, 50%, njëjtë si vitin e kaluar), pasi që janë përmendur dy prej tyre, por jo llojet e aktiviteteve në të cilat janë të përfshira ato.

Më tej, kjo ministri ka listuar të gjitha projektligjet dhe aktet nënligjore që ka sponsorizuar dhe hartuar që nga themelimi i saj, por nuk ka dhënë një listë të akterëve jashtë-qeveritarë të përfshirë në hartimin e secilit prej tyre, prandaj është vlerësuar me 1 pikë (25%, njëjtë si vitin e kaluar). Vlerësimi i njëjtë (1 pikë, 25%, njëjtë si vitin e kaluar) është dhënë në pikën mbi listën e dokumenteve të politikave të këtij institucioni dhe akterëve jashtë-qeveritarë të përfshirë në hartimin e tyre, pasi që është dhënë lista e dokumenteve, por jo edhe ajo e akterëve jashtë-qeveritarë të përfshirë në hartimin e secilit prej tyre. Po i njëjti vlerësim (1 pikë, 25%, njëjtë si vitin e kaluar) në lidhje me listën e akterëve jashtë-qeveritarë të përfshirë në implementimin e dokumenteve të politikave të kësaj ministrie, pasi që është dhënë lista e dokumenteve, por mungon lista e akterëve jashtë-qeveritarë të përfshirë në implementimin e secilit prej tyre. Sa i përket përfshirjes së akterëve jashtë-qeveritarë të përfshirë në monitorimin dhe vlerësimin e implementimit të dokumenteve të politikave, informatat e dhëna nuk janë konkrete e as specifike, prandaj vlerësimi i dhënë është 0 (0%, njëjtë si vitin e kaluar).

MPJ ka marrë vlerësim prej 4 pikësh (100%, njëjtë si vitin e kaluar) në pikën në lidhje me ueb-faqen (www.mfa-ks.net), pasi që është specifikuar se çfarë lloje informatash përmban dhe gjuhët në të cilat janë të publikuara ato (gjë që gjithashtu mund të monitorohet lehtë). Më tej, kjo ministri nuk ka përmendur ndonjë aktivitet shtesë për komunikim dhe informim publik, prandaj është vlerësuar me 0 pikë (0%, 3 pikë më pak se vitin e kaluar). Në fund, në rubrikën mbi kapacitetet e zyrtarëve të saj përgjegjës për komunikim dhe informim publik, MPJ ka dhënë listën e zyrtarëve përkatës (gjithsej 3, megjithëse më sipër kanë specifikuar se kanë 4 zyrtarë), nga të cilët 2 të gjithë posedojnë kualifikime adekuate, kurse sa i përket përvojës së punës 2 prej tyre kanë nga 5 vjet dhe njëri 18 vjet (megjithëse nuk është specifikuar sa relevante është ajo për pozitat që mbajnë), por nuk kanë dhënë asnjë të dhënë mbi temat dhe kohëzgjatjen e trajnimeve të ndjekura, prandaj është dhënë vlerësimi prej 2 pikësh (50%, 0.5 më pak se vitin e kaluar).

Për të ***përmbledhur***, bazuar në informatat e dhëna për qëllim të këtij studimi dhe vlerësimin e tyre në përputhje me Sistemin e Pikëve të Transparencës Institucionale (SPTI), ***Ministria e Punëve të Jashtme***, me ***Indeksin e Transparencës Institucionale (ITI) prej 45***, rezulton se është institucion ***i mbyllur***.

9. Ministria e Shëndetësisë (MSH)

Ministria e Shëndetësisë nuk është përzgjedhur për studimin e vitit të kaluar. Sa i përket reflektimit të dispozitave kushtetuese dhe ligjore për komunikim dhe informim publik në kuadër të dokumentit themelues të saj, MSH ka listuar aktet ligjore (Ligjin për Qasje në Dokumentet Publike, Rregulloren mbi Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive dhe Rregulloren për Shërbimin e Komunikimit Qeveritar me Publikun) dhe nenet përkatëse (8, 9, 10 dhe 11 të rregullores së fundit), por pasi që nuk ka dhënë përmbajtjen e plotë të këtyre neneve, është vlerësuar me 3 pikë (75%). Më tej, MSH ka deklaruar se obligimet, strukturat dhe resurset për komunikim dhe informim publik përcaktohen përmes Rregullores për Shërbimin e Komunikimit Qeveritar me Publikun, dhe ka shpjeguar qëllimin e përgjithshëm të saj, por meqë nuk ka shpjeguar më në hollësi mekanizmat e masat zbatuese, është vlerësuar me 2 pikë (50%). I njëjti vlerësim (prej 2 pikësh, 50%) është dhënë në pikën mbi mekanizmat dhe masave zbatuese të përpara me aktet përkatëse nënligjore, pasi që ka listuar detyrat dhe obligimet e saj në fushën e komunikimit dhe informimit publik, por nuk ka shpjeguar në hollësi vënien e tyre në zbatim.

Sipas informatave të dhëna, MSH e ka të rregulluar çështjen e klasifikimit dhe seleksionimit të dokumenteve publike sipas LQDP-së: ata kanë specifikuar kriteret për këtë, por nuk kanë shpjeguar mekanizmat dhe masat zbatuese, prandaj janë vlerësuar me 2 pikë (50%). Një vlerësim më i lartë (prej 3 pikësh, 75%) është dhënë sa i përket rregullimit të çështjes së përdorimit të gjuhëve zyrtare dhe atyre në përdorim, pasi që kjo ministri ka përmendur Ligjin për Përdorimin e Gjuhëve dhe ka sqaruar një pjesë të mekanizmave dhe masave zbatuese.

MSH ka raportuar se në kuadër të strukturës së saj organizative funksionon Departamenti i Informimit, i themeluar më 2007, me vendim të Sekretarit të Përhershëm, dhe ka sqaruar pozitën dhe funksionimin e tij në kuadër të hierarkisë së ministrisë, prandaj është vlerësuar me 4 pikë (100%). Sa u përket Termave të Referencës së këtij departamenti, MSH ka deklaruar se ato janë të përcaktuar me Rregulloren për Shërbimin e Komunikimit Qeveritar me Publikun, dhe ka dhënë përmbajtjen e tyre, por meqë nuk janë dhënë shpjegime më të hollësishme mbi mekanizmat dhe masat për zbatimin e këtyre obligimeve, i është dhënë vlerësim prej 2 pikësh (50%). Vlerësim me 1 pikë (25%) është dhënë sa u përket Përshkrimeve të Vendeve të Punës, pasi që kanë dhënë përmbajtjen e tyre të përgjithshme, siç është përcaktuar me rregulloren e sapopërmendur, por nuk ka

dhënë shpjegime me të hollësishme mbi këtë çështje. Sa u përket standardeve të raportimit e monitorimit të brendshëm, MSH është vlerësuar me 3 pikë (75%), pasi që ka shpjeguar në përgjithësi mekanizmin e raportimit dhe vlerësimit të performancës së stafit të Departamentit të Informimit në kuadër të hierarkisë së saj dhe kanë përmendur vetëm planin vjetor të punës si standard raportimi, përderisa nuk është e qartë fushëveprimi i këtij departamenti në sektorin e shëndetit publik e as ndarja e përgjegjësive brenda stafit të tij.

Në aspektin e alokimit të resurseve këtij departamenti, edhe kjo ministri ka deklaruar se atij i janë alokuar mjete të mjaftueshme buxhetore gjatë periudhës janar 2010 – maj 2011 (të planifikuara në bazë njëvjeçare), por meqë nuk është thënë asgjë në lidhje me llojet e tjera të resurseve, është vlerësuar me 2 pikë (50%). Në anën tjetër, vlerësim i njëjtë (prej 2 pikësh, 50%) është dhënë sa u përket resurseve të alokuara për implementimin e komponentëve të dokumenteve të politikave dhe atyre planifikuese për komunikim dhe informim publik gjatë periudhës janar 2010 – maj 2011, pasi që vetëm kanë deklaruar në përgjithësi se janë alokuar resurse të mjaftueshme dhe ka nevojë edhe për një anëtar stafi, por nuk kanë dhënë asnjë shpjegim më të hollësishëm. Vlerësim më i ulët (prej 0 pikësh, 0%) është dhënë në pikën mbi resurset e alokuara për vitin vijues, pasi që nuk është dhënë asnjë informatë.

Vlerësim prej 4 pikësh (100%) është dhënë në pikën që ka të bëjë me dokumentet e politikave të kësaj ministrie për komunikim dhe informim publik, pasi që kanë deklaruar se kjo bëhet përmes planit vjetor të punës së Ministrisë, ku kanë listuar objektivat në fushën e komunikimit dhe informimit publik (gjithsej 2 syresh), si dhe aktivitetet për arritjen e tyre (gjithsej 8 kategori syresh), si dhe kanë konfirmuar se realizimi i tyre monitorohet në baza mujore. Në anën tjetër, vlerësim prej 2 pikësh (50%) është dhënë sa u përket mekanizmave dhe masave konkrete të parapara nga dokumentet e saj të politikave për të siguruar qasjen në dokumente publike dhe mekanizmat e masat për monitorimin dhe raportimin e rregullt të zbatimit të tyre, pasi që është deklaruar se pranojnë lloje të ndryshme të kërkesave, ka specifikuar numrin e kërkesave të pranuara gjatë periudhës janar 2010 – maj 2011, por nuk kanë bërë ndërlidhjen e tyre me objektivat dhe aktivitetet e listuara në pikën e mësipërme. I njëjti vlerësim (2 pikë, 50%) është dhënë në lidhje me aktivitetet konkrete për komunikim dhe informim publik, pasi që vetëm kanë listuar kategoritë e aktiviteteve, por nuk kanë dhënë shpjegime të hollësishme mbi mekanizmat dhe masat zbatuese për të siguruar përmbushjen e objektivave të listuara më sipër.

Po i njëjti vlerësim, (2 pikë, 50%) është dhënë sa i përket komunikimit të rregullt me media dhe organizata të shoqërisë civile gjatë periudhës janar 2010 – maj 2011, pasi që vetëm kanë deklaruar se kanë pasur komunikim të rregullt, por nuk kanë shpjeguar më në hollësi llojet e aktiviteteve për të cilat është komunikuar. E njëjta vlen (vlerësim prej 2 pikësh, 50%) sa u përket mediave me të cilat MSH ka pasur komunikim të rregullt gjatë kësaj periudhe, pasi që është dhënë lista e tyre, por jo edhe ajo e aktiviteteve për të cilat kanë komunikuar. Në anën tjetër, në pikën që ka të bëjë me bashkëpunimin me organizata të shoqërisë civile, MSH ka dhënë listën e këtyre organizatave (gjithsej 19 syresh) dhe llojin e bashkëpunimit (nga shkëmbimi i informatave deri të partneriteti), por pasi që nuk ka shpjeguar në hollësi llojet konkrete të aktiviteteve dhe kohëzgjatjen e secilit prej tyre, është vlerësuar me 3 pikë (75%).

MSH ka listuar të gjitha projektligjet që ka sponsorizuar gjatë periudhës janar 2010 – maj 2011 (gjithsej 4) dhe organizatat e shoqërisë civile të konsultuara gjatë hartimit të tyre (gjithsej 13 prej tyre) dhe është vlerësuar me 4 pikë (100%). I njëjti vlerësim (prej 4 pikësh, 100%) është dhënë në ndërlidhje me përfshirjen e akterëve jashtë-qeveritarë në hartimin e dokumenteve të saj të politikave (në kuadër të të cilave reflektohen edhe çështjet e komunikimit dhe informimit publik), pasi që ka dhënë listën e këtyre dokumenteve (gjithsej 4) dhe të organizatave të shoqërisë civile të përfshira (gjithsej 4 të

tilla). Në anën tjetër, vlerësim prej 2 pikësh (50%) është dhënë sa i përket përfshirjes së këtyre lloj akterësh në implementimin e dokumenteve të politikave, pasi që janë listuar disa prej tyre, por mungojnë sqarime më të hollësishme mbi aktivitetet konkrete në të cilat është përfshirë secila prej tyre. Një vlerësim më i lartë (3 pikë, 75%) është dhënë sa i përket përfshirjes së akterëve jashtë-qeveritarë në monitorimin dhe vlerësimin e implementimit të dokumenteve të politikave, pasi që janë listuar këta lloj akterësh (gjithsej 12 prej tyre), por nuk është saktësuar fushëveprimi i secilit prej tyre në monitorimin dhe vlerësimin e implementimit të dokumenteve përkatëse të politikave.

Megjithëse Ministria e Shëndetësisë posedon ueb-faqen e saj (www.msh-ks.org), ajo nuk ka dhënë asnjë informatë mbi të, prandaj është vlerësuar me 0 pikë (0%). E njëjta vlen (vlerësim prej 0 pikësh, 0%) sa u përket aktiviteteve shtesë për komunikim dhe informim publik dhe të dhënave mbi numrin e stafit, kualifikimet, përvojën dhe trajnimet në të cilat kanë marrë pjesë, pasi që nuk është dhënë asnjë informatë.

Për të ***përmbledhur***, bazuar në informatat e dhëna për qëllim të këtij studimi dhe vlerësimin e tyre në përputhje me Sistemin e Pikëve të Transparencës Institucionale (SPTI), ***Ministria e Shëndetësisë***, me ***Indeksin e Transparencës Institucionale (ITI) prej 55***, rezulton se është institucion ***pjesërisht i hapur***.

10. Ministria e Zhvillimit Ekonomik (MZHE)

Ministria e Zhvillimit Ekonomik (në atë kohë Ministria e Energjisë dhe Minierave) nuk është përzgjedhur për studimin e vitit të kaluar. Sa i përket reflektimit të dispozitave kushtetuese dhe ligjore për komunikim dhe informim publik në kuadër të dokumentit themelues të saj, MZHE nuk ka dhënë asnjë informatë, prandaj është vlerësuar me 0 pikë (0%). Sipas të dhënave të saj, kjo ministri nuk posedon një akt të sajin nënligjor që përcakton obligimet, strukturat dhe resurset për komunikim dhe informim publik, por vepron vetëm në bazë të Rregullores për Shërbimin e Komunikimit Qeveritar me Publikun, por as nuk kanë dhënë ndonjë shpjegim mbi atë se cilat struktura dhe resurse kanë siguruar për të zbatuar atë, prandaj është dhënë vlerësim prej 1 pikësh (25%). I njëjti vlerësim (prej 1 pike, 25%) është dhënë në pikën mbi mekanizmat dhe masave zbatuese të përpara me aktet përkatëse nënligjore, pasi që vetëm kanë përmendur se posedojnë një zyrtar për pranimin e kërkesave për qasje në dokumente zyrtare, por nuk kanë shpjeguar asgjë më tepër.

Në anën tjetër, vlerësim më i ulët se kaq (prej 0 pikësh, 0%) është dhënë në lidhje me çështjen e klasifikimit dhe seleksionimit të dokumenteve publike dhe atë të përdorimit të gjuhëve zyrtare dhe atyre në përdorim, pasi që nuk kanë dhënë ndonjë informatë.

Sipas informatave të dhëna, organogrami i MZHE-së parasheh funksionimin e Zyrës për Komunikim, por meqë nuk kanë shpjeguar pozitën e saj në kuadër të hierarkisë së Ministrisë, është vlerësuar me 2 pikë (50%). I njëjti vlerësim (prej 2 pikësh, 50%) është dhënë sa u përket Termave të Referencës së kësaj zyre, pasi që vetëm kanë deklaruar se i posedojnë ato, dhe në bazë të tyre janë përcaktuar tri pozita në kuadër të kësaj zyre, por nuk kanë dhënë asnjë shpjegim më të hollësishëm mbi mekanizmat dhe masat zbatuese. Sa u përket Përshkrimeve të Vendeve të Punës, MZHE është vlerësuar me 0 pikë (0%), pasi që informatat e dhëna nuk janë as konkrete e as specifike. Sa u përket standardeve të raportimit e monitorimit të brendshëm, MZHE është vlerësuar me 1 pikë (25%), pasi që vetëm kanë deklaruar, në nivel parimor, se raportimi dhe monitorimi kryhen bazuar në Ligjin për Shërbim Civil dhe vlerësimi i performancës kryhet çdo, por nuk kanë dhënë shpjegim konkret më të hollësishme mbi mekanizmat dhe masat zbatuese.

Sa i përket alokimit të resurseve departamentit përgjegjës për komunikim dhe informim publik gjatë periudhës janar 2010 – maj 2011, MZHE vetëm ka deklaruar se Zyra për Komunikim posedon linjën e vet buxhetore, por meqë nuk kanë dhënë asnjë informatë mbi shumën e tyre e as llojet e tjera të resurseve të planifikuara është vlerësuar me 1 pikë (25%). Në anën tjetër, vlerësim prej 0 pikësh (0%) është dhënë sa u përket resurseve të alokuara për implementimin e komponentëve të dokumenteve të politikave dhe atyre planifikuese për komunikim dhe informim publik gjatë periudhës janar 2010 – maj 2011, pasi që nuk kanë dhënë asnjë informatë. E njëjta vlen (vlerësim prej 0 pikësh, 0%), pasi që nuk kanë dhënë asnjë informatë.

Vlerësim prej 0.5 pikësh (12.5%) është dhënë në pikën që ka të bëjë me dokumentet e politikave të kësaj ministrie për komunikim dhe informim publik, pasi që është përmendur vetëm Plani Vjetor i Ministrisë, ndërsa është thënë se është duke u hartuar një plan mbarë-qeveritar i komunikimit, por nuk është shpjeguar asgjë mbi përmbajtjen e objektivave, mënyrat për realizimin e tyre, dhe mekanizmat e masat për monitorim dhe raportim. Në anën tjetër, vlerësim prej 0 pikësh (0%) është dhënë sa u përket mekanizmave dhe masave konkrete të parapara nga dokumentet e saj të politikave për të siguruar qasjen në dokumente publike dhe mekanizmat e masat për monitorimin dhe raportimin e rregullt të zbatimit të tyre, pasi që nuk është dhënë asnjë përgjigje. I njëjti vlerësim (prej 0 pikësh, 0%) është dhënë në lidhje me aktivitetet konkrete për komunikim dhe informim publik, pasi që as këtu nuk është dhënë asnjë informatë.

MZHE ka deklaruar se gjatë periudhës janar 2010 – maj 2011 ka pasur komunikim të drejtpërdrejtë dhe të rregullt me të gjitha mediat dhe organizatat e shoqërisë civile, përmes takimeve të rregullta me media, dhe takime me OJQ sipas nevojës, por meqë nuk janë listuar lloje të tjera të aktiviteteve e as ndonjë organizatë e shoqërisë civile (përfshirë shpeshtësinë e komunikimit me secilën prej tyre), është dhënë vlerësim prej 2 pikësh (50%). I njëjti vlerësim (prej 2 pikësh, 50%) është dhënë sa u përket mediave konkrete me të cilat MZHE ka pasur komunikim gjatë kësaj periudhe dhe llojet e aktiviteteve për të cilat është komunikuar, pasi që kanë listuar mbi 14 prej tyre, por nuk ka dhënë listën e këtyre mediave e as sqarime më të hollësishme mbi llojet e aktiviteteve për të cilat është komunikuar me to. I njëjti vlerësim (prej 2 pikësh, 50%) është dhënë, por nuk ka dhënë listën e këtyre mediave e as sqarime më të hollësishme mbi llojet e aktiviteteve për të cilat është komunikuar me to.

MZHE ka dhënë listën prej 4 projektligjesh të sponsorizuara nga ana e saj gjatë periudhës janar 2010 – maj 2011, por meqë nuk kanë përmendur asnjë akter jashtë-qeveritar vendor të përfshirë në hartimin e tyre, është vlerësuar me 2 pikë (50%). Në anën tjetër, vlerësim prej 1 pikësh (25%) është dhënë sa i përket përfshirjes së akterëve jashtë-qeveritarë në hartimin e dokumenteve të saj të politikave relevante për komunikim dhe informim publik, pasi që është përmendur një dokument i tillë, por asnjë akter jashtë-qeveritar të përfshirë në hartimin e tij. Vlerësim më i ulët se kaq (prej 0 pikësh, 0%) është dhënë sa i përket përfshirjes së këtyre lloj akterësh në implementimin e dokumenteve të politikave, pasi që nuk është dhënë asnjë informatë. Po i njëjti vlerësim (0 pikë, 0%) është dhënë sa i përket përfshirjes së akterëve jashtë-qeveritarë në monitorimin dhe vlerësimin e implementimit të dokumenteve të politikave, pasi që as në këtë pikë nuk është dhënë asnjë informatë.

Në ndërkohë, pika që ndërlidhet me ueb-faqen e kësaj ministrie është vlerësuar maksimalisht (4 nga 4 pikë, 100%), pasi që është deklaruar se kjo ministri posedon ueb-faqen e saj zyrtare (www.mem.rks-gov.net) dhe janë përmendur kategoritë kryesore të informatave të publikuara në të (gjë që gjithashtu mund të monitorohet lehtë). Meqë MZHE nuk ka dhënë asnjë informatë specifike sa u përket aktiviteteve shtesë të komunikimit dhe informimit publik, është vlerësuar me 0 pikë (0%). Në fund, kjo ministri ka dhënë të dhënat mbi kualifikimet, përvojën dhe trajnimet e ndjekura nga stafi i Zyrës

për Informim Publik (gjithsej 4 zyrtarë), të cilët posedojnë arsimim relativisht relevant për punën që bëjnë, në ndërkohë që nuk kanë specifikuar asgjë mbi relevancën e përvojës së punës (e cila sillet nga 3 deri në 9 vjet), por meqë nuk kanë dhënë asnjë informatë mbi trajnimet e ndjekura, prandaj është vlerësuar me 3 pikë (75%).

Për të ***përmbledhur***, bazuar në informatat e dhëna për qëllim të këtij studimi dhe vlerësimin e tyre në përputhje me Sistemin e Pikëve të Transparencës Institucionale (SPTI), ***Ministria e Zhvillimit Ekonomik***, me ***Indeksin e Transparencës Institucionale (ITI) prej 24.5***, rezulton se është institucion ***i mbyllur***.

Institucionet e pavarura dhe agjencitë ekzekutive

Në studimin e këtij viti janë përfshirë pesë (5) institucione të kësaj kategorie: Agjencia kosovare Kundër Korrupsionit, Agjencia për Privatizim e Kosovës, Dogana e Kosovës, Institucioni i Avokatit të Popullit dhe Këshilli Gjyqësor i Kosovës.

Për të ***përmbledhur***, bazuar në informatat e dhëna për qëllime të këtij studimi dhe vlerësimin e tyre në përputhje me Sistemin e Pikëve të Transparencës Institucionale (SPTI), të pesë ***institucionet e pavarura dhe agjencitë ekzekutive*** të përfshira në studimin e këtij viti, me ***mesataren e Indeksit të Transparencës Institucionale (ITI) prej 56.1***, rezultojnë se janë institucione ***pjesërisht të hapura***.

11. Agjencia kosovare Kundër Korrupsionit (AKK)

Sipas të dhënave të ofruara nga AKK, dokumenti ligjor që themelon këtë institucion (Ligji mbi AKK-në) përcakton detyrimin e tij për të zbatuar obligimi kushtetues për të mundësuar qasjen e qytetarëve në dokumente publike, përfshirë rregullimin e asaj se çfarë dokumentesh e të dhënash duhet publikuar e çfarë janë konfidenciale në kuadër të fushëveprimit specifik të këtij institucioni të pavarur, prandaj vlerësimi i dhënë është 4 pikë (100%, 2 pikë më tepër se vitin e kaluar). AKK gjithashtu ka specifikuar se posedon rregulla procedurale për zbatimin e këtyre obligimeve kushtetuese dhe ligjore, si dhe se gjithashtu vepron bazuar në UA për Zbatimin e Ligjit për Qasje në Dokumente Zyrtare, por meqë nuk kanë specifikuar fushëveprimin, kohën dhe formën e hyrjes në fuqi të këtyre rregullave procedurale, e as strukturat e resurset që e obligojnë t'i ketë në dispozicion për zbatimin e tyre, është vlerësuar me 1 pikë (25%, 1 pikë më pak se vitin e kaluar). I njëjti vlerësim (1 pikë, 25%, 1 pikë më pak se vitin e kaluar) është dhënë sa u përket mekanizmave dhe masave zbatuese që parasheh ky akt nënligjor, pasi që janë përmendur vetëm dispozitat përkatëse, por nuk është dhënë asnjë shpjegim në lidhje me përmbajtjen e tyre dhe masat e mekanizmat e zhvilluar për të mundësuar zbatimin efektiv të tyre.

Sa i përket çështjes së klasifikimit të dokumenteve publike, AKK vetëm ka përmendur aktet ligjore dhe nënligjore, si dhe aktet e brendshme të këtij institucioni (Ligji mbi AKK-në, Ligji për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe të Dhuratave të Zyrtarëve të Lartë Publikë, UA për Zbatimin e Ligjit për Qasje në Dokumente Zyrtare dhe Rregullat Procedurale të AKK-së), që rregullojnë këtë çështje, por meqë nuk kanë dhënë asnjë shpjegim mbi mekanizmat dhe masat zbatuese, është dhënë vlerësim me 2 pikë (50%, 2 më pak se vitin e kaluar). Sa i përket çështjes së përdorimit të gjuhëve zyrtare dhe atyre në përdorim në Kosovë, AKK vetëm ka përmendur se çfarë parasheh Kushtetuta dhe rregullat procedurale të saj, por pasi që nuk kanë dhënë asnjë informatë në lidhje me mekanizmat dhe masat zbatuese, është dhënë vlerësim prej 1 pikësh (25%, 1 pikë më pak se vitin e kaluar).

Në nivelin e strukturave të brendshme institucionale për komunikim dhe informim publik, AKK ka specifikuar se organogrami i këtij institucioni, përkatësisht Vendimi për organizimin dhe sistematizimin e brendshëm të saj, parasheh funksionimin e Zyrës për Komunikim dhe Informim të Publikut në kuadër të kësaj agjencie, por pasi që nuk ka shpjeguar më në hollësi funksionimin e saj në kuadër të hierarkisë së gjithëmbarshme të institucionit, vlerësimi i dhënë në këtë pikë është 2 pikë (50%, 2 më pak se vitin e kaluar). Ky institucion gjithashtu ka deklaruar se posedon Termat e Referencës së kësaj zyre, por pasi që nuk ka dhënë përmbajtjen e tyre e as ndonjë shpjegim mbi mekanizmat e masat zbatuese, është vlerësuar me 2 pikë (50%, 1 më pak se vitin e kaluar). E njëjta vlen (vlerësim prej 2 pikësh, 50%, 1 më pak se vitin e kaluar) sa u përket Përshkrimit të Vendit të Punës për zyrtarin e saj për informim, pasi që nuk kanë dhënë përmbajtjen e tyre e asnjë shpjegim shtesë rreth tyre. Një vlerësim prej 3 pikësh (75%, 1 më pak se vitin e kaluar) është dhënë sa u përket standardeve të raportimit e monitorimit të brendshëm dhe të vlerësimit të punës, pasi që vetëm kanë deklaruar se posedojnë procedurat dhe se raportohet në bazë javore, por nuk kanë dhënë shpjegime më të hollësishme mbi mekanizmat dhe masat zbatuese të këtyre procedurave, e as mbi shpeshtësinë e tyre.

Në nivelin e resurseve, specifikisht sa i përket resurseve të alokuara Zyrës për Komunikim dhe Informim të Publikut gjatë periudhës janar 2010 – maj 2011, është thënë se resurset financiare janë mesatarisht të kënaqshme, por nuk është dhënë asnjë shpjegim shtesë mbi shumën e planifikuar dhe atë të alokuar të të gjitha kategorive të resurseve, dhe prandaj është vlerësuar me 2 pikë (50%, njëjtë si vitin e kaluar). Në anën tjetër, është dhënë një vlerësim më i vogël së kaq (1 pikë, 25%, 1 pikë më pak se vitin e kaluar) në pikën mbi resurset e alokuara gjatë së njëjtës periudhe kohore për implementimin e dokumenteve të politikave, përkatësisht të komponentëve për komunikim dhe informim publik, pasi që vetëm kanë deklaruar se është gjendje e njëjtë si vitin e kaluar dhe se pritet shtim të numrit të stafit, por nuk kanë dhënë asnjë shpjegim të mëtejshëm specifik mbi shumën e resurseve të të gjitha kategorive që janë planifikuar dhe alokuar. Pika e fundit në kategorinë e resurseve, ajo që ka të bëjë me resurset e alokuara për vitin në vijim, është vlerësuar me 3 pikë (75%, 1 pikë më pak se vitin e kaluar, pasi që është specifikuar shuma e resurseve humane e financiare të alokuara, por nuk janë dhënë shpjegime më të hollësishme mbi kategoritë e tjera të resurseve.

Në nivelin e dokumenteve të politikave që kanë të bëjnë me komunikim dhe informim publik, AKK vetëm ka përmendur Strategjinë dhe PV kundër Korrupsionit, por meqë nuk kanë dhënë listën e objektivave në fushën e komunikimit dhe informimit publik, e as nuk kanë sqaruar mekanizmat dhe masat për monitorim dhe raportim të implementimit të tyre, janë vlerësuar me 0.5 pikë (25%, 1.5 pikë më pak se vitin e kaluar). Në anën tjetër, vlerësim më i vogël se kaq (0 pikë, 0%, 2 pikë më pak se vitin e kaluar) është dhënë në pikën rreth mekanizmave e masave konkrete të paraparë nga ky dokument politikash për të siguruar qasjen në dokumente publike, pasi që informatat e dhëna nuk janë as konkrete e as specifike. Më tej, sa u përket aktiviteteve kyçe të paraparë për këtë vit për të siguruar qasjen në dokumente publike, është dhënë një vlerësim prej 0.5 pikësh (12.5%, 0.5 pikë më pak se vitin e kaluar), pasi që vetëm kanë përmendur synimin për fuqizimin e bashkëpunimit me shoqërinë civile dhe mediat, por nuk është dhënë asnjë shpjegim i mëtejshëm në aktivitetet specifike të planifikuara për të arritur këtë.

Në nivelin e bashkëpunimit me mediat dhe shoqërinë civile, përkatësisht vendosjes së komunikimit të drejtpërdrejtë dhe të rregullt me mediat dhe organizatat e shoqërisë civile, është dhënë vlerësim prej 1 pikësh (25%, 3 pikë më pak se vitin e kaluar), pasi që AKK vetëm ka deklaruar se ka vendosur kontakte të rregullta (ditore, javore dhe mujore) me të dy këto kategori të akterëve jashtë-qeveritarë, por nuk kanë shpjeguar konkretisht shpeshtësinë e komunikimit dhe aktivitetet specifike për të cilat komunikohet. Një vlerësim më i madh se kaq (3 pikë, 75%, 1 pikë më pak se vitin e kaluar) është dhënë në pikën që ka të bëjë me listën e mediave me të cilat AKK ka komunikim të rregullt dhe

llojet e aktiviteteve për të cilën komunikohet me to, pasi që vetëm është thënë se ka komunikim me të gjitha mediat e shkruara dhe elektronike, dhe janë listuar disa fusha (jo aktivitete konkrete) për të cilat komunikohet me to. Sa u përket organizatave të shoqërisë civile të përfshira në punën e saj, AKK është vlerësuar me 2 pikë (50%, 2 pikë më pak se vitin e kaluar, për shkak se vetëm kanë përmendur disa organizata të tilla (gjithsej 5), por nuk kanë dhënë listën e aktiviteteve konkrete përkatëse.

Sa i përket përfshirjes së akterëve jashtë-qeveritarë në hartimin e ligjeve në fushëveprimin e AKK-së, është dhënë vlerësim me 1 pikë (25%, njëjtë si vitin e kaluar), për shkakun se është dhënë vetëm lista e projektligjeve të propozuara nga AKK për rishikim, por jo edhe lista e akterëve jashtë-qeveritarë të përfshirë në hartimin e secilit prej tyre. I njëjti vlerësim, (1 pikë, 25%, njëjtë si vitin e kaluar) është dhënë për pikën që ka të bëjë me përfshirjen e akterëve jashtë-qeveritarë në hartimin e dokumenteve të politikave të AKK-së, pasi që vetëm i është referuar këtyre akterëve, por nuk është dhënë lista e akterëve të veçantë të përfshirë. Përgjigje e ngjashme e përgjithshme është dhënë sa i përket përfshirjes së akterëve jashtë-qeveritarë në implementimin e dokumenteve të politikave të AKK-së, pra mungon lista e akterëve të veçantë jashtë-qeveritarë të përfshirë, prandaj është dhënë vlerësim me 1 pikë (25%, njëjtë si vitin e kaluar). Në fund të kësaj kategorie çështjesh, AKK ka dhënë listën e akterëve jashtë-qeveritarë të përfshirë në monitorimin dhe vlerësimin e implementimit të dokumentit të tyre të politikave, por meqë mungojnë sqarime më të hollësishme mbi kohëzgjatjen dhe aktivitetet konkrete, është vlerësuar me 2 pikë (50%, 2 pikë më pak se vitin e kaluar).

I njëjti vlerësim si vitin e kaluar (4 pikë, 100%) është dhënë në pikën rreth ueb-faqes së AKK-së (www.akk-ks.org), pasi që është dhënë lista e dokumenteve që përmban ajo dhe gjuhët në të cilat janë publikuar (edhe pasi që mund të monitorohet lehtë). Kurse sa u përket masave dhe aktiviteteve shtesë të ndërmarra nga AKK është dhënë vlerësim prej 4 pikësh (100%, 4 pikë më tepër se vitin e kaluar), pasi që kanë listuar dy aktivitete të rëndësishme (publikimi i një analize mbi punën e gjykatave në raste specifike të korrupsionit dhe i një baze të dhënash për deklarimin e pasurisë). Në fund, në rubrikën mbi kapacitetet e zyrtarit të saj përgjegjës për komunikim dhe informim publik, AKK ka dhënë hollësitë përkatëse: kualifikim adekuat, përvojë pune prej 4 vitesh dhe trajnime relevante me kohëzgjatje prej 2 muajsh, prandaj është vlerësuar maksimalisht (4 pikë, 100%, njëjtë si vitin e kaluar).

Për të ***përmbledhur***, bazuar në informatat e dhëna për qëllim të këtij studimi dhe vlerësimin e tyre në përputhje me Sistemin e Pikëve të Transparencës Institucionale (SPTI), ***Agjencia kosovare Kundër Korrupsionit***, me ***Indeksin e Transparencës Institucionale (ITI) prej 48*** (21 më pak se vitin e kaluar), rezulton të jetë institucion ***i mbyllur***.

12. Agjencia për Privatizim e Kosovës

Agjencia për Privatizim e Kosovës nuk është përfshirë në studimin e vitit të kaluar, pasi që nuk i është përgjigjur kërkesës për pjesëmarrje në të. Sa i përket reflektimit të dispozitave kushtetuese dhe ligjore për komunikim dhe informim publik në kuadër të dokumentit themelues të saj, APK ka sqaruar se kjo parashihet në Ligjin për APK-në, dhe ka dhënë përmbajtjen e dispozitave përkatëse, prandaj është vlerësuar me 4 pikë (100%). Më tej, ajo ka dhënë përmbajtjen e dispozitave që përcaktojnë në përgjithësi obligimet, strukturat dhe resurset për komunikim dhe informim publik, por pasi që nuk ka shpjeguar më në hollësi mekanizmat e masat zbatuese, është vlerësuar me 2 pikë (50%). I njëjti vlerësim (prej 2 pikësh, 50%) është dhënë në pikën mbi mekanizmat dhe masave zbatuese të përpara me aktet përkatëse nënligjore, pasi që kanë dhënë përmbajtjen e dispozitave përkatëse ligjore, por nuk kanë shpjeguar në hollësi vënien e tyre në zbatim.

Sipas informatave të dhëna, APK e ka të rregulluar çështjen e klasifikimit dhe seleksionimit të dokumenteve publike sipas Rregullave të Tenderit dhe Procedurave Operacionale: është dhënë përmbajtja e plotë e dispozitave përkatëse ligjore, por meqë nuk kanë shpjeguar mekanizmat dhe masat zbatuese, janë vlerësuar me 2 pikë (50%). I njëjti vlerësim (prej 2 pikësh, 50%) është dhënë sa i përket rregullimit të çështjes së përdorimit të gjuhëve zyrtare dhe atyre në përdorim, pasi që edhe në këtë rast vetëm kanë përmendur obligimet ligjore (sipas aktit nënligjor të sipërpërmendur), por nuk kanë dhënë asnjë sqarim mbi mekanizmat dhe masat zbatuese.

APK ka raportuar se në kuadër të strukturës së saj organizative funksionon Njësia për Shtyp dhe Marrëdhënie me Publikun, dhe kanë sqaruar obligimet kryesore të saj, si dhe pozitën e funksionimin e tij në kuadër të hierarkisë së agjencisë, prandaj është dhënë vlerësim prej 4 pikësh (100%). Sa u përket Termave të Referencës së kësaj njësie, kanë deklaruar se i posedojnë ato, por meqë nuk kanë dhënë asnjë të dhënë mbi përmbajtjen e tyre, e as shpjegime më të hollësishme mbi mekanizmat dhe masat zbatuese, i është dhënë vlerësim prej 2 pikësh (50%). Vlerësim i njëjtë (2 pikë, 50%) është dhënë sa u përket Përshkrimeve të Vendeve të Punës, pasi që kanë deklaruar se i posedojnë ato, por nuk kanë dhënë përmbajtjen e tyre, e as ndonjë shpjegim më të hollësishëm mbi këtë çështje. Sa u përket standardeve të raportimit e monitorimit të brendshëm, APK është vlerësuar me 3 pikë (75%), pasi që ka shpjeguar në përgjithësi mekanizmin e raportimit dhe vlerësimit të performancës së stafit në kuadër të hierarkisë së saj dhe kanë përmendur disa procedura për vlerësimin e performancës, por mungojnë sqarime më të hollësishme mbi standardet dhe procedurat e raportimit për çështje të tjera përveç vlerësimit të performancës së stafit.

Në aspektin e alokimit të resurseve kësaj njësie, ky institucion ka deklaruar se asaj i janë alokuar mjete të mjaftueshme buxhetore gjatë periudhës janar 2010 – maj 2011, por meqë nuk është thënë asgjë në lidhje me llojet e tjera të resurseve, është vlerësuar me 2 pikë (50%). Në anën tjetër, vlerësim i njëjtë (prej 2 pikësh, 50%) është dhënë sa u përket resurseve të alokuara për implementimin e komponentëve të dokumenteve të politikave dhe atyre planifikuese për komunikim dhe informim publik gjatë periudhës janar 2010 – maj 2011, pasi që vetëm kanë deklaruar në përgjithësi se janë alokuar resurse të mjaftueshme dhe ka nevojë edhe për një anëtar stafi, por nuk kanë dhënë asnjë shpjegim më të hollësishëm. Vlerësim më i lartë se kaq (prej 3.5 pikësh, 87.5%) është dhënë në pikën mbi resurset e alokuara për vitin vijues, pasi që kanë dhënë numrin e zyrtarëve (2), dhe shumën e buxhetit, por jo edhe të dhëna mbi kategori të tjera të resurseve të alokuara.

Vlerësim prej 2.5 pikësh (62.5%) është dhënë në pikën që ka të bëjë me dokumentet e politikave të kësaj ministrie për komunikim dhe informim publik, pasi që kanë dhënë listën e objektivave specifike në fushën e komunikimit dhe informimit publik (gjithsej 11 syresh, që janë pjesë e Planit të Punës së agjencisë), por nuk kanë dhënë asnjë shpjegim mbi mekanizmat dhe masat e monitorimit dhe raportimit. Në anën tjetër, vlerësim prej 0 pikësh (0%) është dhënë sa u përket masave konkrete të parapara nga dokumentet e saj të politikave për të siguruar qasjen në dokumente publike dhe mekanizmat e masat për monitorimin dhe raportimin e rregullt të zbatimit të tyre, pasi që informatat e dhëna nuk janë relevante. Vlerësim më i lartë (1 pikë, 25%) është dhënë në lidhje me aktivitetet konkrete për komunikim dhe informim publik, pasi që kanë përmendur vetëm një aktivitet, a as nuk kanë dhënë shpjegime të hollësishme mbi mekanizmat dhe masat zbatuese për të siguruar përmbushjen e objektivave të listuara më sipër.

Kjo agjenci është vlerësuar me 1 pikë (25%) sa i përket komunikimit të rregullt me media dhe organizata të shoqërisë civile gjatë periudhës janar 2010 – maj 2011, pasi që vetëm kanë deklaruar se kanë pasur komunikim të rregullt, por nuk kanë shpjeguar më në hollësi

llojet e aktiviteteve për të cilat është komunikuar. Vlerësim më i madh se kaq (prej 2 pikësh, 50%) është dhënë sa u përket mediave me të cilat APK ka pasur komunikim të rregullt gjatë kësaj periudhe, pasi që vetëm është thënë se ka pasur komunikim të rregullt me të gjitha, por mungojnë sqarime mbi aktivitetet konkrete për të cilat kanë komunikuar. Në anën tjetër, në pikën që ka të bëjë me bashkëpunimin me organizata të shoqërisë civile, ky institucion ka dhënë listën e këtyre organizatave (gjithsej 3 syresh) dhe llojin e bashkëpunimit, dhe është vlerësuar me 4 pikë (100%).

APK ka sqaruar se nuk ka të drejtë të sponsorizojë projektligje, por ka dhënë listën e projektligjeve që ka propozuar, përmes Qeverisë, gjatë periudhës janar 2010 – maj 2011 (gjithsej 3), por meqë nuk ka dhënë listën e organizatave të shoqërisë civile të konsultuara gjatë hartimit të tyre, është vlerësuar me 1 pikë (25%). I njëjti vlerësim (1 pikë, 25%) është dhënë në ndërlidhje me përfshirjen e akterëve jashtë-qeveritarë në hartimin e dokumenteve të saj të politikave relevante për komunikim dhe informim publik, pasi që ka përmendur dokumentin përkatës, por jo edhe organizatat e shoqërisë civile të përfshira. Në anën tjetër, vlerësim prej 0 pikësh (0%) është dhënë sa i përket përfshirjes së këtyre lloj akterësh në implementimin e dokumenteve të politikave, pasi që informatat e dhëna nuk janë relevante. Një vlerësim më i lartë (1 pikë, 25%) është dhënë sa i përket përfshirjes së akterëve jashtë-qeveritarë në monitorimin dhe vlerësimin e implementimit të dokumenteve të politikave, pasi që janë listuar këta lloj akterësh, por nuk është saktësuar fushëveprimi i tyre në monitorimin dhe vlerësimin e implementimit të dokumenteve përkatëse të politikave.

Vlerësim prej 4 pikësh (100%) është dhënë në pikën rreth ueb-faqes së APK-së (www.pak-ks.org), pasi që është dhënë lista e dokumenteve që përmban ajo dhe gjuhët në të cilat janë publikuar (edhe pasi që mund të monitorohet lehtë). Kurse sa u përket masave dhe aktiviteteve shtesë të ndërmarra nga APK është dhënë vlerësim prej 3 pikësh (75%), pasi që kanë listuar aktivitete shtesë, kryesisht me mediat, për informim më të mirë mbi punën e Agjencisë. Në fund, në rubrikën mbi kapacitetet e zyrtarit të saj përgjegjës për komunikim dhe informim publik, APK ka dhënë hollësitë përkatëse: kualifikim adekuat, përvojë pune mbi 5 vite dhe trajnime relevante me kohëzgjatje prej mbi 3 muaj, prandaj është vlerësuar maksimalisht (4 pikë, 100%).

Për të ***përmbledhur***, bazuar në informatat e dhëna për qëllim të këtij studimi dhe vlerësimin e tyre në përputhje me Sistemin e Pikëve të Transparencës Institucionale (SPTI), ***Agjencia për Privatizim e Kosovës***, me ***Indeksin e Transparencës Institucionale (ITI) prej 55***, rezulton se është institucion ***pjesërisht i hapur***.

13. Dogana e Kosovës (DK)

Dogana e Kosovës ka specifikuar të gjitha aktet ligjore dhe nënligjore që rregullojnë punën e saj dhe dispozitat përkatëse në kuadër të tyre për zbatimin e dispozitave kushtetuese dhe ligjore për qasje në dokumentet publike (Kodin Doganor dhe të Akcizave, UA mbi Procedurat e Informimit, Publikimet dhe Komunikimin në Doganë) si dhe ka sqaruar në hollësi mekanizmat specifikë se si sigurohet zbatimi i rregullt i këtyre obligimeve (ata gjithashtu kanë dërguar UA në fjalë), dhe është vlerësuar me 4 pikë (100%, njëjtë si vitin e kaluar). I njëjti vlerësim (prej 4 pikësh, 100%, njëjtë si vitin e kaluar) është dhënë sa i përket aktit nënligjor që përcakton strukturat, resurset dhe obligimet përkatëse specifike brenda këtij institucioni për komunikim dhe informim publik, pasi që ky institucion ka dërguar këtë akt bashkë me pyetësorin e plotësuar (UA nr. 80-2009 mbi Procedurat e Informimit në Doganën e Kosovës), si dhe ka sqaruar instrumentet përkatëse për zbatimin e tij. Po i njëjti vlerësim (prej 4 pikësh, 100%, njëjtë si vitin e kaluar) është dhënë në pikën që ka të bëjë me masat zbatuese të parapara me këtë akt nënligjor, pasi që është

dhënë e tërë lista e masave të tilla të parapara, të cilat janë të qarta, si nga aspekti i procedurave ashtu edhe ai i resurseve që alokohen.

Edhe pika që ka të bëjë me klasifikimin dhe seleksionimit të dokumenteve publike është vlerësuar maksimalisht (4 pikë, 100%, njëjtë si vitin e kaluar), pasi që DK ka sqaruar të gjitha elementet dhe kriteret për këtë dhe mekanizmat e masat zbatuese për këtë. I njëjti vlerësim (prej 4 pikësh, 100%, 1 pikë më tepër se vitin e kaluar) është dhënë sa i përket çështjes së përdorimit të gjuhëve, pasi që është përmendur dhe dërguar UA i sipërpërmendur i këtij institucioni.

Në nivelin e strukturave të brendshme institucionale, duke filluar me organogramin, DK ka dërguar organogramin e saj (të rishikuar këtë vit) dhe ka sqaruar se ai parasheh funksionimin e Zyrës për Komunikim dhe Informim në kuadër të Kabinetin e Drejtorit të Përgjithshëm të saj, prandaj është vlerësuar me 4 pikë (100%, njëjtë si vitin e kaluar). Sa u përket Termave të Referencës së kësaj zyre, DK ka dërguar ato, dhe ka sqaruar se çfarë parashohin ato, prandaj është vlerësuar me 4 pikë (100%, 1 pikë më tepër se vitin e kaluar). I njëjti vlerësim (prej 4 pikësh, 100%, 3 pikë më tepër se vitin e kaluar) është dhënë në pikën rreth Përshkrimeve të Vendeve të Punës për stafin përgjegjës për komunikim dhe informim publik, pasi që ka dërguar një kopje të tyre dhe kanë shpjeguar mbi PVP për secilin pjesëtar të stafit. Po i njëjti vlerësim (prej 4 pikësh, 100%, 2 pikë më tepër se vitin e kaluar) është dhënë sa u përket standardeve të raportimit e monitorimit të brendshëm dhe të vlerësimit të punës, pasi që janë përmendur ato dhe shpeshtësia e përdorimit të tyre, si dhe është sqaruar mënyra e kryerjes së tyre, por gjithashtu kanë dërguar vlerësimin më të fundit të Komisionit Evropian, në përputhje me '*Blueprint*' (*'modelin standard'*) të BE-së për dogana.

Në nivelin e resurseve të alokuara për periudhën që mbulon ky raport, DK ka dhënë sqarime mbi numrin e stafit dhe ka dërguar planin buxhetor për periudhën 2010 – 2013 për Zyrën për Komunikim dhe Informim, dhe nuk është theksuar ndonjë problem sa i përket kësaj, prandaj është vlerësuar me 4 pikë (100%, njëjtë si vitin e kaluar). I njëjti vlerësim (4 pikë, 100%, njëjtë si vitin e kaluar) është dhënë në pikën që ka të bëjë me resurset e alokuara për implementimin e plotë të komponentëve që ndërlidhen me komunikimin dhe informimin publik në kuadër të dokumenteve të politikave dhe planit vjetor të punës, pasi që kanë dhënë shumën e mjeteve financiare të alokuara, numrin e stafit, rolin e udhëheqësve të degëve të Doganës në tërë vendin në fushën e komunikimit dhe informimit publik, por edhe indikatorët përmes të cilëve ky institucion e kryen vetë-vlerësim të performancës në këtë fushë. Edhe nënkategoria e fundit nga kategoria e resurseve, ajo e resurseve të alokuara për vitin aktual, ka marrë vlerësim maksimal prej 4 pikësh (100%, njëjtë si vitin e kaluar), pasi që është dhënë shuma e saktë e të tria kategorive të resurseve për të cilat është kërkuar informata.

Në nivelin e dokumenteve të politikave, DK ka miratuar Planin për Marrëdhënie me Publikun për 2010, i cili rrjedh nga Strategjia Operative 2011 – 2013 (të cilin edhe e kanë dërguar), gjë që tregon se ka qasje strategjike (pasi që një dokument planifikues rrjedh nga një dokument strategjik shumëvjeçar, Korniza Strategjike Operative e Doganës 2011 – 2013) dhe planifikimi i aktiviteteve konkrete për arritjen e objektivave strategjike bëhet çdo vit), si dhe fakti se mekanizmat e brendshëm të raportimit dhe monitorimit tashmë janë shpjeguar dhe të dyja këto dokumente edhe janë dërguar, është dhënë vlerësimi prej 4 pikësh (100%, njëjtë si vitin e kaluar). I njëjti vlerësim (prej 4 pikësh, 100%, njëjtë si vitin e kaluar) është dhënë sa u përket mekanizmave dhe masave konkrete të parapara për të siguruar qasjen në dokumente publike janë listuar dhe shpjeguar masat kryesore të parapara për këtë qëllim (auditimi i brendshëm, me qëllim të monitorimit të respektimit të procedurave standarde dhe afateve, dhe raportet mujore, të cilat fokusohen në të arriturat apo dështimet e atij muaji kundrejt objektivave të Doganës, përfshirë ato që kanë të bëjnë me informimin dhe komunikimin publik). Edhe sa u përket aktiviteteve për

përmbushjen e objektivave të vendosura është dhënë vlerësim prej 4 pikësh (100%, njëjtë si vitin e kaluar), pasi që Plani i Veprimit i DK-së për 2011 (i cili gjithashtu është dërguar) parasheh një listë aktivitetesh për përmbushjen e objektivave strategjike që kanë të bëjnë me komunikim dhe informim publik.

Sa i përket vendosjes së komunikimit të drejtpërdrejtë dhe të rregullt me mediat dhe organizatat e shoqërisë civile, Dogana e Kosovës ka dhënë listën e mediave dhe OSHC-ve specifike me të cilat ka vendosur kontakte dhe bashkëpunim të rregullt, përfshirë përfshirjen e akterëve në hartimin e dokumenteve ligjore dhe të politikave (sipas varësisht nga çështja që preket), llojin e informatave që u dërgohen mediave, e kështu me radhë, prandaj është vlerësuar maksimalisht (me 4 pikë, 100%, njëjtë si vitin e kaluar). Gjithashtu janë shpjeguar llojet e aktiviteteve për të cilat komunikohet me mediat vendore, dhe në këtë pikë është vlerësuar njëjtë (me 4 pikë, 100%, njëjtë si vitin e kaluar), ashtu sikurse në pikën që ka të bëjë me bashkëpunimin me organizatat e shoqërisë civile dhe ato të komunitetit të biznesit (vlerësim prej 4 pikësh, 100%, njëjtë si vitin e kaluar), pasi që kanë listuar të gjitha me të cilat kanë bashkëpunuar gjatë periudhës janar 2010 – maj 2011 (gjithsej 8 prej tyre) dhe llojet specifike të aktiviteteve në të cilat është përfshirë secili prej tyre.

DK ka dhënë listën e projektligjeve të hartuara gjatë periudhës që mbulon ky raport (4 prej tyre) në fushën e kompetencave të këtij institucioni, por meqë nuk kanë listuar organizatat e shoqërisë civile të përfshira në hartimin e secilit prej tyre, është dhënë vlerësimi prej 2 pikësh (50%, 2 pikë me pak se vitin e kaluar). Vlerësim më i ulët se kaq (1 pikë, 25%, 3 pikë më pak se vitin e kaluar) është dhënë sa u përket dokumenteve të politikave të hartuar gjatë kësaj periudhës në fjalë, pasi që ka dhënë listën e këtyre dokumenteve, por sipas informatave të dhëna në hartimin e tyre nuk është përfshirë asnjë akter jashtë-qeveritar vendor. Në anën tjetër, DK ka marrë vlerësim maksimal (4 pikë, njëjtë si vitin e kaluar) është dhënë sa i përket përfshirjes së këtyre lloj akterësh në implementimin e dokumenteve strategjike, pasi që ky institucion ka shpjeguar se natyra e punës nuk mundëson përfshirje të drejtpërdrejtë të këtyre lloj akterësh në implementim. Më tej, sipas informatave të dhëna nga ky institucion, gjatë periudhës që mbulon ky raport nuk ka pasur asnjë akter jashtë-qeveritar vendor të përfshirë në monitorimin dhe vlerësimin e implementimit të dokumenteve të politikave të përmendur më sipër, prandaj janë vlerësuar me 2 pikë (50%, 2 pikë më pak se vitin e kaluar)

I njëjti vlerësim (4 pikë, 100%, njëjtë si vitin e kaluar) është dhënë në pikën rreth ueb-faqes së Doganës së Kosovës (www.dogana.rks-gov.net), pasi që është dërguar lista e plotë e dokumenteve që përmban dhe është shpjeguar çështja rreth gjuhëve në të cilat janë publikuar, por gjithashtu kanë sqaruar avancimet më të fundit në përmbajtjen dhe mekanizmat që ofron për përmirësimin e konsultimeve dhe bashkëpunimit me akterë jashtë-qeveritarë. I njëjti vlerësim (4 pikë, 100%, njëjtë si vitin e kaluar) është dhënë në lidhje me masat dhe aktivitetet shtesë të ndërmarra nga ky institucion, pasi që është kanë dhënë një listë aktivitetesh të tilla të ndërmarra gjatë periudhës që mbulon ky raport (ofrimi i informatave të sakta dhe të shpejta publikut, qoftë përmes komunikatave për shtyp, qoftë si përgjigje ndaj kërkesave specifike, publikimet e shpeshta të broshurave, statistikave e doracakëve dhe dy fushatave të informimit të publikut) me qëllim të rritjes së transparencës. Në fund, në rubrikën mbi kapacitetet e zyrtarëve të saj përgjegjës për komunikim dhe informim publik (gjithsej tre syresh), DK ka dhënë hollësitë përkatëse: kualifikim adekuat – që të tre, përvojë pune nga 4 deri në 6 vjet dhe trajnime relevante me kohëzgjatje nga 1 deri në mbi 3 muaj, prandaj është vlerësuar maksimalisht (4 pikë, 100%, njëjtë si vitin e kaluar).

Për të ***përmbledhur***, bazuar në informatat e dhëna për qëllim të këtij studimi dhe vlerësimin e tyre në përputhje me Sistemin e Pikëve të Transparencës Institucionale (SPTI), ***Dogana e Kosovës***, me ***Indeksin e Transparencës Institucionale (ITI) prej 93*** (3

më tepër se vitin e kaluar), rezulton se është institucion ***plotësisht i hapur***, pra ***institucioni më i hapur*** nga të gjitha institucionet e përfshira në këtë studim.

14. Institucioni i Avokatit të Popullit (IAP)

As Institucioni i Avokatit të Popullit nuk është përfshirë në studimin e vitit të kaluar, pasi që nuk i është përgjigjur kërkesës për pjesëmarrje në të. Sa i përket reflektimit të dispozitave kushtetuese dhe ligjore për komunikim dhe informim publik në kuadër të dokumentit themelues të saj, IAP ka përmendur dispozitat përkatëse në kuadër të Ligjit mbi Avokatin e Popullit dhe Rregulloren e Punës së këtij institucioni, por meqë nuk kanë dhënë përmbajtjen e këtyre dispozitave, është dhënë vlerësim prej 3 pikësh (75%).Më tej, sa u përket dispozitave që përcaktojnë obligimet, strukturat dhe resurset për komunikim dhe informim publik, IAP ka thënë se kjo nuk është e rregulluar me ndonjë akt të veçantë nënligjor, dhe prandaj është vlerësuar me 0 pikë (0%). Një vlerësim më i lartë, (prej 2 pikësh, 50%) është dhënë në pikën mbi mekanizmat dhe masave zbatuese, pasi që ky institucion ka sqaruar se sipas praktikave administrative të tij, të gjitha dokumentet e tij janë publike, përveç dosjeve të personave.

IAP është vlerësuar me 0 pikë (0%) në pikën që ka të bëjë me çështjen e klasifikimit dhe seleksionimit të dokumenteve publike senzitive, pasi që kanë pohuar se nuk posedojnë ndonjë akt nënligjor për këtë, por as nuk kanë sqaruar se si është e rregulluar ndryshe kjo çështje. Në anën tjetër, ky institucion ka pohuar se përdorimi i gjuhëve zyrtare dhe atyre në përdorim është i rregulluar sipas Ligjit për Përdorimin e Gjuhëve dhe se është praktikë administrative e institucionit që të komunikojë më palët në gjuhën e tyre amtare, por meqë nuk kanë dhënë ndonjë shpjegim mbi masat e mekanizmat zbatuese, është dhënë vlerësim prej 2 pikësh (50%).

IAP ka raportuar se në kuadër të strukturës së tij organizative funksionon Zyra për Media dhe Marrëdhënie me Publikun, por meqë nuk kanë sqaruar në hollësi pozitën e saj në hierarkinë e gjithëmbarshme të institucionit, është dhënë vlerësim prej 3 pikësh (75%). Sa u përket Termave të Referencës së kësaj zyre, ata kanë deklaruar se i posedojnë ato, por meqë nuk kanë dhënë asnjë të dhënë mbi përmbajtjen e tyre, e as shpjegime më të hollësishme mbi mekanizmat dhe masat zbatuese, është dhënë vlerësim prej 2 pikësh (50%). E njëjta vlen (vlerësim me 2 pikë, 50%) sa u përket Përshkrimeve të Vendeve të Punës së dy zyrtarëve të kësaj zyre, pasi që kanë deklaruar se ato ekzistojnë, por nuk kanë dhënë përmbajtjen e tyre, e as ndonjë shpjegim më të hollësishëm mbi këtë çështje. Sa u përket standardeve të raportimit e monitorimit të brendshëm, IAP është vlerësuar me po aq pikë (3, 75%), pasi që vetëm kanë deklaruar se bëjnë vlerësimin e performancës në baza vjetore, por nuk kanë përmendur asnjë procedurë tjetër e as kanë dhënë ndonjë shpjegim shtesë.

Në aspektin e alokimit të resurseve kësaj zyre gjatë periudhës janar 2010 – maj 2011, ky institucion ka deklaruar se shuma e resurseve humane dhe buxhetore të alokuara është e pamjaftueshme dhe se kërkesat e tyre buxhetore për 2010 dhe 2011 nuk janë miratuar nga Kuvendi sipas kërkesës, pa dhënë ndonjë shpjegim me shifra, dhe janë vlerësuar me 2 pikë (50%). Në anën tjetër, vlerësim prej 0 pikësh (0%) është dhënë në lidhje me resurset e alokuara për implementimin e komponentëve të dokumenteve të politikave dhe atyre planifikuese për komunikim dhe informim publik gjatë periudhës janar 2010 – maj 2011, pasi që informatat e dhëna nuk janë as konkrete e as specifike. Vlerësim më i lartë se kaq (prej 2 pikësh, 50%) është dhënë në pikën mbi resurset e alokuara për vitin vijues, pasi që kanë dhënë vetëm numrin e zyrtarëve për komunikim dhe informim publik (2), por jo edhe për kategori të tjera të tyre.

Vlerësim prej 0 pikësh (0%) është dhënë në pikën që ka të bëjë me dokumentet e politikave të këtij institucioni në fushën e komunikimit dhe informimit publik, pasi që kanë deklaruar se nuk posedojnë ndonjë dokument të tillë. Rrjedhimisht, nuk ka as një listë masash konkrete për të siguruar qasjen në dokumente publike, prandaj është dhënë vlerësim i njëjtë (prej 0 pikës, 0%). E njëjta vlen (vlerësim prej 0 pikësh, 0%) është dhënë në lidhje me aktivitetet konkrete për komunikim dhe informim publik të parapara për t'u kryer gjatë periudhës që mbulon ky raport, pasi që kanë deklaruar se nuk posedojnë asgjë të tillë.

IAP është vlerësuar me 2 pikë (50%) sa i përket komunikimit të rregullt me media dhe organizata të shoqërisë civile gjatë periudhës janar 2010 – maj 2011, pasi që vetëm kanë deklaruar se kanë pasur komunikim të rregullt, por se 'nuk mbajnë evidenca statistikore' mbi këtë. I njëjti vlerësim (prej 2 pikësh, 50%) është dhënë sa u përket mediave me të cilat IAP ka pasur komunikim të rregullt gjatë kësaj periudhe, pasi që vetëm është thënë se ka pasur komunikim të rregullt me të gjitha, por mungojnë sqarime mbi aktivitetet konkrete për të cilat kanë komunikuar. Në anën tjetër, në pikën që ka të bëjë me bashkëpunimin me organizata të shoqërisë civile, ky institucion ka dhënë listën e këtyre organizatave (gjithsej 7 syresh), por pasi që nuk ka shpjeguar llojet e aktiviteteve për të cilat është bashkëpunuar, është vlerësuar me 2 pikë (50%).

Meqë IAP ka sqaruar se nuk ka të drejtë të sponsorizojë projektligje, është vlerësuar me 4 pikë (100%). Vlerësim prej 0 pikësh (0%) është dhënë në ndërlidhje me përfshirjen e akterëve jashtë-qeveritarë në hartimin e dokumenteve të tij të politikave relevante për komunikim dhe informim publik, pasi që informatat e dhëna janë jo-relevante. E njëjta vlen (vlerësim prej 0 pikësh, 0%) sa i përket përfshirjes së këtyre lloj akterësh në implementimin e dokumenteve të politikave, pasi që informatat e dhëna nuk janë relevante. Një vlerësim më i lartë (2 pikë, 50%) është dhënë sa i përket përfshirjes së akterëve jashtë-qeveritarë në monitorimin dhe vlerësimin e implementimit të dokumenteve të politikave, pasi që është përmendur një organizatë dhe periudha e përfshirjes, por nuk është saktësuar fushëveprimi i tyre në monitorimin dhe vlerësimin e implementimit të dokumenteve përkatëse të politikave.

Vlerësim prej 4 pikësh (100%) është dhënë në pikën rreth ueb-faqes së këtij institucioni të pavarur (www.ombudspersonkosovo.org), pasi që është dhënë lista e dokumenteve që përmban ajo dhe gjuhët në të cilat janë publikuar (edhe pasi që mund të monitorohet lehtë). Kurse sa u përket masave dhe aktiviteteve shtesë të ndërmarra nga IAP është dhënë vlerësim prej 0 pikësh (0%), pasi që nuk kanë përmendur asnjë aktivitet të tillë. Në fund, në rubrikën mbi kapacitetet e zyrtarëve të tij përgjegjës për komunikim dhe informim publik (megjithëse më sipër ka deklaruar se ka 2 zyrtarë të tillë, ka dhënë informata vetëm për një zyrtar), IAP ka dhënë hollësitë përkatëse: kualifikim jo plotësisht adekuat, përvojë pune mbi 5 vite dhe trajnime relevante me kohëzgjatje prej mbi 3 muaj, prandaj është vlerësuar me 3 pikë (75%).

Për të ***përmbledhur***, bazuar në informatat e dhëna për qëllim të këtij studimi dhe vlerësimin e tyre në përputhje me Sistemin e Pikëve të Transparencës Institucionale (SPTI), ***Institucioni i Avokatit të Popullit***, me ***Indeksin e Transparencës Institucionale (ITI) prej 39***, rezulton se është institucion ***i mbyllur***.

15. Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK)

Këshilli Gjyqësor i Kosovës nuk është përfshirë në studimin e vitit të kaluar, pasi që nuk i është përgjigjur kërkesës për pjesëmarrje në të. Sa i përket reflektimit të dispozitave kushtetuese dhe ligjore për komunikim dhe informim publik në kuadër të dokumentit themelues të saj, KGJK ka përmendur dy akte ligjore (Ligjin mbi Gjykatat e Rregullta dhe

LQDP-në) dhe tri akte nënligjore (UA për Implementimin e LQDZ-së, Rregulloren për Organizimin e Brendshëm të Gjykatave dhe Doracakun për Menaxhimin e Gjykatave), por meqë nuk janë specifikuar as dispozitat përkatëse e as nuk është dhënë përmbajtja e tyre, është dhënë vlerësim prej 2 pikësh (50%). Më tej, sa u përket dispozitave që përcaktojnë obligimet, strukturat dhe resurset për komunikim dhe informim publik, KGJK vetëm ka përmendur Doracakun për Menaxhimin e Gjykatave, por meqë nuk kanë dhënë asnjë shpjegim mbi strukturat, resurset dhe obligimet që dalin nga ajo, është vlerësuar me 1 pikë (25%). Në anën tjetër, një vlerësim prej 4 pikësh (100%) është dhënë në pikën mbi mekanizmat dhe masave zbatuese, pasi që ky institucion ka listuar tri prej tyre dhe ka sqaruar qëllimin dhe fushëveprimin e Doracakut për Menaxhimin e Gjykatave sa i përket fushës së komunikimit dhe informimit publik.

KGJK është vlerësuar me 1 pikë (25%) në pikën që ka të bëjë me çështjen e klasifikimit dhe seleksionimit të dokumenteve publike senzitive, pasi që vetëm i janë referuar LQDP-së, por nuk kanë dhënë asnjë shpjegim shtesë mbi dispozitat konkrete e as mbi mekanizmat e masat zbatuese. I njëjti vlerësim (prej 1 pikësh, 25%) është dhënë sa i përket përdorimit të gjuhëve zyrtare dhe atyre në përdorim, pasi që vetëm i janë referuar Ligjit për Përdorimin e Gjuhëve, por nuk kanë dhënë asnjë shpjegim shtesë mbi dispozitat konkrete e as mbi mekanizmat e masat zbatuese.

KGJK ka deklaruar se në kuadër të strukturës së tij organizative funksionon Zyra për Informim dhe Protokoll, por meqë nuk kanë sqaruar në hollësi pozitën e saj në hierarkinë e gjithëmbarshme të institucionit, është dhënë vlerësim prej 2 pikësh (50%). Sa u përket Termave të Referencës së kësaj zyre, është dhënë vlerësim prej 0 pikësh (0%), pasi që nuk kanë dhënë informata konkrete dhe specifike. Një vlerësim më i lartë se kaq (prej 2 pikësh, 50%) është dhënë sa u përket Përshkrimeve të Vendeve të Punës së dy zyrtarëve të kësaj zyre, pasi që kanë deklaruar se ato ekzistojnë (në kuadër të Rregullores së KGJK-së për Përshkrimin e Detyrave të Punës), por nuk kanë dhënë përmbajtjen e tyre, e as ndonjë shpjegim më të hollësishëm mbi këtë çështje. I njëjti vlerësim (prej 2 pikësh, 50%) është dhënë sa u përket standardeve të raportimit e monitorimit të brendshëm, pasi që vetëm u janë referuar dispozitave përkatëse të Ligjit për Shërbim Civil, por nuk kanë dhënë asnjë shpjegim mbi mekanizmat dhe masat zbatuese.

Sa i përket alokimit të resurseve kësaj zyre gjatë periudhës janar 2010 – maj 2011, KGJK ka deklaruar se resurset e alokuara nuk janë të mjaftueshme, por meqë nuk ka dhënë asnjë informatë konkrete mbi shumën e resurseve të alokuara për secilën kategori, është vlerësuar me 1 pikë (25%). I njëjti vlerësim (prej 1 pikësh, 25%) është dhënë në lidhje me resurset e alokuara për implementimin e komponentëve të dokumenteve të politikave dhe atyre planifikuese për komunikim dhe informim publik gjatë periudhës janar 2010 – maj 2011, pasi që edhe këtu vetëm kanë thënë se resurset e alokuara nuk janë të mjaftueshme, por nuk ka dhënë asnjë informatë konkrete mbi shumën e resurseve të alokuara për secilën kategori. Vlerësim më i lartë se kaq (prej 2 pikësh, 50%) është dhënë në pikën mbi resurset e alokuara për vitin vijues, pasi që kanë dhënë vetëm shumën e resurseve njerëzore (1 zyrtar), por jo edhe për kategori të tjera të tyre.

Vlerësim prej 3 pikësh (75%) është dhënë në pikën që ka të bëjë me dokumentet e politikave të këtij institucioni në fushën e komunikimit dhe informimit publik, pasi që kanë listuar pesë objektiva të parapara në kuadër të Planit Strategjik për Gjyqësorin e Kosovës 2007 – 2012, të cilat objektiva parashohin edhe një pjesë të mekanizmave dhe masave zbatuese. Më tej, ky institucion është vlerësuar me 1 pikë (25%) sa u përket masave konkrete për të siguruar qasjen në dokumente publike, pasi që ka listuar 10 masa të tilla, por mungojnë informata mbi masat dhe mekanizmat për monitorim dhe raportim dhe shpeshtësinë e zbatimit të tyre. I njëjti vlerësim (prej 1 pike, 25%) është dhënë në lidhje me aktivitetet konkrete për komunikim dhe informim publik të parapara për t'u kryer gjatë periudhës që mbulon ky raport, pasi që vetëm kanë listuar 4 aktivitete të tilla,

por nuk kanë dhënë asnjë informatë shtesë mbi masat dhe mekanizmat për monitorim dhe raportim dhe shpeshtësinë e zbatimit të tyre.

KGJK është vlerësuar me 3 pikë (75%) sa i përket komunikimit të rregullt me media dhe organizata të shoqërisë civile gjatë periudhës janar 2010 – maj 2011, pasi që kanë deklaruar se kanë pasur komunikim të rregullt me të gjitha mediat, se kanë bashkëpunim të vazhdueshëm me njërin prej tyre (projektin 'Jeta në Kosovë') me synim specifik informimin e publikut dhe rritjen e transparencës së punës së gjyqësorit. Sa u përket organizatave të shoqërisë civile, gjithashtu kanë deklaruar se bashkëpunojnë me organizata që fokusohen në sundimin e ligjit, por nuk kanë dhënë ndonjë informatë mbi shpeshtësinë e komunikimit me to. I njëjti vlerësim (prej 3 pikësh, 75%) është dhënë sa u përket mediave me të cilat KGJK ka pasur komunikim të rregullt gjatë kësaj periudhe, pasi që vetëm kanë deklaruar se kryesisht komunikojnë përmes deklaratave për shtyp dhe ftesave dhe se u shpërndajnë rregullisht informata, por nuk kanë dhënë listën e mediave me të cilat kanë komunikuar. Po i njëjti vlerësim (prej 3 pikësh, 75%) është dhënë sa i përket bashkëpunimit me organizata të shoqërisë civile, pasi që kanë dhënë listën e këtyre organizatave (gjithsej 5 syresh), por nuk kanë shpjeguar llojet e aktiviteteve për të cilat është bashkëpunuar.

Meqë KGJK ka sqaruar se nuk ka të drejtë të sponsorizojë projektligje, është vlerësuar me 4 pikë (100%). Vlerësim prej 1 pike (25%) është dhënë sa i përket përfshirjes së akterëve jashtë-qeveritarë në hartimin e dokumenteve të tij të politikave relevante për komunikim dhe informim publik, pasi që kanë përmendur një dokument të tillë (për reduktimin e lëndëve të vjetra), por nuk kanë dhënë listën e akterëve të tillë të përfshirë në hartimin e tij. E njëjta vlen (vlerësim prej 1 pikësh, 25%) sa i përket përfshirjes së këtyre lloj akterësh në implementimin e dokumenteve të politikave, pasi që është përmendur e njëjta strategji, por nuk kanë dhënë listën e akterëve të tillë të përfshirë në monitorimin dhe vlerësimin e implementimit të saj. Në anën tjetër, një vlerësim më i ulët se kaq (0 pikë, 0%) është dhënë sa i përket përfshirjes së akterëve jashtë-qeveritarë në monitorimin dhe vlerësimin e implementimit të dokumenteve të politikave, pasi që informatat e dhëna nuk janë as konkrete e as specifike.

Vlerësim prej 4 pikësh (100%) është dhënë në pikën rreth ueb-faqes së këtij institucioni të pavarur (www.kgjk-ks.org), pasi që kanë deklaruar se dokumentet që posedojnë janë të publikuara në të dyja gjuhët zyrtare dhe në anglisht edhe pasi që mund të monitorohet lehtë). Kurse sa u përket masave dhe aktiviteteve shtesë të ndërmarra nga KGJK është dhënë vlerësim prej 0 pikësh (0%), pasi që nuk kanë përmendur asnjë aktivitet shtesë përveç aktiviteteve të listuara më sipër. Në fund, në rubrikën mbi kapacitetet e zyrtarit të tij përgjegjës për komunikim dhe informim publik, KGJK ka dhënë hollësitë përkatëse: kualifikim jo plotësisht adekuat, përvojë pune prej 17 vitesh, por nuk kanë dhënë asnjë informatë mbi trajnimet relevante të ndjekur nga zyrtari në fjalë, është vlerësuar me 2.5 pikë (62.5%).

Për të ***përmbledhur***, bazuar në informatat e dhëna për qëllim të këtij studimi dhe vlerësimin e tyre në përputhje me Sistemin e Pikëve të Transparencës Institucionale (SPTI), ***Këshilli Gjyqësor i Kosovës***, me ***Indeksin e Transparencës Institucionale (ITI) prej 45.5***, rezulton se është institucion ***i mbyllur***.

Ndërmarrjet publike

Nga tri (3) ndërmarrjet publike të nivelit qendror të kontaktuara për qëllim të këtij studimi (Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës, Korporata Energjetike e Kosovës, dhe Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës), vetëm PTK i është përgjigjur kërkesës për informata në kuadër të këtij studimi politikash.

16. Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës

Sipas të dhënave të PTK-së, funksionimi i aspektit të komunikimit dhe informimit publik të saj rregullohet nga Ligji për Ndërmarrjet Publike, Ligji për Shoqëritë Tregtare dhe matrica e autorizimeve të saj, por për shkakun se nuk është përmendur as dispozita konkrete që zbaton këtë obligim kushtetues, e as nuk është dhënë përmbajtja e saj e asnjë shpjegim tjetër më i hollësishëm, është dhënë vlerësim prej 1 pike (25%, 1 pikë më tepër se vitin e kaluar). Sa i përket aktit nënligjor që përcakton strukturat, resurset dhe obligimet e saj për komunikim dhe informim publik, PTK ka deklaruar se këto përcaktohen përmes dokumentit të quajtur 'matrica e autorizimeve të korporatës', si dhe disa vendime të Bordit të Drejtorëve (të cilët zbatojnë obligimet që dalin nga Ligji mbi Ndërmarrjet Publike), por meqë kanë dhënë shpjegime më të hollësishme mbi funksionimin e strukturave dhe resurset e parapara me akte të brendshme, është vlerësuar me 1.5 pikë (37.5%, 0.5 pikë më pak se vitin e kaluar). Një vlerësim prej 0 pikësh (0%, 2 pikë më pak se vitin e kaluar), është dhënë në pikën që ka të bëjë me mekanizmat dhe masat zbatuese të parapara, pasi që përgjigja e dhënë nuk është as konkrete e as specifike.

Sa i përket rregullimit të çështjes së klasifikimit dhe seleksionimit të dokumenteve publike, PTK ka shpjeguar se kjo bazohet në nenin 3 të LQDP-së, të Ligjit mbi Ndërmarrjet Publike dhe në dispozita të kontratave individuale, kurse arsyeshmëria e këtyre kufizimeve është mbrojtja e interesave komerciale dhe shmangia nga shkaktimi i dëmit, por pasi që nuk ka shpjeguar më në hollësi dispozitat e akteve nënligjore të kësaj ndërmarrjeje publike për fushën e komunikimit dhe informimit publik, është vlerësuar me 2 pikë (50%, 1 pikë më pak se vitin e kaluar). Nga ana tjetër, komponenti mbi përdorimin e gjuhëve zyrtare dhe atyre në përdorim në Kosovë është vlerësuar me 2 pikë (50%, 2 më pak se vitin e kaluar), pasi që vetëm kanë deklaruar përgjithësisht se respektojnë dispozitat ligjore, dhe se posedojnë një zyrë të përkthimeve, por nuk kanë dhënë informata mbi dispozitat konkrete në kuadër të akteve të brendshme ligjore e procedurale e as mbi mekanizmat e masat zbatuese.

Sa i përket ekzistencën në organogram të strukturave përgjegjëse për komunikim dhe informim, PTK është vlerësuar maksimalisht (4 pikë, 100%, njëjtë si vitin e kaluar), pasi që është shpjeguar se organogrami i kësaj ndërmarrjeje publike parasheh funksionimin e Departamentit për Komunikim dhe Informim Publik në kuadër të Zyrës së Kryeshefit Ekzekutiv (nën udhëheqjen e Drejtorit të tij), i cili ndahet në tri shtylla: për informim, për imazhin e korporatës dhe ai kreativ. Më tej, sa u përket Termave të Referencës së këtij departamenti, PTK ka shpjeguar në përgjithësi fushëveprimtarinë e tij dhe disa nga detyrat konkrete që kryen (nxjerrjen e botimeve, buletineve informative, njoftimeve, komunikatave brenda dhe jashtë kompanisë, monitorimin ditor të mediave të shkruara dhe elektronike, mbarëvajtjen operative dhe efektive të sistemit informativ, etj.), por meqë nuk kanë dhënë përmbajtjen konkrete të tyre, e as nuk kanë dhënë shpjegime më të hollësishme mbi mekanizmat e masat zbatuese, është vlerësuar me 3 pikë (75%, njëjtë si vitin e kaluar). Vlerësimi i njëjtë (3 pikë, 75%, njëjtë si vitin e kaluar) është dhënë në komponentin mbi Përshkrimet e Vendeve të Punës së stafit të saj, pasi që vetëm kanë deklaruar se ekzistojnë, por nuk kanë dhënë përmbajtjen konkrete të tyre, e as shpjegime më të hollësishme mbi to. Sa u përket standardeve dhe shpeshtësisë së monitorimit të brendshëm dhe vlerësimit të punës së stafit dhe mekanizmat e masat përkatëse zbatuese,

PTK vetëm ka deklaruar se performanca matet në baza ditore dhe çdo tremujor, por meqë nuk kanë dhënë shpjegime më të hollësishme konkrete është vlerësuar me 2 pikë (50%, 2 pikë më tepër se vitin e kaluar).

I njëjti vlerësim (prej 2 pikësh, 50%, njëjtë si vitin e kaluar) është dhënë sa u përket resurseve të alokuara Departamentit për Komunikim dhe Informim Publik gjatë periudhës që mbulon ky raport, pasi që vetëm kanë deklaruar se këto resurse alokohen duke u bazuar në vlerësim real të nevojave dhe parashihen në kuadër të Planit të Biznesit të Korporatës, por nuk kanë dhënë asnjë shpjegim më të saktë mbi shumën e resurseve të alokuara në kudër të secilës kategorie të resurseve. E njëjta vlen (vlerësim prej 2 pikësh, 50%, njëjtë si vitin e kaluar) sa i përket komponentit në lidhje me resurset e alokuara për zbatimin e dokumenteve planifikuese të kësaj ndërmarrjeje që kanë hyrë në fuqi gjatë kësaj periudhe, pasi që kanë deklaruar përgjithësisht se departamenti në fjalë është i kompletuar me staf, bazuar në vlerësimin e menaxhmentit përkatës, por nuk kanë dhënë asnjë shpjegim më të saktë mbi shumën e resurseve të alokuara në kudër të secilës kategorie të resurseve. Po i njëjti vlerësim (prej 2 pikësh, 50%, njëjtë si vitin e kaluar) është dhënë sa u përket resurseve të alokuara për zbatimin e dokumenteve planifikuese të saj, pasi që kanë dhënë shpjegime vetëm mbi numrin e stafit, por nuk kanë dhënë asnjë shpjegim më të saktë mbi shumën e resurseve të alokuara në kudër të kategorive të tjera.

Sa u përket dokumenteve planifikuese për komunikim dhe informim publik të miratuara gjatë kësaj periudhe dhe objektivave të përcaktuara në kuadër të tyre, PTK është vlerësuar me 0 pikë (0%, njëjtë si vitin e kaluar), pasi që kanë deklaruar se nuk kanë plane të tilla, e rrjedhimisht as ndonjë objektiv relevant për fushën e komunikimit dhe informimit publik. E njëjta vlen (vlerësim prej 0 pikësh, 0%, njëjtë si vitin e kaluar) edhe për komponentin tjetër, atë në lidhje me mekanizmat dhe masat konkrete të parapara për të siguruar qasjen në dokumente publike të kësaj ndërmarrjeje publike, pasi që vetëm është thënë se masat e ndërmarra, pa përmendur asnjërën prej tyre, janë ndërmarrë për të mbrojtur korporatën. Edhe komponenti i fundit në këtë kategori, ai mbi aktivitetet specifike për të siguruar qasjen në dokumente publike të kësaj ndërmarrjeje publike, është vlerësuar me 0 pikë (0%, njëjtë si vitin e kaluar), meqë është deklaruar se nuk ka aktivitete të tilla, por veprohet në varësi nga rastet specifike.

Sa i përket vendosjes së komunikimit të drejtpërdrejtë me mediat dhe organizatat e shoqërisë civile, PTK është vlerësuar me 2 pikë (50%, njëjtë si vitin e kaluar), pasi që vetëm kanë deklaruar se ka komunikim, bazuar në nevoja të dyanshme, por që nuk është dhënë asnjë shpjegim më i hollësishëm. I njëjti vlerësim (prej 2 pikësh, 50%, njëjtë si vitin e kaluar) është dhënë në lidhje me komunikimin me mediat e veçanta dhe llojet e aktiviteteve për të cilat komunikohet, pasi që vetëm është thënë se komunikohet me të gjitha mediat elektronike dhe të shkruara, por nuk është përmendur asnjë aktivitet për të cilat komunikohet. Vlerësim i njëjtë (2 pikë, 50%, 2 pikë më pak se vitin e kaluar) është dhënë në komponentin mbi listën e organizatave të shoqërisë civile të përfshira në punën e PTK-së dhe llojet e kësaj përfshirjeje (shkëmbim informatash, konsultime, bashkëpunim ose partneritet), pasi që vetëm kanë deklaruar se kjo lloj përfshirjeje mbulon të gjitha fushat e veprimit, specifikisht në çështje financiare, legale e resurse humane, por nuk kanë dhënë asnjë shpjegim më të hollësishëm mbi organizatat dhe aktivitetet konkrete.

Sa i përket përfshirjes së mediave dhe organizatave të shoqërisë civile në hartimin e legjislacionit relevant gjatë periudhës janar 2010 – maj 2011, kjo ndërmarrje publike është vlerësuar me 2 pikë (50%, 2 më pak se vitin e kaluar), pasi që vetëm kanë deklaruar përgjithësisht se janë përfshirë një numër organizatash të tilla në një numër aktivitetesh të tilla dhe kanë përmendur vetëm një akter jashtë-qeveritar të përfshirë. Vlerësim më i ulët se kaq (prej 0 pikësh, 0%, njëjtë si vitin e kaluar) është dhënë sa i përket përfshirjes së akterëve qeveritarë në hartimin e dokumenteve të politikave dhe atyre planifikuese

relevante për komunikim dhe informim publik gjatë periudhës që mbulon raporti, pasi që nuk kanë dhënë asnjë informatë.

Vlerësim prej 2 pikësh (50%, 2 më tepër se vitin e kaluar) është dhënë sa i përket përfshirjes së akterëve jashtë-qeveritarë në implementimin e dokumenteve të politikave dhe atyre planifikuese, pasi që vetëm kanë deklaruar përgjithësisht se menaxhmenti dhe aksionarët e saj përcaktojnë dhe implementojnë strategjitë përkatëse, por nuk kanë përmendur specifikisht për cilin dokument bëhet fjalë e as nuk kanë dhënë të dhëna më të hollësishme. Në anën tjetër, vlerësim më i ulët se kaq (prej 0 pikësh, 0%, 2 pikë më pak se vitin e kaluar) është dhënë sa i përket përfshirjes së akterëve jashtë-qeveritarë në monitorimin dhe vlerësimin e implementimit të dokumenteve të politikave dhe atyre planifikuese, pasi që nuk kanë dhënë asnjë informatë.

Sa i përket ueb-faqes zyrtare, është dhënë vlerësim prej 4 pikësh (100%, njëjtë si vitin e kaluar), pasi që PTK ka deklaruar se e posedon atë (www.ptkonline.com), dhe kanë sqaruar se cfarë lloje dokumentesh janë të publikuara në të (gjë që edhe mund të monitorohet lehtë). Nga ana tjetër, komponenti në lidhje me masat dhe aktivitetet shtesë të ndërmarra nga PTK sa i përket informimit dhe komunikimit publik është vlerësuar me 0 pikë (0%, njëjtë si vitin e kaluar), pasi që nuk kanë përmendur ndonjë aktivitet të tillë. Në fund, në rubrikën mbi kapacitetet e stafit të saj përgjegjës për komunikim dhe informim publik (janë dhënë të dhëna mbi stafin e Departamentit për Komunikim dhe Informim Publik), PTK ka dhënë hollësitë përkatëse: kualifikim adekuat, përvojë pune prej 1 deri në 10 vjet dhe trajnime relevante me kohëzgjatje 2 javë – 3 muaj, prandaj është vlerësuar me 4 pikë (100%, njëjtë si vitin e kaluar).

Për të ***përmbledhur***, bazuar në informatat e dhëna për qëllime të këtij studimi dhe vlerësimin e tyre në përputhje me Sistemin e Pikëve të Transparencës Institucionale (SPTI) ***Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës***, me ***Indeksin e Transparencës Institucionale (ITI) prej 42.5***, rezulton se është ndërmarrje publike ***e mbyllur***.

IV. Përfundime dhe rekomandime

Bazuar në informatat e marra nga institucionet dhe ndërmarrjet publike të përfshira në studimin e këtij viti, ky raport tregon se shumica dërrmuese e tyre akoma përballen me zbrazësi ligjore në nivel të legjislacionit zbatues. Kjo pasi që, përtej dispozitave të përgjithshme që garantojnë, në nivel parimor, të drejtën e qytetarëve për qasje në dokumente publike, këto obligime në pak raste janë të zbërthyera në kuadër të dokumenteve ligjore që themelojnë dhe rregullojnë organizimin e secilit institucioni dhe ndërmarrjeje publike. Gjithashtu vërehet se mungon një rregullim uniform i fushës së komunikimit dhe informimit publik të institucioneve dhe ndërmarrjeve publike, varësisht nga kategoria e përgjegjësive që kanë (përfaqësuese, ekzekutive, rregullatorë, agjenci e institucione të pavarura, e kështu me radhë). Kjo e bën edhe më të paqartë dhe me të komplikuar tërë kornizën rregullative (si për vetë institucionet dhe ndërmarrjet publike, ashtu edhe për akterët jashtë-qeveritarë dhe publikun e gjerë), duke vështirësuar kështu të kuptuarit dhe zbatimin e saj, përfshirë mundësinë e identifikimit të lehtë të strukturave të brendshme ku gjenden informatat publike të çfarëdo kategorie.

Prandaj *rekomandohet* që të bëhen ndërhyrje në dokumentet ligjore që themelojnë institucionet dhe ndërmarrjeve publike dhe që rregullojnë strukturat e tyre të brendshme, në mënyrë që të sigurohet uniformitet i rregullimit të secilës çështjeje specifike për komunikim dhe informim publik në kuadër të secilit institucion. Më tej, bazuar në një vlerësim të hollësishëm dhe gjithëpërfshirës të implikimeve që krijon fushëveprimi i secilit institucion në kuadër të sektorit përkatës të politikave për fushën e komunikimit dhe informimit publik, nevojitet ndërhyrje në organogramet, termat e referencës dhe përshkrimet e vendeve të punës së zyrave përgjegjëse për komunikim dhe informim publik, për të siguruar rregullim më të saktë të strukturës, si dhe të përgjegjësive dhe detyrave të stafit të tyre. Kjo përfshin edhe rregullim më të mirë të koordinimit të brendshëm në kuadër të secilit institucion i dhe ndërmarrjeje publike, me qëllim që të sigurohet rrjedhja dhe përpunimi adekuat i informatave me rëndësi për interesin publik dhe publikimi i tyre në mënyrë të rregullt, proaktive dhe me kohë. Kjo gjithashtu do të rriste kredibilitetin e secilit institucioni dhe ndërmarrjeje publike në mesin e publikut të gjerë. E fundit, por jo vetëm kaq, kjo është parakusht për vetë institucionet dhe ndërmarrjet publike për të siguruar se posedojnë një kornizë rregullative të kompletuar dhe kapacitete të mjaftueshme institucionale për të filluar konsultime efektive me të gjitha palët e interesuara në zhvillimin e politikave në kuadër të secilit sektor dhe fushe nën përgjegjësinë e tyre, si dhe në implementimin e vlerësimin e vazhdueshëm e sistematik të implementimit të politikave.

Përveç kësaj, gjithashtu mungon një lloj diversifikimi i kornizës rregullative për komunikim dhe informim publik: përtej udhëzimeve administrative dhe rregulloreve, pothuaj asnjë nga institucionet dhe ndërmarrjet publike të përfshira në këtë studim nuk posedon dokumente rregullative udhëzuese, të tilla si udhëzimet e politikave, të cilat do të ndihmonin në ngritjen e kapaciteteve dhe zhvillimin e memories institucionale, por gjithashtu në implementimin më të mirë të kornizës së politikave. Më tej, gjithashtu vërehet se pjesa më e madhe e stafit përgjegjës për komunikim dhe informim publik përballen me një mungesë të theksuar të të kuptuarit adekuat të dispozitave në kuadër të niveleve të ndryshme të hierarkisë së akteve ligjore e rregullative, e në veçanti të lidhshmërisë logjike në mes tyre.

Prandaj *rekomandohet* që secili institucion dhe ndërmarrje publike të zhvillojë udhëzime politikash që duhet të adresojnë secilën çështje specifike relevante për komunikim dhe informim publik, përfshirë:

- Zhvillimin e vazhdueshëm dhe zbatimin e kornizës rregullative për komunikim dhe informim publik;

- ‘Përkthimin’ e legjislacionit kornizë në legjislacion zbatues dhe dokumente politikash dhe ato planifikuese për komunikim dhe informim publik;
- Pasqyrimin efektiv të komponentit për komunikim dhe informim publik në kuadër të secilit dokument politikash dhe planifikues për fusha të veçanta ‘vertikale’ të politikave;
- Zhvillimin dhe vënien në përdorim e mekanizmave dhe masave të ndryshme zbatuese që rrjedhin nga dokumente të politikave dhe ato planifikuese;
- Koordinimin dhe komunikimin brenda-institucional në zhvillimin dhe implementimin e dokumenteve të politikave dhe atyre planifikuese relevante për komunikim dhe informim publik;
- Standardet për vlerësimin e vazhdueshëm të nevojave dhe kapaciteteve të strukturave të brendshme dhe tërë stafit përgjegjës për komunikim dhe informim publik;
- Zhvillimi dhe implementimi i planeve dhe programeve për ngritjen e kapaciteteve institucionale dhe organizative për komunikim dhe informim publik;
- Alokimin adekuat të resurseve për adresimin e nevojave të identifikuara të strukturave dhe stafit përgjegjës për komunikim dhe informim publik;
- Standardet për vlerësimin e vazhdueshëm të implementimit të dokumenteve të politikave dhe atyre planifikuese relevante për komunikim dhe informim publik dhe të performancës së zyrtarëve përkatës;
- Vlerësimin e brendshëm dhe të jashtëm të implementimit të dokumenteve të politikave dhe atyre planifikuese relevante për komunikim dhe informim publik, dhe vlerësimi efektiv i performancës së zyrtarëve përkatës;
- Vendosjen e komunikimit dhe bashkëpunimit me të gjitha kategoritë e palëve të interesuara (shoqërinë civile, mediat, komunitetin e biznesit, grupet e interesit, komunitetin akademik, e kështu me radhë) në zhvillimin e legjislacionit dhe të politikave, si dhe implementimin dhe vlerësimin e implementimit të tyre; dhe
- Zhvillimin dhe shfrytëzimin efektiv të instrumenteve për komunikim dhe informim publik (siç janë ueb-faqet, buletinet informuese, komunikatat për shtyp, etj.), jo vetëm për të promovuar punën dhe plasuar informata të zgjedhura nga vetë institucioni/ndërmarrjen publike në fjalë, por edhe për të promovuar dhe lehtësuar komunikimin dhe bashkëpunimin me të gjitha kategoritë e palëve të interesuara (shoqërinë civile, mediat, komunitetin e biznesit, grupet e interesit, komunitetin akademik, e kështu me radhë).

Sidoqoftë, është e qartë se me kapacitetet aktuale institucionale dhe organizative, zhvillimi i tërë kësaj infrastrukture dhe memorieje institucionale është tejet i vështirë dhe kërkon shumë kohë. Prandaj *rekomandohet* që të zhvillohet një analizë e detajuar kualitative dhe kuantitative e kapaciteteve ekzistuese institucionale dhe e nevojave të secilit institucioni dhe ndërmarrjeje publike. Kjo analizë do të ofronte një pasqyrë gjithëpërfshirëse të gjendjes aktuale dhe nevojave për ngritje të kapaciteteve institucionale.

Pas kësaj, dhe bazuar në gjetjet e dala, *rekomandohet* zhvillimi dhe implementimi i një programi gjithëpërfshirës për ngritjen e kapaciteteve institucionale për komunikim dhe informimi publik. Ky plan do të duhej të përfshinte edhe të gjitha çështjet e përmendura në kuadër të udhëzimeve të politikave të rekomanduar më sipër, por edhe çështje të tjera relevante për këtë fushë politikash. Implementimi i tij kërkon një kombinim trajnimesh, trajnime në vendin e punës, shkëmbimin e përvojave më të mira mes institucioneve dhe ndërmarrjeve publike dhe me palët e tjera të interesuara jashtë tyre, trajnime praktike në vendin e punës, e kështu me radhë.

Së fundi, por jo më pak e rëndësishme, *rekomandohet* zhvillimi dhe implementimi i një strategjie të bazuar në indikatorë për komunikim dhe informim publik dhe përfshirjen e akterëve jashtë-qeveritar në politika publike. Kjo strategji do të përfshinte të gjitha institucionet dhe ndërmarrjet publike dhe do të përmbante objektiva strategjike dhe

aktivitete konkrete për arritjen e tyre, të ndarë në dy komponentë: (1) komponenti politik, i cili do të demonstronin përkushtimin e secilit institucioni dhe ndërmarrjeje publike për të vendosur një politikë për komunikim dhe informim publik dhe për të siguruar përfshirjen sistematike të akterëve jashtë-qeveritarë në tërë ciklin e zhvillimit dhe implementimit të legjislacionit e të politikave; (2) komponenti i politikave, ku do të përcaktoheshin synime strategjike për zhvillimin e vazhdueshëm të legjislacionit politikave dhe institucioneve për të siguruar qasjen e publikut në dokumente zyrtare, transparencë dhe përfshirjen e akterëve jashtë-qeveritar në politika publike; dhe (3) komponenti i operativ, i cili do të përmbante aktivitete dhe masa konkrete për t'u implementuar brenda çdo viti.